**PËRMBAJTJA** **Faqe**

**I. Përmbledhje Ekzekutive......1-9**
**II. Hyrje ......9-10**
**a. Objektivat dhe qëllimi**
**b. Identifikimi i çështjes**
**c. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese**
**d. Përgjegjësitë e audituesve**
**e. Kriteret e Vlerësimit**
**f. Standartet e auditimit**
**III. Përshkrimi i auditimit……......10-71**
**1- Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm......11-18**
**2- Auditim mbi hartimin dhe zbatimin buxhetit......18-21**
**3- Krijimi dhe përdorimi i te ardhurave...a......21-24**
**4- Zbatimi i dispozitave ligjore që rregullojnë marrëdhëniet e punës......24-27**
**5- Mbi administrimin e pronës shtetërore, zbatimin e dispozitave ligjore......27-33**
**6-Mbi organizimin e mbajtjen e kontabilitetit. Nxjerrja e llogarive vjetore, inventarizimi i llogarive të pasurisë publike......33-39**
**7- Prokurimi i fondeve publike për mallra, ndërtime dhe shërbime......39-40**
**8- Auditim mbi zbatimin e procedurave të vlerësimit të ndikimit në mjedis si dhe dhënia e mendimit për pajisjen e subjektit me leje mjedisore. Mbi zbatimin e procedurave për pajisjen e subjektit me autorizim e pëlqim mjedisor......40-60**
**9- Mbi auditimin e procedurave vetëmonitorimit e monitorimi mjedisit......60-66**
**10- Mbi kontrollin e DRM, në subjektet që me aktivitetin e tyre kanë ndikim të lartë në mjedis......66-66**
**11- Mbi zbatimin e marrëveshjeve me organet e tjera të kontrollit, për kryerjen e inspektimin e kontrolleve të përbashkëta......66-70**
**12- Mbi aplikimin e sanksioneve të vendosura......70**
**13- Mbi vlersimin e funksionimit të Kontrollit të Brendshëm......70**
**14- Probleme të ndryshme që mund të dalin gjatë auditimit......71**
**IV. Gjetje dhe Rekomandime......71-76**
**V. Konkluzione dhe opinioni i auditimit ......76-80**
**VI. Anekse ......80-114**
**VII. Dokumente shoqëruese......115**

## I - Përmbledhje Ekzekutive

### a- Përshkrimi i shkurtër i Auditimit

Drejtoria Rajonale e Mjedisit Durrës ka filluar aktivitetin e saj në zbatim të VKM nr.47, datë 29.01.2014 "Për përcaktimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit e të Agjencive Rajonale të Mjedisit" e cila në kapitulli V citon se; "Funksionet e AKM dhe ARM$^{-ve}$ (DRM) pika 2, "*Agjencitë Rajonale të Mjedisit brenda kompetencave që u njeh ligji, ushtrojnë funksionet e mëposhtme: japin lejen e mjedisit të tipit C, sipas përcaktimeve në ligjin nr.10448, datë 14.7.2011 "Për lejet e mjedisit""* i ndryshuar.

Referuar bazës së të dhënave për periudhën e auditimit, rezultatii procesit të inventarizimit fizik të aktiveve, pasurisë, aseteve e vlerave materiale të njësisë shpenzuese DRM Durrës nuk është i njëtjë me gjendjen që evidneton (pasqyra financiare) në periudhat raportuese 2016; 2017, në këto kushte ky rezultat i inventarizimit fizik të aktiveve, astetve, pasurisë e vlerave materiale nuk i ka shërbyer ndërtimit dhe hartimit të pasqyrës financiare për këto periudha raportuese, për pasojë pasqyrat financiare (bilanci kontabël) konsiderohen se nuk tregojnë dhe nuk pasqyrojnë të plotë realitetin e pasurisë, aseteve e vlerave materiale të institucionit të njësisë shpenzuese.

-Procesi inventarizimit fizik i kryer nga komisionet e inventarizimit në përfundim të periudhës raportuese ushtrimore objekt auditimi nuk është kryer në përputhje me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aseteve në sektorin publik", pasi komisioni nuk ka evidentuar e pasqyruar saktësisht sasinë e vlerat e aktiveve për gjatë kryerjes së inventarizimit fizik, duke mos evidentuar cdo vlerë dhe artikull në përdorim.

-Për shpenzimet e kryera nga njësia shpenzuese nëpërmjet procedures së prokurimit "blerje me vlerë të vogël", veprimtaria e anëtarëve të KBVV dhe KMD ka qenë në mospërputhje me Udhëzimin nr. 3, datë 27.01.2015 "Për procedurën e prokurimit me vlerë të vogël".

DRM Durrës ka mbajtur dhe ka përditësuar në formë fizike dhe elektronike regjistrin e akt miratimeve dhe akt refuzimeve sipas formatit standard të shtojcës 4 të Urdhri Ministrit të Mjedisit nr.1964, datë 13.11.2014 "Për miratimin e procedurave të administrimit dhe formatit të regjistrave të lejeve të mjedisit të tipit A, B, C" që "*mbajnë dhe përditësojnë regjistrin sipas shtojcës 6 të VKM nr. 419, datë 25.06.2014, me të dhëna për instalimet e kategorisë C, që ndodhen brenda territorit ku shtrihet fusha e kompetencave të tyre".* Por gjatë auditimit u konstatua se DRM Durrës nuk ka të evidentuar listën e subjekteve aktive, të përditësuar, të subjekteve që duhet të jenë të pajisura me leje mjedisore të tipit (C), të nxjerrë nga bashkëpunimi periodik me DRT, Durrës, QKL, ISHMPUT apo dhe me NJVQV-të (3 bashki) për numrin e përgjithshëm të subjekteve që ushtrojnë veprimtari në qarkun Durrës e që kanë ndikim në mjedis, me detyrim pajisjen me leje mjedisi për ushtrimin e veprimtarive ekonomike.

Për miratimin e lejeve tipi C në zbatim të VKM nr.47, datë 29.01.2014 Kreu V "Funksionet e AKM, ARM (DRM) dhe kërkesave të ligjit nr. 10448, datë 14.07.2011 "Për Lejet e Mjedisit" dhe Urdhri nr. 38, datë 17.03.2015 të Drejtorit të Përgjithshëm të AKM, Drejtori i DRM Durrës me urdhëra të vecanta ka ngritur komisionin e shqyrtimit të aplikimeve për leje mjedisi tipi (C) i përbërë nga Drejtori dhe specialistet e monitorimit. Shqyrtimi i aplikimeve për leje mjedisi bëhet nga komisioni ku për shkak të numrit të kufizuar mungon grafiku i hartuar nga drejtori DRM Durrës në zbatim të urdhërave nr.109 dhe 1847, datë 06.10.2015 "Për zbardhjen e akt miratimeve dhe refuzimeve për leje mjedisi tipi C". Në DRM Durrës u auditua edhe libri i protokollit dhe u konstatua se mbajtja e procesverbaleve të mbledhjeve të komisioneve kishte mangësi nga ana drejtshkrimore dhe zbatimi i rregullave të korrektimit dhe fjalitë shpesh herë kanë qenë të paplota dhe të pakuptueshme dhe pa koherence kuptimore për të paraqitur me saktësi qëndrimin e antarëve të komisionit gjatë shqyrtimit të aplikimeve për leje.

Subjektet kanë aplikuar për leje mjedisi tipi (C), konform legjislacionit në fuqi dhe nëpërmjet QKL Tiranë. Në rrugë elektronike QKL i ka dërguar aplikimet në AKM Tiranë e cila po në mënyrë elektronike, me postë elektronike (e-mail) zyrtar i ka përcjellë kërkesat për leje në DRM Durrës. Të gjitha kërkesat e subjekteve që kanë ardhur në formë elektronike në DRM Durrës janë të qarta dhe jo të dëmtuara, gjë që lejon mundësinë e verifikimit të tyre, nëse janë kryer procedurat e përcaktuara në Kreu IV, VKM nr. 419, datë 25.06.2014 "Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipit A, B, C, për

transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullat e hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKL$^{-ja}$".

Për periudhën e auditimit 01 shtator 2016-01 shtator 2018 për të marë Leje tipi C nga DRM Durrës kanë aplikuar gjithësej 526 subjekte dhe kanë marë këtë leje 299 subjekte duke rerfuzuar kështu 227 subjekte gjithësej. Numri i tyre i shperndarë në të tre periudhat vjetore të auditimit është: Për tre muajt e fundit Tetor-Dhjetor 2016 DRM Durrës nga **68** aplikime të kryera ka refuzuar **23** aplikime dhe ka aprovuar 45 Leje mjedisore tipi C; për vitin **2017** DRM Durrës nga **193** aplikime të kryera ka refuzuar **39** aplikime dhe ka aprovuar 154 Leje mjedisore tipi C; për nëntëmujorin e parë Janar-Shtator të vitit 2018 DRM Durrës nga **265** aplikime të kryera ka refuzuar **165** aplikime dhe ka dhënë 100 Leje mjedisore tipi C.

Për vitin 2016 numri i dosjeve të aplikimit për dhënie mendimi për pëlqim mjedisor për Leje tipi A/B dhe VNM paraprake/thelluar ka qenë **159** raste. Për vitin 2017 ka më pak aplikime të ardhura për VNM të Thelluar/Paraprake dhe Leje Mjedisi Tipi A/B. Për vitin 2017 janë shqyrtuar gjithësej **129** aplikime nga të cilat **96** janë për VNM Paraprake dhe **27** janë Leje Tipi B dhe **4** raste janë Leje Tipi A. Prej shqyrtimit të këtyre rasteve, për **124** aplikime ka dhënie mendimi pozitiv dhe për **5** ka dhënie mendimi negativ ku hyjnë 4 VNM dhe 1 leje Tip B. Për periudhën 1 Janar 2018- 1 Tetor 2018 janë shqyrtuar gjithësej **101** dosje nga të cilat **58** VNM paraprake dhe **41** Leje Tipit B e 2 Leje Tip A. Nga ky total aplikimesh **85** janë dhënie mendimi pozitiv dhe **16** dhënie mendimi negative nga të cilat janë refuzuar **13** VNM dhe 3 leje Tip B.

Nga auditimi konstatohet së për **258** rastet e përmendura më lart në total, dëgjesa me publikun nuk janë kryer për të gjitha rastet, në varësi edhe të delegimit të kësaj kërkese që DRM Durrës ka marë nga AKM. Këto dëgjesa janë kryer për tre periudhat e auditimit më lart përkatësisht: për shtator-dhjetor 2016 nga 86 raste për dhënie mendimi për pëlqim mjedisor, janë kryer konsultime me publikun në 25 raste dhe nuk janë kryer këto konsultime në 61 raste; për gjithë vitin 2017 nga 258 raste për dhënie pëlqimi mjedisor për Leje Tip A/B dhe VNM, DRM Durres ka kryer konsultime me publikun në 75 raste dhe nuk e ka kryer këtë konsultim në 183 raste; për periudhën janar - -1 shtator 2018 për 326 kërkesa për dhënie mendimi për pëlqim mjedisor, në 88 raste ka patur konsultime me publikun dhe në 238 raste ka munguar ky konsultim.

Referuar në ligji nr.10431, datë 09.06.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit", ligjin nr.10440, datë 07.07.2011 "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis", ligjin nr. 10448, datë 14.07.2011 "Për lejet e mjedisit", VKM nr.1189, datë 18.11.2009 "Për rregullat dhe proçedurat për hartimin dhe zbatimin e programit kombëtar të monitorimit të mjedisit" si dhe kushtit i vënë në lejet e marra nga subjektet për raportim periodik, subjektet janë të detyruar të monitorojnë shkarkimet nga veprimtaritë ekonomike në përputhje me kushtet e lejeve mjedisore, të bëjnë vetëmonitorimet dhe të sjellin raportet e vetëmonitorimit pranë DRM$^{-së}$

Nga auditimi për dhënien dhe miratimin e lejes mjedisore pas vetemonitorimit të subjekteve, nga informacioni i vënë në dispozicion nga DRM Durrës rezulton se një pjesë e subjekteve që me aktivitetet e tyre kanë më shumë ndikim në mjedis, nuk kanë respektuar detyrimin ligjor që buron nga kushtet e lejeve mjedisore, pasi nuk kanë dorëzuar raportet e vetëmonitorimit.

DRM nuk ka informacion periodik të plotë nga ana e ISHMP mbi gjobat dhe masat administrative të përkoheshme apo adminsitrative që merren prej saj ndaj subjekteve shkelës për mosdërgim te vetemonitorimeve apo tejkalim të normave të shkarkimit në mjedis.

Nga auditimi mbi dokumentacionin e vendosur në dispozicion për bashkëpunimin e DRM$^{-së}$ Durrës me institucione të tjera shtetërore me qëllim parandalimin e ndikimeve negative në mjedis dhe që i përket identifikimit të subjekteve që gjenerojnë e disponojnë mbetje të

ndryshme me ndikim të madh në mjedis, si edhe marrja e masave në drejtim të përmirësimit të gjendjes për perudhën raportuese objekt auditimi (*tetor 2016-tetor 2018)* u konstatua se; DRM-ja Durrës me institucionet e tjera shtetërore si; Drejtoria e Shëndetit Parësor (DSHP), Drejtoria e Bujqësisë e Ushqimit (DBU), Autoriteti Kombëtar i Ushqimit Durrës (AKU), Drejtoria Rajonale Tatimore (DRT), Drejtorinë Rajonale ALUIZN Qarku Durrës, si dhe NJQV bashkitë Durrës, Krujë Shijak, nuk kanë kryer asnjë bashkëpunim, sepse me këto institucione nuk ka të dokumentuar ndonjë planveprim të përbashkët, si dhe ka munguar shkëmbimi informacionit të ndërsjelltë, ndërsa DRM është mjaftuar vetëm me dërgimin e shkresave zyrtare për marrje informacioni me qëllim përgatitjen e Raportit të Gjëndjes Mjedisore (*RGJM*); pra ka munguar bashkëpunimi në mënyrë që të bëhet sa më eficente ndjekja dhe evidentimi mbetjeve që gjenerohen në teritorin e qarkut, njëkohësisht për të evidentuar ndërtimet pa leje në toka bujqësore e troje, etj.
Bën përjashtim rasti kur Dega Rajonale e ISHMP- Durrës në bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale të Mjedisit Durrës, ngriti **11 grupe inspektimi** për evidentimin e situatës mjedisore në Qarkun e Durrësit gjatë vitit 2017 si edhe u inspektuan **34** gurore në bashkëpunim mes të dy institucioneve gjatë vitit 2018. Nga auditimi i procesverbaleve u konstatua se ka pasur hedhje pa kriter të mbetjeve të ndryshme si urbane, inerte, skrapi etj, të cilat ishin të fotografuara dhe të përcaktuara me përafërsi dhe sasia e gjetur dhe e ngarkuar çdo ditë, e hedhur në sistemin *TrashOut Albania,* me ndarje sipas rretheve dhe lagjeve.
Në bazë të të dhënave të vëna në dispozicion nga DRM Durrës, në këtë qark gjenden gjithsej **181** subjekte me ndikim të lartë e të mesëm në mjedis. Nga këto subjekte **13** janë pajisur me leje mjedisore të tipit A, **9** për rrethin e Durrësit dhe **4** për Rrethin e Krujës. Ndër aktivitetet e përfshira në to përmendim "rritje intensive të shpendëve", "prodhim produkte higjienike kozmetike", "rafineri vajrash dhe gazsh", në Durrës dhe kryesisht prodhim çimentoje në Krujë, etj. 168 subjekte janë pasjiur me leje mjedisi të tipit B, nga të cilat 119 për Rrethin e Durrësit dhe 49 për Rrethin e Krujës. Ndër aktivitetet e përfshira në to përmendim në Durrës "magazinim i kimikateve", "stacion transferimi për mbetje jo të rrezikshme", "gaz natyror aromatik ose GLN", "prodhim letre", "përpunim metalesh", "fabrikë këpucësh", "treg fruta-perime me shumicë", "përpunim lëndësh drusore", etj. Në Rrethin e Krujës përmendim "nxjerrje mineralesh, rërë, argjilë, etj.", "prodhim i produketeve abrazive", "prodhim inertesh dhe betoni", "linjë prodhimi gëlqere", "riveshje e gomave të përdorura", "linjë fraksionimi inertesh", etj.

**b- Një përshkrim i përmbledhur i gjetjeve dhe rekomandimeve të auditimit.**

**Gjetje nga auditimi:** Nga analiza e fondeve të programuara në projektbuxhetet dhe atyre të alokuara për shpenzime të përdorura nga njësia shpenzuese DRM Durrës rezulton se fondet për shpenzime janë në kushtet e pamjaftueshmërisë për realizimin e funksioneve të Institucionit, sepse ka mungesa investimi për paisje zyre e mjete transporti për lëvizjen e specialistëve për kontroll dhe monitroim të subjekteve që janë pajisur me lejet mjedisore të cdo tipi. Ka mungesë në ambiente pune, ku edhe ato në dispozicion janë në kushtet të papërshtatshme dhe të pamjaftueshme për punonjësit, njëkohësisht mungon ambienti për funksionimin e arkivit dhe protokollit. Ka mungesë në fonde për shpenzime operative, për udhëtime të specialistëve jashtë vendit të punës, në territorin e qarkut për ushtrimin e verifikimeve të nevojshme në terren në subjektet e pajisura me leje mjedisore, si dhe për shpenzime për dokumenta evidentuese (larje foto), të cilat janë të domosdoshme dhe pjesë e procedurave për paisjen me

leje mjedisore të tipit (C), apo të dhënies së mendimeve për VNM e leje tipi (A) e (B) të subjektit aplikues. (*Trajtuar më hollësishtë në faqen **18-20** të Raportit të Auditimit*).
***Rekomandim***: DRM Durrës nëpërmjet hartimit të projektbuxhetit, me analizë të plotë të kërkojë pranë Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit zgjidhjen për të siguruar ambiente të përshtatshme për zyra me qëllim krijimin e kushtev të punës për punonjësit e institucionit, duke përfshirë dhe ambientin për arkivprotokoll. Njëkohësisht të kërkojë rishikimin e alokimit dhe rritje fondeve të programuara për shpenzime operative në mbështetje të funksioneve të saj.
**Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi nxjerrjen e hartimin e pasqyrave financiare të njësisë shpenzuese DRM Durrës për periudhën raportuese objekt auditimi u konstatua se, pasqyra financiare (bilanci kontabël) nuk pasqyron realitetin e gjendjes së aktiveve, pasurisë, aseteve e gjendjes materiale të institucionit, pasi rezultati i inventarizimit fizik nuk i ka shërbyer hartimit të pasqyrës financiare sepse, ndërmjet gjendjes fizike e gjendjes së deklaruar në pasqyrën financiare rezultojnë diferenca; njëkohësishtë 8 artikuj janë të administruar vetëm në sasi pa vlerë dhe 5 artikuj janë në përdorim, por të pa administruar e dokumentuar në sasi e vlerë, veprime në mospërputhje me UMF nr. 28, datë 18.12.2014 "Për procedurat e mbylljes së llogarive vjetore të buxhetit", Kap VI "Rakordimi dhe mbyllja e llogarive të tjera vjetore të qeverisjes se përgjithshme", pika 33 "Rakordimi, mbyllja e llogarive të tjera vjetore të njësive dhe hartimi i pasqyrave financiare do të vazhdojë të kryhet në bazë të UMF nr. 14, datë 28.12.2006 dhe nr. 26, datë 27.12.2007 ndryshuar me udhëzimi nr. 10, datë 27.02.2008" dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", Kreu IV "Sistemi kontrollit periodik aktiveve", pika 74 "Inventarizimi aktive" (*Trajtuar më hollësisht në **32-39** të Raportit të Auditimit*).
***Rekomandim:*** DRM Durrës, specialisti financës të marë masa të plota për të kryer vlerësimin dhe administrimin e aktiveve të qëndrueshme qarkulluese të institucionit të cilat janë në përdorim pa vlerë dhe të pa administruara, nëpërmjet kontabilizimit me qëllim që inventarizimi fizik i aktiveve të qëndrueshme qarkulluese, ti shërbej hartimit të pasqyrës financiare.
**Gjetje nga auditimi:** DRM Durrës nuk ka të përditësuar periodikisht listën e subjekteve të pajisur me leje mjedisore të tipit (C) që janë aktive, të nxjerrë nga bashkëpunimi periodik me DRT Durrës, QKL, ISHMPUT apo dhe me NJVQV-të (për 3 bashkitë) për numrin e përgjithshëm të subjekteve që ushtrojnë veprimtari ekonomike në qarkun Durrës e që kanë ndikim në mjedis, për të ditur subjektet që duhet të bëjnë vetmonitorim dhe subjektet që zhvillojnë ativitet të pa pajisur me leje mjedisi në kundërshtim me nenin 4 dhe nenin 10 të Ligjit 10431, datë 09.06.2011"*Për lejet e mjedisit*" për ushtrimin e veprimtarisë ekonomike dhe VKM nr.419, datë 25.6.2014, kreu VIII pika 1,2,3 (*Trajtuar në faqen **62** të Raportit të auditimit*).
***Rekomandim:*** DRM Durrës në bashkëpunim me AKM Tiranë, të marë masa për të evidentuar e ndjekur subjektet aktive mbajtës të lejeve mjedisore tipi (C) dhe subjektet që ushtrojnë veprimtari ekonomike të pa pajisur me leje mjedisore, duke rakorduar me DRT Durrës, ISHMPUT, QKL dhe NJVQV-të, për numrin e përgjithshëm të subjekteve aktive që ushtrojnë në çdo periudhë të kohës veprimtari ekonomike në qarkun Durrës, ndjekjen e monitorimin e vazhdueshëm të tyre si edhe të subjekteve që zhvillojnë aktivitet ekonomik të pa pajisur me leje mjedisi sipas subjekteve të përcaktuara në bazë të aktivitetit kufi, të përcaktuara tek shtojca nr.1 e Ligjit 10448, datë 14.07.2011.
**Gjetje nga auditimi:** DRM Durrës në formulimin e akteve të refuzimit të lejeve tipi (C), është konstatuar se, në disa raste mungojnë citimet në nenin apo pikën e bazës ligjore e nënligjore dhe pikat e shtojcës përkatëse të përcaktuara në VKM nr.419, datë 25.6.2014, kreu 4 pika 9 dhe10 dhe shtojcës nr. 6 për secilin prej kushteve të paplotësuara. Në akt refuzimet DRM

Durrës është mjaftuar në përgjithësi vetëm me përmendjen apo citimin e ligjit nr. 10431, datë 09.06.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit"; gjithashtu mungojnë aktverifikimet ne terren dhe relacionet përkatëse të grupit të specialistëve për argumentimin e refuzimeve *(Trajtuar më hollësisht në faqe 43-52 të Raportit të Auditimit).*

**Rekomandim**: Në Urdhërin e brendshëm të Drejtorit të DRM Durrës për ngritjen e komisionit të licensimit me Leje Tipi C, të kërkohet që ato të përgatisin dhe formulojnë qartësisht në çdo rast arsyetimin ligjor për akt-refuzimet, bazuar tek neni 21 i Ligjit 10431, datë 09.06.2011"*Për lejet e mjedisit*" dhe aktet e tjera nënligjore si VKM nr.419, datë 25.6.2014, kreu 4 pika 9 dhe10, duke i mbështetur në çdo rast shkaqet e refuzimit edhe me bazën nënligjore të kushtete, sipas shtojcës nr.6.

**5- Gjetje nga auditimi:** Në DRM Durrës u konstatua se procesverbalet e mbledhjeve të komisioneve teknike gjatë verifikimit dhe shqyrtimit të kërkesave për miratimin ose refuzimin e lejeve mjedisore janë mbajtur pa regulla drejtshkrimi dhe pa korrektesë gjuhësore, sidomos në 19 raste ku u konstatuan mangësi në konceptim dhe formulim dhe nuk janë evidentuar diskutimet, mendimi i NJQV, dokumentacioni, situatat, zhvillimi i tyre, duke mos prezantuar një informacion të plotë në përputhje me kërkesat e ligjit nr.10448, datë 14.07.2011"Për lejet e mjedisit" dhe VKM nr. 419, datë 25.06.2014. Në procesverbalet e mbledhjeve të komisionit nuk pasqyrohen as të dhënat mbi zotërimin e dokumentave të pronësisë, dokumentimi i mendimit të NJVQV$^{-ve}$ dhe informacion tjetër ligjor që lidhet me mbrojtjen e mjedisit, sepse këto informacione ligjore pothuaj në asnjë rast nuk kanë qenë të pasqyruara me korrektësi në këto shënime *(Trajtuar më hollësisht në faqen* ***43-45*** *të Raportit të Auditimit).*

**Rekomandim:** Kryetari i Komisionit të dhënies së 'Leje Tipi C' të marrë masa që në procesverbalet e mbajtura në mbledhjen e komisioneve për leje mjedisi tipi (C), të pasqyrohen e citohen saktësisht në çdo rast shënimet nga ana e formës dhe përmbajtjes së aktivitetit gjatë shqyrtimit të dokumentacionit në mbledhjet e komisioneve teknike dhe të pasqyrohen në këto procesverbale në mënyrë objektive dhe sipas rregullave të drejtshkrimit arsyet e pranim/refuzimit, mangësitë ligjore dhe dispozitat përkatëse, duke kërkuar respektimin e kushteve apo kritereve ligjore e nënligjore që duhen plotësuar nga subjektet me informacion të plotë për vlerësimin e dokumentacionit.

**Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi në DRM Durrës u konstatua se ka diferenca gjatë kontrolleve mes të dhënave që subjektet paraqesin në raportet e vetëmonitorimit dhe ndotjes reale të mjedisit prej tyre, kjo pasi në disa raste analizat e sjella prej tyre nuk kanë saktësi dhe besueshmëri të lartë dhe mungojnë laboratorët shtetërorë me ndihmën e të cilave do të mund të sigurohej një informacion më i përafërt mbi saktësinë e të dhënave në cdo rast prej laboratorëve të akredituar sipas VKM nr. 1185, datë 18.11.2009*"Për rregullat dhe procedurat për hartimin dhe zbatimin e programit kombëtar të monitorimit në mjedis",* vendim i cili ka nevojë për ndryshime dhe përshtatje me kushtet e reja, pasi ka mangësi në vërtetësinë e raporteve të vetëmonitorimit *(Trajtuar më hollësisht në faqe* ***60-65*** *të Raportit të Auditimit).*

**Rekomandim:** DRM Durrës në bashkëpunim me AKM Tiranë, të marrin masa që të parashikohen fonde të nevojshme për të lidhur kontrata me subjekte të liçensuara dhe akredituara laboratorike për marrjen prej tyre të shërbimit të kërkuar laboratorik për verifikime të pavarura me analiza shoqëruese të dhënash ndaj subjekteve që kërkojnë leje mjedisore ose që kryejnë vetmonitorim.

**Gjetje nga Auditimi:** Mungesa e raporteve të vetëmonitorimit për të gjitha kategoritë e lejeve bën që të mos njihet si duhet gjendja e mjedisit në qarkun Durrës me të dhënat e shkarkimeve në tokë, ujë dhe ajër.

Raportet e vetëmonitorimit nuk janë vlerësuar teknikisht për shkarkimet apo ndërhyrjet që kanë në mjedis, në varësi të aktivitetit/veprimtarisë që ushtrojnë subjektet e ndryshme me Leje Tipi C, referuar dispozitave ligjore të mjedisit, Ligjit numër10448, datë 14.07.2011"Për lejet e mjedisit" dhe VKM nr. 419, datë 25.06.2014 *(Trajtuar më hollësisht në faqen **60-66** të Raportit të Auditimit).*

**Rekomandim:** DRM Durrës të marrë masa për hartimin e një database të veçantë, të përditësuar me numrin e subjekteve dhe numrin e raporteve të vetëmonitorimeve periodike që duhet të paraqiten nga secili subjekt, numrin e raporteve të vetëmonitorimit të dorëzuara dhe ato që duhet të dorëzohen, me afate dhe data përkatëse, në varësi të llojit të veprimtarisë së subjektit dhe kushteve të lejes.

**Gjetje nga Auditimi:** DRM Durrës për periudhën raportuese tetor 2016 – teror 2018, ka dhënë ***258 mendime për vlerësime të ndikimit në mjedis (VNM*)** dhe për leje mjedisore për licencimet të tipit (A), (B) nga AKM. Për këto DRM Durrës ka data base elektronike për vitin 2017-2018 por nuk ka informacione të sakta nga AKM Tiranë për ecurinë e procedurës për ***shumicën e praktikave të dhënies së mendimit prej tyre,*** përcaktime këto të bëra në VKM nr. 419, kreu VIII tek Dispozitat përfundimtare. Këto veprime janë në kundërshtim edhe me urdhrin e Ministrit të Mjedisit nr. 1964, datë 13.11.2014 "Për miratimin e procedurave të administrimit dhe formatit të regjistrave të lejeve të mjedisit të tipit (A), (B) dhe (C)". Gjithastu, DRM Durrës nuk disponon një data base elektronike mbi VNM dhe dhënie mendimi për Leje Tipi A/B për periudhën e auditimit tetor-dhjetor 2016 dhe për gjithe vitin 2016 *(Trajtuar më hollësisht në faqe **55-60** të Raportit të Auditimit).*

***Rekomandim:*** DRM Durrës të kërkojë zyrtarisht nga AKM Tiranë, marrjen e të dhënave në lidhje me ecurinë e praktikave që ka dhënë mendime për VNM-të e lejet mjedisore tipi (A; B) me synim përditësimin nga ana e saj në formë elektronike të rregjistrit të lejeve tipi (A,B) sic përcakton VKM nr. 419, kreu VIII tek Dispozitat përfundimtare sipas formatit standard të miratuar, zbatimin e afateve dhe procedurave ligjore, si dhe mundësimin e bashkëpunimit ligjor me strukturat e tjera si DRISHMU, NJVQV-të dhe QKL.

**- Gjetje nga auditimi:** DRM Durrës për periudhën raportuese tetor 2016 – teror 2018, nuk ka hartuar program pune për bashkëpunim dhe kryerje të kontrolleve të përbashkëta dhe bashkëpunim me NJQV (*bashki e njësi administrative*) për mbetjet urbane dhe mbetjet spitalore sipas Urdhërit Nr. 16, datë 06.11.2017 "Për ngritjen e grupeve të punës për zbatimin e programit për evidentimin e problematikës mjedisore në Republikën e Shqipërisë". Gjithashtu, bashkëpunimi ndërmjet DRM dhe ISHMPU Durrës ka qenë në kushtet e pamjaftueshmërisë dhe nuk janë shtrirë në të gjithë intervalin kohor të auditimit kontrollet e monitorimet e përbashkëta për informalitetin e zbatimit të kushteve të lejeve mjedisore, në përmbushje të kërkesave të ligjit nr.10431, datë 09.06.2011 "*Për mbrojtjen e mjedisit*" dhe kërkesave të përcaktuara në Kreu VII, pika 2 ku përcaktohet se "Agjencia Kombëtare e Mjedisit administron sistemin e informacionit mjedisor"dhe pika 3 ku thuhet se "Autoritetet publike bashkëpunojnë me Agjencinë Kombëtare të Mjedisit, me qëllim sigurimin e funksionimit të duhur të këtij sistemi...", VKM nr. 47, datë 29.01.2014 "*Për përcaktimin e rregullave për organizimin e funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe të agjencive rajonale të mjedisit*" sipas pikës a të Kreut VI ku thuhet se: "AKM-ja lidh marrëveshje dhe bashkëpunon me njësitë e qeverisjes vendore mbështetur në ligjin "Për organizimin dhe funksionimin e njësive të qeverisjes vendore", si dhe në legjislacionin mjedisor" *(Trajtuar më hollësisht në faqe **66-70** të Raportit të Auditimit).*

***Rekomandim:*** DRM Durrës nëpërmjet bashkëpunimit me AKM duhet të nxitë dhe të kërkojë prej saj që në hartimin e programit vjetor të punës të DRM Durrës të pasqyrohet qartë edhe

bashkëpunimimi me institucionet e tjera, me qëllim kryerjen e monitorimeve nëpërmjet kontrolleve të përbashkëta me ta, në zbatim të marrëveshjeve të bashkëpunimit me organet e tjera të kontrollit, si me Drejtorinë Rajonale të Tatimeve, NJQV dhe ISHMPUT Durrës për zbatimin e kushteve të lejeve mjedisore dhe ndikimit në mjedis.

**Gjetje nga auditimi:** DRM Durrës për periudhën raportuese tetor 2016 – tetor 2018 ka shqyrtuar gjithësej **670** dosje për Leje Tip C + mendim VNM (526+ 144 raste) duke kryer njoftim në NJQV në **277** raste ose në masën **41 %** të tyre. NjQV janë përgjigjur gjithësej në **188** raste ose në masën **67%** të rasteve të njoftuara, në mungesë të të cilave DRM ka vijuar procedurat e miratimit të lejeve pa kthim përgjigje nga NJQV, sipas pikës 2, 3 dhe 4, Kreu IV të VKM nr.419, datë 25.06.2014 "***Mbi afatin 3 ditor"*** të përgjigjes për mendimin e NJQV për miratimin e lejeve mjedisore tipi (C) ku në pikën 4 thuhet se "Nëse NjQV-ja përkatëse nuk shprehet brenda afatit, DRM vijon me procedurën" *(Trajtuar më hollësisht në faqe **41-43** të Raportit të Auditimit).*

***Rekomandim:*** DRM Durrës të marë masa dhe të gjejë forma bashkëpunimi për tërheqjen e e mendimit ndaj subjekteve që aplikojnë për Leje tip C nga ana e NJVQV$^{-të}$ përkatëse dhe të sigurojë prej tyre dhënien e mendimit brenda afatit 3 ditor. DRM Durrës, herë pas here, për rastet e mosdhënies së mendimit nga ana e NJQV të njoftojë zyrtarisht AKM Tiranë dhe Ministrinë e Mjedisit në lidhje me angazhimin e e NJQV në dhënien e mendimeve të mbi subjektet që kërkojnë leje Tip C.

**11. Gjetje nga Auditimi**: DRM Durrës në dokumentacionin elektronik të dosjeve për dhënie mendimi për VNM$^{-të}$ e lejes mjedisore të tipit A e B pothuajse në të gjitha rastet mungojnë praktikat e procesit të konsultimeve dhe dëgjesave me publikun. Në mbi **34** raste për dëgjesat me publikun DRM është shprehur se; "*....do të kryhen hap pas hapi në fazën e zbatimit të projektit...".* Nga auditimi u konstatua se në subjektet që kanë filluar punimet, deri në përfundim të periudhës së auditimit, nuk ka informacione për realizimin e të gjitha këtyre dëgjesave, veprime në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 419, datë 25.06.2014 "*Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për Leje Mjedisi të Tipi A,B,C, për transferimin e lejeve nga një subjekt tek tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKL",* Kreu I, pika 1/dh, Kreu VI, pika 12; 13; 15; 16 dhe 22 *(Trajtuar më hollësisht në faqet **55-60** të Raportit të Auditimit).*

**Rekomandim:** DRM Durrës në bashkëpunim me AKM Tiranë, të marrë masa që të komunikojë në dëgjesa me publikun në të gjitha rastet kur veprimtaria e subjektit që aplikon për lejë ka impakt mjedisor ose kur kjo kërkohet nga publiku i interesuar, sidomos në rastet e lejeve tip A/B dhe VNM dhe kjo të realizohet para se të jepet mendimi për leje mjedisore e jo pasi të ketë filluar aktiviteti investues ose prodhues nga ana e subjektit.

**Gjetje nga auditimi**: Nga auditimi i strukturës së organikës së DRM për periudhën objekt auditimi u konstatua se ka pasur ndryshime të shpeshta të specialistëve, cfarë ka shkaktuar mungesën e eksperiencës së specialistëve duke ndikuar negativisht në realizimin e objektivave dhe funksioneve të institucionit, pasi DRM e ushtron aktivitetin në Qarkun Durrës në një teritor të gjerë, me veprimtari ekonomike intensive, me gjendje të madhe asetesh dhe pasurish natyrore, faktorë këta që kërkojnë vazhdimësi, eksperiencë dhe profesionalizëm të lartë në mjedis e shoqëruar kjo me një numër të konsiderueshëm specialoistësh në strukturen e DRM$^{-së}$. Kështu, gjatë periudhës së auditimit u konstatua se ka pasur gjithësej 18 punonjës me status të nëpunësit civil dhe 1 në periudhë prove nga të cilët janë larguar 10 punonjës *(trajtuar në faqen **20** të Raportit të Auditimit).*

**Rekomandim:** DRM, AKM dhe Ministria e Turizmit dhe Mjedisit duhet të ndryshojë filozofinë e rekrutimit të punonjësve të DRM të cilët janë me status të nëpunësit civil nga DAP për të trajnuar dhe aftësuar punonjësit dhe për të shmangur mundësinë negative të pagesave të disa pagave shtesë të punonjësve që vazhdojnë gjyqet me DRM-AKM për largimin e tyre nga puna.
**Gjetje nga auditimi**: Në DRM Durrës për **153** subjekte të cilët nuk kanë kryer pagesën vjetore të tarifës së lejes mjedisore tipi (C), si pa mjaftueshmëri nga fakti mungesës së rregullshmërisë (udhëzim, urdhër, etj...) dhe për të ndjekur proceduarat në rastet e ndërprerjes së aktivitetit për pasojë edhe të lejës mjedisore, ndërsa për 112 subjekte për të cilët është bërë pezullimi lejes mjedisore për mos pagesë të tarifës vjetore të lejës mjedisore në total 265 subjekte (153+112) me tarifë 2,000 lekë në vit, duke krijuar të ardhura të munguar për buxhetin e shtetit shuma 530 mijë lekë. (*Trajtuar më hollësisht në faqen 8 të Raportit të Auditimit*).
***Rekomandim*:** DRM Durrës në bashkëpunim me DRISHMP Durrës, të vazhdojë ndjekjen dhe të marë masa administrative për arkëtimin nga 153 subjekte të tarifës vjetore për leje mjedisore tipi (C), si dhe 112 subjekte pas pezullimit të lejes mjedisore tipi (C).

## II -HYRJE

Kontrolli i Lartë i Shtetit (*në vazhdim KLSH*), auditoi Drejtorinë Rajonale të Mjedisit Qarku Durrës (*në vazhdim* DRMD) duke i kushtuar vëmendje të posaçme çështjeve që lidhen me vlerësimin e aktivitetit të institucionit për procedurat e monitorimit, vet-monitorimit të subjekteve me ndikim në mjedis nga ndotja dhe dëmtimi, procedurën ligjore në dhënien e akt-miratime/refuzime të lejeve tipi (C), në zbatim të ligjit nr.10431, datë 09.06.2011 "Për Mbrojtjen e Mjedisit"; VKM nr. 419, datë 25.06.2014 "*Për Miratimin e Kërkesave të Posaçme për Shqyrtimin e Kërkesave për Leje Mjedisi Tipi A, B, C për transferimin e lejeve nga një subjekt tek tjetri, të kushteve për Lejet Respektive të Mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre Lejeve nga QKL*", aktivitetin ekonomiko-financiar, ecurinë e punës në përmbushje të funksioneve ligjore të mbrojtjes së mjedisit, si dhe forcimit të sistemit të Kontrollit të Brendshëm, lidhur me integritetin e punonjësve në zbatim të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", lidhur me zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë, siguria e nivelit të menaxhimit dhe transparenca me publikun, etj.
DRM-të kanë filluar funksionimin me VKM nr.47, datë 29.01.2014 "Për Përcaktimin e Rregullave për Organizimin dhe Funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit e të Agjencive Rajonale të Mjedisit", si pjesë të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit (AKM Tiranë) e cila varet nga Ministria e Mjedisit dhe ushtron aktivitetin në juridiksion të dy rretheve Durrës e Krujë ose 3 bashkive: Durrës, Krujë, Shijak.
KLSH në përputhje me kompetencat e parashikuara në zbatim të ligjit nr.154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", ushtroi auditim në DRM Durrës në zbatim të Programit të Auditimit nr.***1275/1, datë 16.11.2018.***
Lloji i auditimit i parashikuar sipas programit është Auditm i përputhshmërisë dhe rregullshmërisë.
Metoda e auditimit sipas pikave të programit është mbi bazë risku, e njëpasnjëshme dhe me zgjedhje, sipas vlerësimeve të riskut.
Periudha e auditimit përmbledh aktivitetin për periudhën raportuese (01.10.2016 deri më datë 01.10.2018).
Auditimi sipas çështjeve të shqyrtuara është kryer nga Grupi i Auditimit i përbërë:

**1. A.C., përgjegjës grupi.**

**2. K.M., auditues**
**3. V.R., auditues**

**Objektivat dhe qëllimi i auditimit.**
Vlerësimi i aktivitetit të institucionit lidhur me përmbushjen e funksioneve në zbatim të ligjit nr. 10431, datë 09.06.2011 "Për mbrojtjen e Mjedisit"; ligjit nr.10448, datë 14.7.2011 "Për Lejet e Mjedisit" i ndryshuar; ligjit nr.10433, datë 16.06.2011 "Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë", ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 "Për kundërvajtjet administrative"; ligjit nr.10463, datë 22.09.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", me synim ruajtjen e mjedisit dhe pyjeve e për të siguruar: mirë përdorimin e resurseve dhe garantimin e sigurisë së jetës, veprimtarisë dhe aktivitetit të publikut nga kundërvajtjet në mjedis dhe nga pasojat e kësaj, përmbushjen e funksioneve rregullatore për leje mjedisi, monitorimin dhe vlerësimin e gjendjes së mjedisit (pjesë rajonale e përgatitjes së Programit Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit), kërkimet shkencore lidhur me mjedisin, botime e kërkime për zhvillimin e teknologjisë së informacionit etj; VKM nr. 47, datë 29.01.2014 "Për Përcaktimin e Rregullave për Organizimin dhe Funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe Agjencive Rajonale të Mjedisit", ku përveç sa më sipër DRM/ARM përmbushin funksionet si: dhënie leje mjedisore tipi (C), mbajtje dhe përditësim i regjistrit të dhënave, instalime Kategoria (C) në territorin juridiksional të përcaktuar në rregulloren "*Për organizimin dhe veprimtarinë e AKM dhe ARM-ve/DRM-ve*" e miratuar në datë 20.10.2014 nga Ministri i Mjedisit, si dhe përmbushjen e misionit të garantimit dhe respektimit të kërkesave ligjore në fushën e mbrojtjes së mjedisit, bazuar në 9 parimet e përcaktuara në Kreu II, neni 6-14 të ligjit nr. 10431, datë 09.06.2011 "*Për Mbrojtjen e Mjedisit*", të cilat i japin institucionit jo vetëm funksion ligjzbatues, por dhe funksion parandalues, këshillues, informues dhe edukues, për reagim të kulturuar të publikut ndaj mjedisit dhe ndaj aktivitetit ekonomiko-financiar, performancës së punës në përmbushje të rritjes së transparencës së institucionit me shërbimin ndaj publikut dhe forcimit të sistemit të Kontrollit të Brendshëm, lidhur me integritetin e punonjësve në zbatim të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar e Kontrollin", lidhur me zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë.

**Kriteret e vlerësimit:**
Në të gjitha fazat e auditimit, sipas programit të detajuar në përshtatje me Standardet e Auditimit dhe në referencë me problematikën, është pasur si kriter vlerësues në radhë të parë ligji nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"; ligji nr. 10440, datë 07.07.2011 "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis"; ligji nr. 10448, datë 14.07.2011 "Për lejet e mjedisit"; ligji nr. 10431, datë 09.06.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit" i ndryshuar; ligji nr. 10266, datë 15.04.2010 "Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja"; ligji nr. 10463, datë 22.9.2011 "Për menaxhimin e integruar te mbetjeve"; ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin"; ligji nr. 10081, datë 23.02.2009 "Për Licencat, Autorizimet dhe Lejet në Republikën e Shqipërisë" dhe VKM nr.3, datë 21.06.2006 "Për rehabilitimin e shtretërve dhe brigjeve të lumenjve, të dëmtuara nga shfrytëzimi i inerteve"; VKM nr. 1189, datë 18.11.2009 "Për rregullat dhe procedurat për hartimin dhe zbatimin e Programit Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit"; VKM nr. 13, datë 04.01.2013 "Për miratimin e rregullave të përgjegjësive e afateve për zhvillimin e procedurës së VNM"; VKM nr. 803, datë 04.12. 2003 "Për miratimin e normave te cilësisë se ajrit"; VKM nr.247, datë 30.04.2014 "Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimarrje mjedisore"; VKM nr.47, datë 29.01.2014 "Për Përcaktimin e Rregullave për Organizimin dhe Funksionimin e Agjencisë Kombëtare dhe Agjencive Rajonale të Mjedisit"; VKM nr. 229, datë 23.04.2014 "Për Miratimin e rregullave

për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme"; VKM nr. 419, datë 25.06.2014 "Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi tipi A; B; C, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga Autoritetet Kompetente, deri në lëshimin e këtyre nga QKL-ja", si dhe akte të tjera ligjore e nënligjore në ndryshim dhe zbatim të tyre.

## III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

Auditimi i Drejtorisë Rajonale të Mjedisit në Durrës ka një rëndësi të posacme pasi ky rreth ka portin më të rëndësishëm të vendit dhe një vijë detare të lakmuar nga shumë pushues sidomos gjatë stinës së verës. Ruajtja dhe mirëmbajtja e mjedisit të këtij rrethi lidhet me cilësinë e shërbimit dhe me numrin e frekuntuesve dhe përdoruesve të industrisë së turizmit dhe thithjes së turistëve të huaj, gjë e cila do të rriste të ardhurat tona kombëtare nga ky sektor i rëndësishëm.

**Objekti** i këtij auditimi është vlerësimi i aktivitetit të institucionit për përmbushjen e funksioneve në zbatim të ligjit nr. 10431, datë 09.06.2011 "Për mbrojtjen e Mjedisit"; ligjit nr.10448, datë 14.7.2011 "Për Lejet e Mjedisit" i ndryshuar; ligjit nr.10433, datë 16.06.2011 "Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë", ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 "Për kundërvajtjet administrative"; ligjit nr.10463, datë 22.09.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", me synim ruajtjen e mjedisit dhe pyjeve e për të siguruar: mirë përdorimin e resurseve dhe garantimin e sigurisë së jetës, veprimtarisë dhe aktivitetit të publikut nga kundërvajtjet në mjedis dhe nga pasojat e kësaj, përmbushjen e funksioneve rregullatore për leje mjedisi, monitorimin dhe vlerësimin e gjendjes së mjedisit (pjesë rajonale e përgatitjes së Programit Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit), kërkimet shkencore lidhur me mjedisin, botime e kërkime për zhvillimin e teknologjisë së informacionit etj; VKM nr. 47, datë 29.01.2014 "Për Përcaktimin e Rregullave për Organizimin dhe Funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe Agjencive Rajonale të Mjedisit", ku përveç sa më sipër DRM/ARM përmbushin funksionet si: dhënie leje mjedisore tipi (C), mbajtje dhe përditësim i regjistrit të dhënave, instalime Kategoria (C) në territorin juridiksional të përcaktuar në rregulloren "*Për organizimin dhe veprimtarinë e AKM dhe ARM-ve/DRM-ve*" e miratuar në datë 20.10.2014 nga Ministri i Mjedisit, si dhe përmbushjen e misionit të garantimit dhe respektimit të kërkesave ligjore në fushën e mbrojtjes së mjedisit, bazuar në 9 parimet e përcaktuara në Kreu II, neni 6-14 të ligjit nr. 10431, datë 09.06.2011 "*Për Mbrojtjen e Mjedisit*", të cilat i japin institucionit jo vetëm funksion ligjzbatues, por dhe funksion parandalues, këshillues, informues dhe edukues, për reagim të kulturuar të publikut ndaj mjedisit dhe ndaj aktivitetit ekonomiko-financiar, performancës së punës në përmbushje të rritjes së transparencës së institucionit me shërbimin ndaj publikut dhe forcimit të sistemit të Kontrollit të Brendshëm, lidhur me integritetin e punonjësve në zbatim të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar e Kontrollin", lidhur me zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë.

**Qëllimi** i auditimit është dhënia e opinionit dhe hartimi i raportit të auditimit mbi bazën e vlerësimeve të gjetjeve dhe dhënia e rekomandimeve për përmirësime të mëtejshme në punën e ardhshme të subjektit që auditohet.

**Fushëveprimi** i auditimit lidhet me aktivitetin e subjektit në dhënien e lejeve mjedisore dhe pëlqimeve mjedisore, bashkëpunimin ligjor me institucionet e tjera dhe gjithë shpenzimet buxhetore për periudhën e auditimit.

***Pika nr.1 e programit të auditimit: "Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm".***

Në zbatim të programit të auditimit u shqyrtua dokumentacioni i vendosur në dispozicion nga subjekti i audituar për sa më poshtë:
1-Shkresa përcjellëse e dërgimit të Raportit Përfundimtar të Auditimit.
2-Raporti Përfundimtar i Auditimit mbi veprimatarinë e DRM Durrës.
3-Shkresa përcjellëse, kthim përgjigje për marrje Raporti Përfundimtar dhe rekomandimet e dërguar brenda 20 ditëve.
4-Plan veprimi dhe programi i institucionit për realizimin e rekomandimeve në zbatim.
5-Shkresa përcjellëse, kthim përgjigje për marrje masa në zbatim të rekomandimeve e dërguar brenda 6/muajve.
Nga auditimi i dokumentacionit në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së në DRM Durrës me veprimtari periudha e audituar (01.01.2014 deri 31.12.2015) u konstatua se;
-Objekti i aktkonstatimit është: Verifikimi zbatimit të rekomandimeve të KLSH të dërguara me shkresë nr.1208/5, datë 31.03.2017 në mënyrë të përmbledhur paraqiten sa më poshtë:
*a-Për përmirësimin e gjendjes janë rekomanduar për zbatim gjithësej 20 masa organizative, nga të cilat 18 masa janë pranuar plotësisht, ndërsa 2 masa nuk janë pranuar.*
*b-Për masën shpërblim dëmi është rekomanduar arkëtimi i tarifës vjetore me vlerë 1.409.000 lekë me afat menjëherë, detyrim i subjekteve debitor që rrjedh nga mos pagesa e tarifës vjetore për leje mjedisi konkretisht;*
-nga 4 subjekte që disponojnë leje mjedisore tipi (A) vlera 40.000 lekë.
-nga 11 subjekte që disponojnë leje mjedi sore tipi (B) vlera 55.000 lekë.
-nga 657 subjekte që disponojnë leje mjedisore tipi (C) vlera 1.314.000 lekë.
Në total detyrimi debitor për periudhën 2014 e mbrapa është 1.409.000 lekë, ndërsa nga DRM Durrës është kërkuar të korrigjohet shuma prej 374.000 lekë, pra detyrim i pranuar është 1.035.000 lekë, shumë kjo e pa kontabilizuar e evidentuar në pasqyrat finaciare në periudhën raportuese dhe detyrime për subjektet debitorë në periudhat e audituara, por shlyerja e detyrimeve e tërheqja e faturës bëhet në 3/mujori I-rë periudha pasardhëse, në këto kushte detyrimi debitor është shuma 1.035.000 lekë. Nga verifikimi rezulton se;
*-Është rekomanduar nga KLSH vlera prej..........................................................1.409.000 lekë.*
*-Është kërkuar korigjim nga institucioni shuma prej.............................................374.000 lekë.*
*-Detyrimi i pranuar nga institucioni është shuma prej........................................1.035.000 lekë.*
*-Arkëtimi deri në datën e aktkonstatimit është shuma............................................(0) zero lekë.*
*-Vlera e pranuar debitore, por pa arkëtuar është shuma prej..............................1.035.000 lekë.*
*c-Janë rekomanduar "masa disiplinore" referuar neni 57; 58, germa"a"; 59 ligji nr.152/2013 "Për nëpunësi civil", ligji nr.9131, datë 08.09.2003 "Për rregullat e etikës në administratën publike", si dhe pika 11 të VKM nr.115, datë 05.06.2014 "Për përcaktimin e procedurs disiplinore dhe të* rregullave për krijimin përbërjen e vendimarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil", për 7 nënpunës masa disiplinore "Vërejtje".
DRM Durrës për masat e rekomanduara është mjaftuar me nxjerrje urdhëri, apo njoftimi, ndërsa për ndalesat nuk është bashkëpunuar me ISHMPU e nëpërmjet rrugës administrative për arkëtimin e vlerave të rekomanduara, për pasojë ndalesa nuk janë kryer duke u bërë përgjegjës për kalimin e afatit ligjor në kërkim të shpërblim dëmit, përcaktuar në neni 115 të Kodit Civil në RSH.
Më hollësisht auditimi i ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve paraqitet si vijon:
*1-Hartimi programit (Plan veprimit) dhe respektimi afatit 20 ditë për kthim përgjigje në zbatimin e rekomandimeve, parashikuar nga neni 15, gërma (j) e ligjit nr.154/2014, datë 27.11.2914 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit".*

Për respektimin e kërkesës së parashikuar nga verifikimi rezultoi se, në DRM Durrës nga KLSH-ja me shkresë nr.1208/5, datë 31.03.2016, janë dërguar rekomandimet e auditimit e protokolluar me nr.477 prot, datë 04.04.2016, ndërsa për rekomandimet institucioni ka kthyer përgjigje me shkresë nr.477/1, datë 22.04.2016 "Kthim përgjigje mbi auditimin dhe rekomandimet", duke raportuar në KLSH-në brenda afatit ligjor 20 ditë me pranim të rekomandimeve, ndërsa nuk ka hartuar planveprimi me program për zbatim dhe përsona që do ndjekin rekomandimin dhe afatet e zbatimit.

*2-Respektimi afatit ligjor 6/muaj nga data e marrjes së njoftimit të raportit të auditimit për raportimin në KLSH, në lidhje me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve e parashikuar nga neni 30, pika 2 e ligjit nr.154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".*

Për respektimin e kërkesës së parashikuar nga verifikimi rezultoi se, nga DRM Durrës nuk është respektuar afati 6/muaj, ose brenda datës 04.10.2016 për të raportuar në KLSH-ë, sepse në DRM Durrës nuk ka të administruar dokument për të raportuar mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6/muaj nga data e marrje së raportit të auditimit, veprim në mospërputhje me kërkesat parashikuar nga ligji nr.154/2014, datë 27.11.2914"Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", neni 30 "Rekomandimet e KLSH-së dhe ecuria e zbatimit", pika 2, ku përcaktohet qartësishtë se: Subjekti i audituar brenda 6/muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna. Për mos hartimin e programit me plan veprimi dhe për mos raportim brenda afatit ligjor 6/muaj në KLSH-ë, ngarkohet me përgjegjësi ish/Drejtori DRM Durrës..

3-Realizimi rekomandimeve sipas cilësimeve të subjektit të audituar, duke pasqyruar punën e bërë për rekomandimet e pranuara me analizë të hollësishme të realizuar plotësisht, pjesërisht, në proces, apo nuk janë pranuar rezulton për sa më poshtë;

**A. MASA ORGANIZATIVE.**

Për DRM Durrës nga KLSH-ja janë rekomanduar gjithësej 20 masa organizative, nga të cilat janë pranuar e zbatuar plotësisht 18 masa, ndërsa nuk janë pranuar e zbatuar 2 masa organizative. Në mënyrë të detajuar realizimi i masave organizative paraqitet si më poshtë:

***1-Rekomandimi*:** DRM Durrës të hartojë dhe dërgojë në AKM regjistrin kadastral mjedisor, dixhital elektronik për Qarkun, dokument i cili nëpërmjet shfrytëzimit të të dhënave konkrete të pasqyruara në lejet mjedisore i shërben AKM për marrjen e masave me qëllim që të evidentohet ndotja dhe dëmtimi i mjedisit dhe përbërësve të tij, me synim rritjen e cilësis së së jetës që qytetarëve për qarkun Durrës.

1.1-Nga verifikimi rezultoi se: DRM Durrës për këtë rekomandim, nuk ka marr masa për të hartuar regjistërin, si manual, apo dixhital elektronik për të shfrytëzuar të dhënat konkrete të pasqyruara në lejet mjedisore me synim rritjen e cilësisë së jetës të qytetarëve për qarku Durrës, pasi ky dokument nuk u vendos në dispozicion gjatë procesit të auditimit.

***Ky rekomandim është pranuar, ndërsa nuk është zbatuar.***

***2-Rekomandimi:*** *DRM Durrës të krijojë një (databazë) e cila të përditësohet me të dhënat nga subjektet përdorues dhe subjektet grumbulues të vajrave të përdorura me sasitë dhe llojin e tyre, si dhe me të dhënat e nga subjektet të cilat kryejnë përpunmin (riciklimin) dhe asgjësimin e tyre me synim mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetin e njeriut nga pasojat e dëmshme të shkaktuara nga shkarkimet, depozitimi, apo trajtimi i vajrave ë përdorur.*

2.1-Komente nga verifikimi rezultoi se: DRM Durrë për këtë rekomandim nuk ka marr masa në lidhje me krijimin "databazë" përkatëse me të dhënat nga subjektet përdorues dhe subjektet

grumbullues vajra të përdorura të ricikluar dhe të asgjësuar me sasitë dhe llojin e tyre, pasi ky dokument nuk u vendos në dispozicion gjatë procesit të auditimit.
***Ky rekomandim është pranuar, ndërsa nuk është zbatuar.***
***3-Rekomandimi:*** DRM Durrës me qëllim mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit të njeriut nga ndikimet negative të ujërave të ndotura, të evidentojë subjektet, veprimtaria e të cilave shkaktojnë ndotje të ujerave mbi normat e lejuara si dhe të përcaktojë në kushtet e lejes së mjedisit të tipit C, mjedisin pritës ku do te derdhen ujërat e pastruara dhe regjimin e derdhjes së tyre (depuratorët e pastrimit përkatës), kërkesat për trajtimin mjedisor të llumrave, që rezultojnë nga trajtimi i ujërave të ndotura, në përputhje me natyrën, përbërjen dhe sasitë e tyre, mbajtjen e regjistrave si dhe kryerjen e monitorimit dhe publikimin e rezultateve të tij.
3.1-Komente nga verifikimi rezultoi se: DRM Durrë në lidhje me këtë rekomandim nuk ka marr masa dhe nuk ka bërë evidentimin e subjekteve që shkarkojnë ujra të përdorura, apo ujra industrialë, ndërsa është mjaftuar me përpilimin e raporteve të vetmonitorimit të sjella nga vetë subjektet. Nuk rezulton të jetë kërkuar verifikim nga laboratori i AKM.
***Ky rekomandim është pranuar, ndërsa nuk është zbatuar.***
***4-Rekomandimi***: DRM Durrës nga specialistja e financës të hapen librat e kontabilitetit dhe të kryejë regjistrimin e shpenzimeve sipas klasifikimit dhe kapitujve, titujve, si dhe ditarët analitik, libri i madh apo centralizatori, në zbatim të pikës 100 e 101, Kapitulli II të UMF nr. 2, datë 06.02.2012 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit".
4.1-Komente nga verifikimi rezultoi se: DRM Durrë për këtë rekomandim, specialisti i ngarkuar me financë nuk ka marr masa, sepse nuk është hap libri kontabilitetit, regjistrimi shpenzimeve sipas klasifikimit në kapituj, tituj, artikull nuk janë pasqyruar dhe evidentuar në ditarë analitik, libri madh, apo centralizator, pasi nuk u vendosën në dispozicion në auditim.
***Ky rekomandim është pranuar, ndërsa nuk është zbatuar.***
***5-Rekomandimi:*** DRM Durrës të marr masa për saktësimin e adresave dhe të njoftojë të 672 subjektet nga të cilët:
*-4 subjekte me leje Mjedisore tipi (A).*
*-11 subjekte me leje Mjedisore tipi (B).*
*-657 subjekte me leje Mjedisore tipi (C), të cilët nuk kanë bërë pagesën e tarifës vjetore sipas* kërkesave ligjore të përcaktuara dhe në kushtet e lejeve të Mjedisit. DRM Qarku Durrës të marr masa që subjektet të cilët ushtrojnë aktivitetin e tyre dhe janë të pajisur me Leje Mjedisi Tipi (A; B; C) të paguajnë tarifën vjetore brenda 3/mujori I-rë të vitit.
***5.1-Komente nga verifikimi rezultoi se:*** DRM Durrës për zbatimin e rekomandimit, vetëm ka bërë evidentimin e subjekteve dhe rishikimin e pagesës së tarifës vjetore për leje mjedisi dhe ka bashkëpunuar me ISHMP Durrës vetëm në një rastë me shkresën nr.1779, datë 21.11.2016 me të cilën ka kërkuar arkëtimin e detyrimit, ndërsa deri në momentin e auditimit nuk ka arkëtim.
***Ky rekomandim është pranuar pjesërisht me korigjim, ndërsa nuk është zbatuar.***
***6-Rekomandimi:*** DRM Durrës dhe specialistja e Financës të marr masat që hyrjet e daljet e mallrave e materialeve në magazinë të bëhen sipas rregjistrit të aktiveve të njësisë në sektori publik, të hapet libri magazinës e kartelat, si dhe çdo dalje e materialeve të shoqërohet me urdhër veprimi.
***6.1-Komente nga verifikimi rezultoi se:*** DRM Durrë për këtë rekomandim, specialisti financës vetëm ka hapur librin e magazinës, ndërsa veprimet në këtë libër malli i regjistruar hyrje mënjëherë është rregjistruar edhe në dalje si shpenzim, ku lëvizja e mallit nuk është shoqëruar në asnjë rast me urdhër veprimi nga nëpunësi autorizues.
***Ky rekomandim është pranuar, ndërsa nuk është zbatuar.***

***7-Rekomandimi:*** DRM Durrës të hartojë programin dhe të ndjekë hapat e duhur ligjor për ngritjen dhe instalim sistemi MFK. Të ngrihen strukturat për të përcaktuar përgjegjshmërinë menaxheriale të punonjësve kryesorë për qëllimet strategjike dhe prioritetet e institucionit të DRM-së, të përcaktohen procedurat standarde për dokumentimin, ruajtjen, qarkullimin dhe nxjerrjen nga përdorimi të aktiveve në këtë njësi publike. Të ngrihet grupi për menaxhimin strategjik, si dhe të çohen për trajnim pranë M.Financës, në zbatim të nenit 27/2 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin".
7.1-Komente nga verifikimi rezultoi se: DRM Durrës për këtë rekomandim nuk ka kryer veprime për të ngritur struktura me grup për të përcaktuar përgjegjshmërinë menaxheriale, duke përcaktuar procedurat standarde për dokumentim, ruajtje dhe qarkullim të aktiveve dhe nuk kryer asnjë trajnim pranë M.Financës, pasi nuk u vendosën në dispozicion programe.
***Ky rekomandim është pranuar, ndërsa nuk është zbatuar.***
**8-Rekomandimi:** DRM Durrës të bëjë azhornimin dhe regjistrimin e dokumentacionit të veprimeve kontabël për vitin 2014 dhe 2015, duke mbajtur ditarët analitikë, librin e madh, ditarin e bankës për të kryer kontabilizimin e llogarive. Bilanci kontabël të nxirret duke mbajtur dhe krahasuar me pasqyrat financiare vjetore të vitit ushtrimor në fund të vitit.
8.1-Komente nga verifikimi rezultoi se: DRM Durrë për këtë rekomandim, specialisti financës nuk është marr masa, sepse ky rekomandim është i barasvlefshëm me rekomandimin nr.4, në të ciln është evidentuar se librat e kontabilitetit nuk janë hapur.
***Ky rekomandim është pranuar, ndërsa nuk është zbatuar.***
**9-Rekomandimi:** Titullari i institucionit t'i kërkojë AKM-së, për të legjitimuar dhe miratuar Rregulloren e Brendshme, e cila aktualisht është vetëm një draft Rregullore.
9.1-Komente nga verifikimi rezultoi se: DRM Durrë për këtë rekomandim, AKM-ja ka hartuar "Rregulloren e Brendshme" e cila ka të detajuar e psqyruar detyrat e detyrimet, për të gjitha strukturën organizative të DRM-ve.
***Ky rekomandim është pranuar dhe zbatuar.***
**10-Rekomandimi:** DRM Durrës të marr masat që të gjitha dosjet e personelit të plotësohen me dokumentacion origjinal, apo fotokopje të noterizuara, duke bërë inventarizim të tyre.
10.1-Komente nga verifikimi rezultoi se: DRM Durrë për këtë rekomandim,specialisti i ngarkuar për personelin ka plotësuar dosjet e personelit me dokumentacion origjinal, apo fotokopje të noterizuar dhe të inventarizuara me dokumetacionin në dosjen personale.
***Ky rekomandim është pranuar dhe zbatuar.***
11-Rekomandimi: Njësia e Prokurimit e blerjeve me vlera të vogla në DRM Durrës, të marr masa për përllogaritjen e saktë të fondit limit, në përputhje me bazën ligjore të prokurimeve.
11.1-Komente nga verifikimi rezultoi se: DRM Durrë për këtë rekomandim, specilaiti financës ka hartuar regjistrin e parashikimit dhe realizimit të prokurimit publik me përllogaritje për vlerën limit të njoftimit të kontratë për shpenzime në përputhje me legjislacionin e prokurimit.
***Ky rekomandim është pranuar dhe zbatuar.***
12-Rekomandimi: DRM  Durrës të marr masa që çdo fillim viti dhe për gjatë, duke ngritur komisionin për kolaudimin e marrje në dorëzim të mallrave, punëve e shërbimeve, në zbatim me pikat 42, 43, 52 dhe 60 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik".
12.1-Komente nga verifikimi rezultoi se: DRM Durrë për këtë rekomandim, ka ngritur komision për marrje në dorëzim të mallit, punë e shërbime dhe kolaudim.
***Ky rekomandim është pranuar dhe zbatuar.***
13-Rekomandimi: DRM Durrës të ndërmarrë masa për kryerjen e inspektimin e kontrolleve të përbashkëta, duke hartuar plane pune, programe kontrolli me organet e tjera të kontrollit në

përputhje me ligjin nr.10431, datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, Kreu II “Parimet e mbrojtjes së Mjedisit”, neni 11 “Parimi përgjegjësisë së ndërsjellë e bashkëpunimit”, pika 1.
13.1-Komente nga verifikimi rezultoi se: DRM Durrë për këtë rekomandim, nuk ka marr masa për të krijuar komision të përbashkëta për inspektimet që do kryhen, vetëm ka komunikuar me shkresa zyrtare me institucione si, Bashkia Durrës, ISHMP Durrës, subjekti “Somet” e Nd.Shërbimeve Komunale, ndërsa prej tyre nuk ka kthim përgjigje.
***Ky rekomandim është pranuar, ndërsa është zbatuar pjesërishtë.***
14-Rekomandimi: DRM Durrës në bashkëpunim me Drejtorin Rajonale Tatimore Durrës, tu kërkojë të gjitha studiove dhe ekspertëve fizikë që kanë hartuar Raporte VNM të paraqesin një fotokopje të faturave tatimore dhe kuponit tatimor të këtij shërbimi. DRM Durrës gjatë shqyrtimit të dosjeve për dhënie mendimi për subjektet që aplikojnë për tu pajisur me leje Mjedisi tipi (A) dhe (B) të kërkojë për çdo rast që bashkëngjitur Raportit të VNM të jetë fatura dhe kuponi tatimor.
14.1-Komente nga verifikimi rezultoi se: DRM Durrë për këtë rekomandim, ka komunikuar me shkresë zyrtare me Agjencinë Kombëtare të Mjedisit e Drejtoria e Financës në Ministrinë e Mjedisit, ndërsa nuk ka konsideruar ligjore kërkesën për të paraqitur nga subjektet dokumente finaciare tatimore të ekspertëve mjedisorë të certifikuar.
***Ky rekomandim nuk është pranuar dhe nuk është zbatuar.***
**15-Rekomandimi:** DRM Durrës të marr të gjitha masat për shqyrtimin në mënyrë objektive dhe korrekte të gjitha kërkesat e subjekteve që kërkojnë të pajisen me leje Mjedisi Tipi (C) të plotësojnë formularin informues sipas kërkesave ligjore në fuqi dhe të plotësojnë dosjen e aplikimit me të gjithë dokumentacionin përkatës dhe mbështetës në lidhje me aktivitetin që do të ushtrojnë.
**16-Rekomandimi**: DRM Durrës në shqyrtimin e lejeve Mjedisore Tipi (C) të përdorë kushte dhe kërkesa të njëjta për plotësimin e informacionit të deklaruar nga subjekti që aplikon për leje Tipi (C) të vendosë rregulla për dokumentacionin shtesë që subjektet duhet të kenë në dosjen e aplikimit gjë që të cilat do të vërtetojnë saktësinë e të dhënave që plotësohen në formularin informues pa bërë dallime dhe diferencime për plotësimin sipas kërkesave të kuadrit rregullator në fuqi.
***15-16.1-Komente nga verifikimi rezultoi se***: DRM Durrës për këto rekomandime në shqyrtimin e lejes mjedisore tipi (C) është vepruar sipas akteve ligjore, për të shqyrtuar dokumentacionin përkatës për lejen, ndërsa janë plotësuar formular informues për shqyrtimnë lejet mjedisore.
***Ky rekomandim është pranuar, ndërsa është në proces zbatimi.***
**17-Rekomandimi:** DRM Durrës të evidentojë të gjitha lejet tipi (C) të dhëna në periudhën (korrik-nëntor) dhe të njoftojë subjektet për përfshirjen e detyrimit ligjor që kanë për tarifën vjetore sipas kërkesave të VKM nr. 417, datë 25.06.2014 “Për miratimin e tarifave të lejeve të mjedisit”.
17.1-Komente nga verifikimi rezultoi se: DRM Durrë për këtë rekomandim, ka evidentuar të gjitha lejet mjedisore tipi (C) të dhëna në periudhën (korrik-nëntor) dhe ka njoftuar subjektet për përfshirjen e detyrimit ligjor e reflektuar kjo edhe me arkëtimin e detyrimeve.
***Ky rekomandim është pranuar, ndërsa është në proces zbatimi.***
**18-Rekomandimi:** DRM Durrës të bashkëpunojë me ISHMPU Durrës për gjendjen aktuale të subjekteve që ushtrojnë aktivitetin e tyre dhe të pajisura me lejet mjedisore të tipti (A), (B), (C), (LM) dhe (AM) të verifikojnë aktivitetin që kryen subjekti dhe nëse ky aktivitet bën pjesë i parashikuar në Shtojca 1 e ligjit nr.10448, datë 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit”.

18.1-Komente nga verifikimi rezultoi se: DRM Durrë për këtë rekomandim, ka komunikuar me shkresë zyrtare me ISHMP qendër dhe ISHMPU dega Durrës,akoma nuk ka marr zgjidhje.
***Ky rekomandim është pranuar, ndërsa është në proces zbatimi.***
**19-Rekomandimi**: DRM Durrës nëpërmjet Specialistit të Monitorimeve të marrin masat e duhura për të njoftuar subjektet në lidhje me vetë monitorimet e përcaktuara në kushtet e lejes Mjedisore dhe të rrisin bashkëpunimin institucional për koordinimin dhe realizimin e detyrave të cilët janë përgjegjës në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi.
19.1-Komente nga verifikimi rezultoi se: DRM Durrë për këtë rekomandim, ka përditësimin e (databazë) së subjekteve të pajisura me leje mjedisore dhe pas verifikimit të hollësishëm të statusit të tyre në QKR ku janë nxjerrë subjektet që nuk figurojnë aktivë është bërë njoftimi i tyre për plotësimin e detyrimeve ligjore që kanë të bëjnë me vetmonitorimin.
***Ky rekomandim është pranuar, ndërsa është në proces zbatim.***
20-Rekomandimi: DRM Durrës, Specialisti monitorimeve në përputhje me kërkesat dhe detyrat e përcaktuara nga kuadri rregullator të marr masa për plotësimin e regjistrit të shkarkimeve e transferimit të ndotësve në mënyrë korrekte, në mënyrë që të kemi një situatë të gjendjes së mjedisit me të dhënat e shkarkimeve në tokë, ujë dhe ajër.
20.1-Komente nga verifikimi rezultoi se: DRM Durrë për këtë rekomandim, ka hartuar regjistërin e shkarkimit e transferimit të ndotësve në formë elektronike (excel) me 18 aktivitete.
***Ky rekomandim është pranuar dhe zbatuar.***

## B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI.

-Rekomandim: DRM Qarkut Durrës të kryej kontabilizimin dhe të kërkojë në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin e arkëtimit të tarifës vjetore që rezulton e pa paguar nga 672 subjekte në shumën 1,409,000 lekë si më poshtë:
*-4 subjekte që disponojnë lejen e mjedisit të tipit A në vlerën totale 40,000 lekë.*
*-11 subjekte që disponojnë lejen e mjedisit të tipit B në vlerën totale 55,000 lekë.*
*-657 subjekte që disponojnë lejen e mjedisit të tipit C në vlerën totale 1,314,000 lekë.*
-Komente nga verifikimi rezultoi se: Për këtë rekomandim DRM Durrës nuk ka kryer asnjë procedurë filluar me kontabilizimin e vlerës detyrimit, si dhe nuk ka ndjekuar asnjë në rrugë ligjore dhe asnjë procedur administrative bashkëpunimi për të kërkuar arkëtimin e tarifës vjetore detyrim nga 672 subjekte në shumën prej 1,409,000 lekë.
***Ky rekomandim është me rishikim, ndërsa nuk është zbatuar.***

## C. MASA DISIPLINORE.

-Mbështetur në nenin 58 "llojet e masave disiplinore", të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", nenit 57, nenit 59 të ligjit, gjithashtu mbështetur në pikën 11 të VKM nr. 115, datë 05.063.2014 "Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin disiplinor në shërbimin civil", si dhe ligjin nr. 9131, datë 8.9.2003 "Për rregullat e etikes në administratën publike" i rekomandojmë Titullarit direkt të filloj procedurat për dhënien e masës disiplinore:
-"Vërejtje" neni 58, germa (a) për punonjësit:
*1. znj. S.V.*
*2. znj. B.C.*
*3. znj. E.Z.*
*4. znj. M.S.*
*5. z. E.V.*
*6. znj. A.B.*
*7. z. B.Gj.*

***-Komente nga verifikimi rezultoi se:*** DRM Durrës për këtë rekomandim, Titullari direkt i institucionit ka nxjerrë urdhrërat përkatës për 7 punonjësit për masën disiplinore "Vërejtje".
***Ky rekomandim është pranuar dhe zbatuar.***
Në përfundim si konkluzion në mënyrë të përmbledhur rezultoi se; zbatimi rekomandimeve në auditimin e mëparshëm nga DRM Durrës paraqitet për sa më poshtë;

| Nr | Masat e Rekomanduara | Të rekomanduara (22 masa) | | | Total | Procedura e zbatimit (22 masa) | | | | Total |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Pa pranuar | Pjesërisht ë | Të pranuara | | Realizua | Pjesërishtë | Pa realizuar | Në proces | |
| 1 | Organizarive | 1 | 1 | 18 | 20 | 5 | 2 | 9 | 4 | 20 |
| 2 | Shpërblim Dëmi | = | = | 1.409.000 | 1 | = | = | 1.409.000 | = | 1 |
| 3 | Disiplinore | = | = | 7 punonjës | 1 | 7punonjë | = | = | = | 1 |
| | Nr.Rekomandime | 1 | 1 | 20 | 22 | 6 | 2 | 10 | 4 | 22 |

Të dhënat në tabelë tregojnë se, rekomandimet që i përkasin masave organizative, shpërblim dëmi dhe disiplinore të dërguara në DRM Durrës konkretisht; 1 masë nuk është pranuar; 1 masë është pranuar pjesërishtë dhe 20 masa janë pranuar plotësisht, ndërsa për zbatimin rezulton se; 6 masa janë realizuar plotësisht; 2 masa pjesërisht; 10 masa nuk janë realizuar përfshirë shpërblim dëmi në vlerën 1.409.000 lekë, ndërsa 4 masa janë në proces realizimi.

*Për Projektraportin e Auditimit nga subjekti i audituar me shkresë nr.598/2 prot, datë 23.04.2019 e protokolluar në KLSH[ë] me nr.1275/3 prot, datë 23.04.2019, si dhe nëpërmjet postës elektronike në adresën (vrisvani@klsh.org.al) janë dërguar dhe paraqitur shpjegime me observacion për sa i përket trajtimit në projektraport, në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm me analizë cdo masë e rekomanduar, duke kundërshtruar trajtimin e kryer për zbatimin e rekomandimeve. Këto shpjegime janë kopje e përsëritur të pa ndryshuara ashtu si edhe ishte shpjeguar e kundërshtuar për trajtimin e bërë në Aktkonstatim. Për kundërshtimet e dërguara nga subjekti i audituar DRM Durres* ***Sqarojmë se:***
***-së pari****; kundërshtimet janë kopje të pa ndryshara për sa është shpjeguar në trajtimin në aktkonstatim e mbajtur, për pasojë për këto shpjegime është kryer sqarim për këtë qëllim.*
***-së dyti;*** *të gjitha shpjegimet nuk kanë mbështetje e argumenta ligjore, ndërsa ato janë vetëm justifikime megjithëse rekomandimet e lëna në auditimin e mëparshëm janë të pranuara, ndërsa për zbatimin Titullari KLSH[së] ka dalë me vendimmarrje të veçantë sa janë zbatuar këto rekomandime deri në këtë periudhë auditimi. Në këto kushte kundërshtimet e dërguara nuk merren në konsideratë dhe rekomandimet do trajtohen përsëri në Raportin Përfundimtar të Auditimit, si detyrime për tu zbatuar në periudhën pasardhëse.*

-Nga shqyrtimi evidencës së grumbulluara për efekt të njohjes së veprimtarisë subjektit për periudhën e audituar dhe vlerësimit të riskut në situata sipas drejtimeve në zbatim të programit për auditimin u shqyrtua dokumentacioni i vënë në dispozicion (Letrat e punës) nga subjekti i audituar sa më poshtë:
1-Projekt buxheti, evidencat e treguesve të realizimit të planit të buxhetit me detajime në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën/artikulli.
2-Pasqyrat financiare (bilanci kontabël) për periudhën raportuese (01.01.2017-31.12.2017) dhe periudhat periodike (01.10.2016-31.12.2016); (01.01.2018-01.10.2018) objekt i auditimit.
3-Ditari veprimeve të kryera nëpërmjet bankës dhe veprimeve të ndryshme.
4-Urdhër shpenzimet për pagesat e likuiduara, nëpërmjet veprimeve me bankë për periudhat raportuese objekt auditimi (01.10.2016 deri 01.10.2018) me dokumentat shoqëruese justifikuese bashkëlidhur me pagesën e kryer.
5-Urdhëra të brendshëm të nxjerra nga titullari për kryerjen e inventarizimit fizik të aktiveve, pasurisë publike e vlerave materiale dhe për nxjerrje jashtë përdorimi dhe asgjësimi tyre.

6-Përmbledhëse e inventarëve fizike të aktiveve, pasurisë publike e vlerave materiale për periudhat raportuese objekt auditimi (01.10.2016 deri 01.10.2018).
7-Listë pagesat, libri i pagave, shkresat e emërimit dhe fotokopja e dosjes së personelit, etj.
(*Për sa është trajtuar më sipër në pikën nr.1 të programit të auditimit u mbajt Aktkonstatimi nr.1, datë 11.01.2019*).

**Pika nr.2 e programit të auditimit: "Mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit".**

Nga auditimi procedurave mbi hartimin e zbatimin e buxhetit të shtetit në njësinë shpenzuese DRM Durrës u konstatua sa më poshtë;

*-Mbi respektimin e procedurave për hartimin dhe zbatimin e buxhetit.*

Për periudhat raportuese (01.10.2016; 2017 deri 30.10.2018) objekte të auditmit, mbi bazën e kërkesave dhe nevojave për shpenzime operative koherente të dërguar nga DRM Durrës, AKM ka hartuar shtojcën 1/A të pasqyrës nr.1, me parashikimin e të ardhurave të veta dhe të shpenzimeve me programin (05320) i dërguar nëpërmjet postës elektronike (mail) në MMT me objekt; Projekt/buxheti (2015-2017); Projekt/buxheti (2016-2018); Projekt/buxheti (2017-2019) dhe Projekt/buxheti (2018-2020) me tregues të miratuar nga MMT brenda afateve dhe kritereve të përcaktuara në ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", si edhe në udhëzimet përkatësë të M.Financave me tregues të njëjtë të pa ndryshuar nga periudhat parardhëse.

*-Mbi zbatimin e krirtereve në celjen dhe detajimin e plan planit fillestar të buxhetit në nivel titulli, kapitulli, artikulli, nën/artikulli dhe respektimi i disiplinës buxhetore sipas strukturës buxhetore dhe burimeve të financimit.*

Nga auditimi i dokumentacionit mbi hartimin, miratimin dhe realizimin e buxhetit të njësisë shpenzuese për periudhat objekt auditimi (30.10 deri 31.12.2016); (01.01 deri 31.12.2017); (01.01 deri 30.10.2018) rezultoi se, programimi dhe realizimi shpenzimeve është bërë në nivel titull, kapitull, artikull e nën/artikull në mënyrë analitike sa më poshtë;

*Tabela nr.1*

*000/lekë*

| *Nr* | *Emërtimi* | *Periudha 2016* | | *Periudha 2017* | | *Deri 30.10.2018* | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | *Plan* | *Fakt* | *Plan* | *Fakt* | *Plan* | *Fakt* |
| 1 | Llog.(600) "Paga e shperblime" | 8.100 | 7.861 | 8.000 | 6.929 | 8,500 | 3,772 |
| 2 | Llog.(601) "Kontribute Sig.Shoq shende" | 1.380 | 1.313 | 1.400 | 1.160 | 1,000 | 647 |
| 3 | Llog.(602) "Shp.operative" | 500 | 414 | 300 | 250 | 250 | 210 |
| | Totali | 9.980 | 9.587 | 9.700 | 8.339 | 10,250 | 4,630 |

*Shënim: Të dhënat janë disponuar nga specialisti Financës.*

Të dhënat në tabelë pasqyrojnë buxhetimin e fondeve për shpenzime në periudhat raportuese objekt auditimi (01.10.2016 deri 30.10.2018) në dispozicion të njësisë shpenzuese me vlera të njëjta dhe të ulëta në pa mjaftueshmëri për realizimin e objektivave dhe strategjisë për ruajtjen e mjedisit.

*-Miratimi dhe realizimi i plan buxhetit për periudhën e plotë raportuese viti 2016.*

Për këtë periudhë raportuese Ministria e Mjedisit me shkresë nr.162/1 port, datë 13.01.2016 dhe shkresë nr.2750/1, datë 12.05.2016 ka dërguar detajimin e shpenzimeve koherente të buxhetit së bashku me shtesat me detajim limiti mujor, në zbatim ligjit nr.147/2015, datë 17.12.2015 "Për buxhetin e vitit 2016" dhe UMF nr.2, datë 06.02.2012 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit" shpenzime të miratuara nga MF, sipas natyrës pasqyrohen sa më poshtë;

*Tabela nr.2*

*në 000/lekë*

| *Periudha raportuese 2016* | *Llogarit e analizuara* | | | | *Totali* |
|---|---|---|---|---|---|
| | *Llog. 600* | *Llog. 601* | *Llog. 602* | *Llog.606* | |
| Programimi | 2.800 | 450 | 500 | = | 3.750 |
| Shtesa të alokuara | 5.300 | 930 | = | = | 6.230 |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| Totali 2016 | 8.100 | 1.380 | 500 | = | 9.980 |
| Celja nga Buxheti | 8,100 | 1,380 | 500 | = | 9,980 |
| Realizimi i Shpenzimeve | 7.861 | 1.313 | 414 | = | 9.587 |
| Realizimi në % | 97 | 95 | 92 | = | 96 |

*Shënim: Të dhënat janë disponuar nga specialisti Financës.*

Të dhënat në tabelë pasqyrojnë me analizë, realizimin e fondeve të alokuara në masën 96%, ku me realizim të ulët paraqitet fondi destinuar për shpenzime llog.(602) me 92%. Fondet e çelura nga Dega e Thesarit janë përdorur sipas destinacioneve përkatëse, ndërsa nuk u konstatuan shpenzime me ndryshim e tejkalim limiti.

-Miratimi dhe realizimi i plan buxhetit për periudhën raportuese 2017.

Për këtë periudhë raportuese Ministria e Mjedisit me shkresë nr.536 port, datë 24.01.2017 dhe shkresë nr.8516/5, datë 26.01.2017 ka dërguar detajimin e shpenzimeve koherente të buxhetit së bashku me shtesat me detajim limiti mujor, në zbatim të ligjit nr.130/2016, datë 17.12.2016 "Për buxhetin e vitit 2017" dhe UMF nr. 2, datë 06.02.2012 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit", shpenzime të miratuara nga MF sipas natyrës pasqyrohen sa më poshtë;

*Tabela nr.3*

*në 000/lekë*

| ***Periudha raportuese 2017*** | ***Llogarit e analizuara*** | | | ***Totali*** |
|---|---|---|---|---|
| | ***Llog. 600*** | ***Llog. 601*** | ***Llog. 602*** | |
| Programimi | 2.700 | 500 | = | 3.200 |
| Shtesa të alokuara | 5.300 | 900 | 300 | 6.500 |
| Totali 2017 | 8.000 | 1.400 | 300 | 9.700 |
| Celja nga Buxheti | 8,000 | 1,400 | 300 | 9,700 |
| Realizimi i Shpenzimeve | 6.929 | 1.160 | 250 | 8.339 |
| Realizimi në % | 87 | 83 | 83 | 86 |

*Shënim: Të dhënat janë disponuar nga specialisti Financës.*

Të dhënat në tabelë pasqyrojnë me analizë, realizimin e fondeve të alokuara në masën 86%, ku me realizim të ulët paraqitet fondi destinuar për shpenzimet në paga, kontributi sigurmeve dhe operative me 83%. Fondet e çelura nga Dega e Thesarit janë përdorur sipas destinacioneve përkatëse, ndërsa nuk u konstatuan shpenzime me ndryshim e tejkalim limiti.

-Miratimi dhe realizimi i plan buxhetit për periudhën raportuese deri 30.10.2018.

Për këtë periudhë raportuese Ministria e Mjedisit me shkresë nr. 1276 port, datë 15.02.2018 ka dërguar detajimin e shpenzimeve koherente të buxhetit së bashku me shtesat me detajim limiti mujor, në zbatim të ligjit nr.109/2017, datë 30.11.2017 "Për buxhetin e vitit 2018" dhe UMF nr.2, datë 06.02.2012 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit" dhe Udhëzimi plotësues nr.2, datë 19.01.2018 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2018", shpenzime të miratuara nga MF sipas natyrës së shpenzimit pasqyrohen më poshtë.

*Tabela nr.4*

në 000/lekë

| ***Periudha raportuese deri 30.10.2018*** | ***Llogarit e analizuara*** | | | ***Totali*** |
|---|---|---|---|---|
| | ***Llog. 600*** | ***Llog. 601*** | ***Llog. 602*** | |
| Programimi | 8.500 | 1.500 | 250 | 10.250 |
| Shtesa të alokuara | = | = | = | = |
| Totali 2018 | 8.500 | 1.500 | 250 | 10.250 |
| Celja nga Buxheti | 8,500 | 1,500 | 250 | 10,250 |
| Realizimi Shpenzimeve deri 30.10.18 | 3,772 | 647 | 210 | 4,629 |
| Realizimi në % | 45 | 44 | 90 | 46 |

*Shënim: Të dhënat janë disponuar nga specialisti Financës.*

Të dhënat në tabelë pasqyrojnë me analizë, realizimin e fondeve të alokuara periudha 10/muaj në masën 46%, ku realizimi është në nivelin nën ½ e fondit të alokuar me tregues mjaft të ulët paraqitet fondi i destinuar për pagat dhe kontributi sigurime shoqërore e shëndetsore me 44%, në të cilin ka ndikuar organika e pa plotësuar me 4 vende vakant i pa evidentuar ky ndikim. Fondet e çelura nga Dega e Thesarit janë përdorur sipas destinacioneve përkatëse, ndërsa nuk u konstatuan shpenzime me ndryshim e tejkalim limiti.

-Rakordimet periodike të kryera me degën e thesarit.
Gjatë zbatimit të buxhetit për periudhat raportuese objekt i auditimit (30.10 deri 31.12.2016); (01.01 deri 31.12.2017); (01.01 deri 30.10.2018) janë bërë ndryshime (shtesa e pakësime). DRM Durrrës ka rakorduar me dega e thesarit çdo muaj, mbështetur në udhëzimet e Ministrisë Financave për zbatimin e treguesve buxhetit për vite ushtrimore, ndërsa realizimi shpenzimeve i dokumentuar nën/artikuj llog.(602) “Shpenzime operative” pasqyrohet sa më poshtë:
*Tabela nr.5*

në 000/lekë

| *Nr* | *Emërtimi* | *Për vitin 2016* | *Periudha 2017* | *Deri 30.10.2018* |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Kancelari | 58 | 99 | 0 |
| 2 | Shpenzime materiale pastrami e shërbimi | 50 | 10 | 0 |
| 3 | Shpenzime për tonera | 99 | 97 | 42 |
| 4 | Shpenzime për telefoni dhe internet | 34 | 0 | 34 |
| | Shpenzime mirmb paisje | 35 | 0 | 0 |
| 5 | Shpenzime energji elektrike | 69 | 0 | 77 |
| 6 | Shpenzime Postare dhe korrieri | 69 | 44 | 57 |
| | Totali | 414 | 250 | 210 |

*Shënim: Të dhënat janë disponuar nga specialisti i Financës.*

Të dhënat në tabelë pasqyrojnë me analizë, alokimin dhe realizimin e fondeve në llog.(602) “Shpenzime operative” në nivel artikull e nën/artikull, të cilat të krahasuara për tre periudhat nuk kanë ruajtur të njëjtin nivel realizimi, pasi janë vetëm në ulje shpenzimi. Njëkohësishtë konstatohet se, DRM Durrës është akomoduar në ndërtesë pronë ISHMPU, ndërsa në periudhë raportuese 2017 ka kryer pagesë për konsum të energjis elektrike, pagesë e cila duhet të kryhet vetëm nëpërmjet matësit të energjisë, apo kontratës së lidhur, për pasojë pagesa për energji elektrike të konsumuar, nuk duhet të likujdohet nga DRM Durrës pa instaluar matës elektrik.
U bë krahasimi pasqyrave financiare për të ardhurat dhe shpenzimet nëpërmjet aktrakordimit, ndërsa nuk u konstatuan deviacione.

*Në përfundim të auditimit me analizë arrihet në konkluzionin se;*
*DRM Durrës ka hartuar projektbuxhete vjetore, vetëm me tregues sasiorë të nevojave për periudhë afatmesme 3/vjeçare për shpenzime dhe të ardhura që do realizojë si pjesë e programit të PBA, kuota të dërguara nga AKM dhe të përcjella në Ministrinë e Mjedisit. Hartimi dhe zbatimi buxhetit vjetor është bërë në përputhje me ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republika e Shqipërisë”; UMF nr.2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, si dhe udhëzimet vjetore përkatëse të buxhetit.*
*Nga realizimi fondeve të alokuara për njësinë shpenzuese DRM Durrës rezultoi se;*
*a-fondet buxhetore janë në kushtet e pamjaftueshmërisë për realizimin e funksioneve të Institucionit, sepse ka mungesa në investime kryesisht për automjete për lëvizjen e specialistëve për kontrollin e subjekteve që pajisen me leje mjedisore në teritorin e qarkut në juridiksion.*
*b-ka fonde të munguara për shpenzime bazë të detajuara si, pagesa për udhëtime të specialistët në territoret që kanë kompetencë për të ushtruar verifikimet e nevojshme për subjektet e pajisura me leje mjedisore.*
*c-ka fonde të munguara për shpenzime të detajuara për fotokopje dokumenta evidentuese, të domosdoshme dhe pjesë e procedurave për paisjen me leje mjedisore tipi (C), apo për dhënie mendime në VNM në lejet tipi (A) dhe (B) të subjekteve aplikuese.*

***Pika nr.3 e programit të auditimit: "Krijimi dhe përdorimi të ardhurave që realizon institucioni. Burimet e krijimit të të ardhurave. Mbledhja e të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore. Auditim mbi përdorimin e të ardhurave nga institucioni".***

*-Krijimi dhe përdorimi të ardhurave që realizon institucioni.*

DRM Durrës është institucion rajonal publik në varësi të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit me objekt mbrojtjen e mjedisit, ndërsa organizimi dhe funksionimi i saj bazohet në VKM nr. 47, datë 29.01.2014 "Për përcaktimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit e të agjencive rajonale të mjedisit". Nga auditimi për periudhat raportuese viti 2016; 2017 deri 30.10.2018 rezulton se, të ardhurat janë krijuar vetëm nga pagesa e tarifës së lejes mjedisore tipi (C), në referim të ligjit nr.10448, datë 27.04.2011 "Për lejet mjedisore"; VKM nr.417, datë 25.06.2014 "Për miratimin e tarifave të lejeve të mjedisit" të cilat derdhen në masë 100% në buxheti shtetit të pa përdorura nga DRM-të. DRM Durrës operon si institucion njësi shpenzuese me bilanc më vete. Nga të dhënat e vendosura në dispozicion rezultoi se, të ardhurat janë krijuar vetëm nga pagesa e subjekteve për tarifën e pajisjes sipas ligjit me leje mjedisi, ku për periudhat raportuese (2016; 2017; 2018) DRM Durrës ka lëshuar fatura për pagesë tarifë vjetore, ndërsa ndjekja e treguesve financiarë të shpenzimeve mujore e progresive bëhet nga AKM me rakordim nëpërmjet degës Thesarit Tiranë. Për periudhën objekt auditimi është rakorduar me drejtorinë e financës së AKM-së, duke marr prej tyre pagesat e kryera nga subjektet që kanë aplikuar për leje mjedisore me tarifë vjetore. Ndërmjet AKM-së dhe DRM Durrës ka korespodencë për rakordimin e të ardhurave, ku DRM Durrës nga pagesa e tarifës vjetore e lejes së mjedisit nuk përfiton asnjë të ardhur, ndërsa në vazhdim aktrakordimet janë mbajtur ndërmjet DRM Durrës dhe MM aktualisht Ministria e Turizmit dhe Mjedisit.

Në fund periudhave (2016; 2017; 2018) specialisti i ngarkuar për financën, ka mbajtur regjistër rakordimi me numrin e subjekteve që nuk kanë kryer pagesën dhe detyrimi për arkëtim brenda afateve te përcaktuara në ligj. DRM Durrës ka hapur numër llogarie për derdhjen e tarifave nga subjektet e pajisura me leje mjedisore tipi (C) parashikuar në pika 5 e VKM nr. 417, datë 25.06.2014 "Për miratimin e tarifave të lejeve të Mjedisit", si dhe në urdhërin e ministrit, të gjitha instalimet tipi(C) paguajnë tarifë vjetore në llogarinë bankare të DRM-së në qarku përkatës ku është instalimi. Për subjektet që kanë derdhur tarifën vjetore në këtë numër llogarie për 20,000 lekë me degën e Thesarit Durrës janë mbajtur aktrakordime akumulative për të ardhura të derdhura në llogari të MMT. Për këtë qëllim Drejtori Përgjithshëm AKM me shkresë nr.294 prot, datë 09.03.2015 ka përcjellë njoftimin se, të ardhurat e realizuara nga pagesa e tarifës për tu pajisur me leje mjedisore tipi (C) në vazhdim të derdhën si edhe është proceduar në llogarinë ekonomike të Ministrisë së Mjedisit.

*Tabela nr.6*

| *Përshktimi* | *Për vitin 2016* | *2017* | *Deri 30.10.2018* | *Gjithësej* |
|---|---|---|---|---|
| MIRATIME TIPI (C) | 150 | 151 | 79 | 380 |
| RISHIKIM KUSHTESH | 0 | 0 | 0 | 0 |
| TRANSERIME | 0 | 0 | 1 | 1 |
| TOTALI | 150 | 151 | 79 | 380 |

*Shënim: Të dhënat janë disponuar nga specialisti i Financës.*

-Burimet e krijimit të të ardhurave.

Nga verifikimi regjistrit të evidentimit të autorizimeve të lëshuara për pagesën e tarifës vjetore nga operatorët e instalimit të lejes mjedisore tipi (C) dhe rakordimit ndërmjet Ministrisë së Mjedisit dhe Drejtorisë Rajonale të Mjedisit Durrës rezultoi se, tarifa vjetore për pajisje me leje mjedisore të aplikuara nga operatorët e instalimeve tipi (C) është 2,000 lekë me afat pagese brenda 3/mujorit I-rë të vitit pasardhës në llogarin e hapur për DRM-në e qarkut përkatës e parashikuar nga pika 6 e VKM nr. 417, datë 25.06.2014 "Për miratimin e tarifave të lejeve të

Mjedisit", ndërsa nga marsi 2015 në llogari të Ministrisë së Mjedisit e parashikuar me urdhër të drejtorit të AKM.
Nga DRM-ja mbahet e ruhet dokumentacioni përkatës për tarifat e paguara, ndërsa lidhur me të ardhurat e krijuara e cila duhet të bashkëpunojë me ISHMPU Durrës dhe të raportojë në AKM dhe MTM në mënyre periodike mujore. Për periudhën raportuese objekt auditimi nga DRM Durrës janë miratuar gjithësej 380 leje mjedisore tipi (C) sa më poshtë;
-Për periudhën 2016 janë miratuar 150 leje mjedisore tipi (C).
-Për periudhën 2017 janë miratuar 151 leje mjedisore tipi (C).
-Për periudhën deri 30.10.2018 janë miratuar 79 leje mjedisore tipi (C).
Për pajisjen e subjekteve me leje mjedisi tipi (C), DRM ka mbajtur "databas" të subjektit dhe tarifës vjetore e parshikuar nga ligji nr. 10488, datë 14.07.2011 "Për lejet e mjedisit" dhe pika 6, VKM nr. 417, datë 25.06.2014 "Për miratimin e tarifave të lejeve të Mjedisit". Tarifa e lejes mjedisit të mbartura nga periudha parardhëse ndiqen rregullisht në vijushmeri me informacion, ndërsa për subjekte që vazhdojnë, apo kanë mbyllur aktivitet, si dhe ato që kanë aplikuar për lejë mjedisi tipi (A) e (B) nuk është mbajtur "databas", sepse nuk u paraqit në auditim.
DRM Durrës për periudhën raportuese ka pajisur e miratuar leje mjedisi tipi (C), ndërsa jo të gjithë subjektet kanë arkëtuar vlerën e tarifës me analizë për periudhën (2016; 2017; 2018) paraqiten sa më poshtë;

*Tabela nr.7*

| *DREJTORIA RAJONALE E MJEDISIT DURRËS* | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | *Leje mjedisore* | | *Të arkëtuara* | | *Detyrime të pa Paguar TVC* | | | |
| *VITI* | *(nr)* | *vlera* | *Nr* | *vlerë* | *Paguar 1 vit* | | *Nr* | *Vlera* |
| 2016 | 150 | 300 | 123 | 246 | 12 | 24 | 15 | 30 |
| 2017 | 151 | 302 | 116 | 232 | = | = | 35 | 70 |
| 2018 | 79 | 158 | = | = | = | = | = | Paguhet në 2019 |
| Totali | 380 | 760 | 239 | 478 | 12 | 24 | 50 | 100 |

*Shënim: Të dhënat janë disponuar nga specialisti i Financës.*

Për periudhën raportuese objekt auditimi rezulton se, janë miratuar leje mjedisi tipi (C) gjithësej për 380 subjekte; nga të cilat kanë kryer pagesë tarife 239 subjekte në vlerë 478 mijë lekë, ndërsa nuk kanë kryer pagesë 62 subjekte me vlerë 124 mijë lekë e konsideruar e ardhur e munguar për buxhetin e shtetit, si pasojë e mos arkëtimit të tarifës së lejes tipi (C), në mospërputhje me VKM nr. 417, datë 25.06.2014 "Për miratimin e tarifave të lejeve të mjedisit". Për vitin 2016 është arkëtuar tarifa e lejes mjedisore tipi (C) e miratuar në vitin 2015 dhe më parë, ndërsa gjatë vitit 2017 është arkëtuar tarifa e lejes e miratuar në vitin 2016 dhe ato të mbartura më parë e pasqyruar sa më poshtë:

*Tabela nr.8*

*në 000/lekë*

| *Periudhat* | *Të mbartura nga vitet nr.* | *Viti ushtrimor* | *Revokim e nr.* | *Totali nr.* | *Detyrimi vjetor nr.* | *Arkëtuar* | | *Pa arkëtuar* | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | *Nr* | *Vlera* | *Nr* | *Vlerë* |
| 2016 | 32 | 150 | 0 | 182 | 364 | 123 | 246 | 59 | 118 |
| 2017 | 59 (nga 2016) | 151 | 0 | 210 | 420 | 116 | 232 | 94 | 188 |
| 2018 | 94 (nga 2017) | 79 | 0 | 173 | 370 | 0 | 30.03.19 | 0 | 0 |
| Totali | | 380 | 0 | 589 | 1.178 | 239 | 478 | 153 | 306 |

*Shënim: Të dhënat janë disponuar nga specialisti i Financës.*

Të dhënat në tabelë evidentojnë vlerën e të ardhurave për periudhën raportuese të pa arkëtuara nga subjektet e pajisura me leje mjedisore tipi (C), si dhe të mbartuara nga periudha të mëpasme shuma 306 mijë lekë e konsideruar e ardhur e munguar për buxhetin e shtetit. Ndërsa subjektet që kanë kërkuar pranë DRM Durrës dhe janë në proçes pezullimi, apo revokim të lejes mjedisore me detyrime të pa derdhura paraqiten sa më poshtë:

*Tabela nr.9*

*në 000/lekë*

| *Periudha* | *Subjektet* | *Mbartur* | *Shuma* | *Tarifa* | *Detyrimi* | *Komente* |
|---|---|---|---|---|---|---|

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 2014 | 28 | 0 | 28 | 2.000 | 56 | Për pezullim nga DRMD, Status pezulluar dhe në QKB |
| 2015 | 13 | 28 | 41 | 2.000 | 82 | Për pezullim nga DRMD, Status pezulluar dhe në QKB |
| 2016 | 2 | 41 | 43 | 2.000 | 86 | Për pezullim nga DRMD, Status pezulluar dhe në QKB |
| Totali | 43 | | 112 | | 224 | |

*Shënim: Të dhënat janë disponuar nga specialisti i Financës.*

Të dhënat në tabelë evidentojnë se, për 43 subjekte që i përkasin periudhave para ardhëse janë paraqitur pranë QKB shkresa për pezullim aktiviteti, leje të cilat do të pezullohen janë të miratuara në periudhën 2014 e përgjatë, përpara miratimit me VKM nr. 417, datë 25.06.2014. DRM Durrës ka përfshirë këtë akt ligjor edhe në lejet e miratuara prej saj në mënyrë që subjektet të informohen për detyrimet financiare. Subjekte të cilat kanë pezulluar aktivitetin e tyre, por nuk kanë paraqitur kërkesë pranë DRM është në mospërputhje me neni 26, pika 1 të ligjit nr. 10448, datë 14.07.2011 "Për Lejet e Mjedisit". Ndërsa për 43 subjektet që nuk kanë kryer pagesë vjetore ka ardhur si pa mjaftueshmëri e ndjekjes nga DRM Durrës, njëkohësisht dhe nga fakti i mungesës së rregullshmërisë si; (udhëzim, urdhër, etj...), për mënyrën e ndjekjes së proceduarës në rastin e ndërprerjes së aktivitetit të lejes mjedisore.

Për periudhën objekt auditimi DRM Durrës nëpërmjet shkresave zyrtare drejtuar QKB dhe ISHMP-së me objekt pezullimi e revokimi lejes mjedisore tipi (C) respektivisht me (Akt Revokim) për shkak mos kryerje të pagesës së tarifës vjetore, ku për 43 subjektet që i përkasin periudhës (2014 deri 2016) janë dërguar shkresa e njoftimit, ndërsa është informuar edhe AKM për subjekte që nuk kanë kryer pagesë e tarifës së përcaktuar dhe ndaj tyre është kërkuar pezullimi lejes mjedisore. Tarifa e lejes mjedisore 2,000 lekë e pa arkëtuar nga 43 subjektet me detyrimin progresiv për periudhën 3 vite të mbartur është vlera 224 mijë lekë e konsideruar e ardhur e munguar për buxhetin e shtetit.

*Sa më sipër arrihet në konkluzionin se;*
*Për periudhën raportuese objekt auditimi (10.10.2016; 2017 deri 30.10.2018) që nga krijimi institucionit të DRM-së, si pasojë e mos pagesës së tarifës së lejes mjedisore tipi (C) nga subjektet e paisjisura me leje mjedisore, apo nga procesi i pezullimit të lejes mjedisore për subjekte me status të pezulluar me QKB, për detyrimet e prapambetura dhe të mbartuara të pa paguara, buxheti shtetit ka krijuar të ardhura të munguara në vlerën 530 mijë lekë (306+224).*

***Pika nr.4 e programit të auditimit; "Zbatimi dispozitave ligjore të marrëdhënieve të punës e pagave. Respektimi strukturave organike të miratuara dhe krahasimi me faktin. Respektimi dispozitave ligjore për pagat e punonjësve. Respektimi dispozitave ligjore për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë, dhënien e shpërblimeve për ndihmë e fatkeqësie etj".***

*-Organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë Rajonale të Mjedisit Durrës.*

Drejtoria Rajonale e Mjedisit është rregjistruar pranë Qendra Kombëtare e Rregjistrimit (QKR) më datë 17.04.2014 me NIPT (L41622751A), si institucion publik në varësinë e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe Ministrisë së Turizmit e Mjedisit (ish Ministria e Mjedisit) me aktivitet kryesor; "Administrimi, dhënia e lejeve mjedisore dhe vlerësimi i ndikimit në mjedis". Organizimi dhe funksionimi bazohet në VKM nr.47, datë 29.01.2014 "Për përcaktimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit e të Agjencive Rajonale të Mjedisit". Në zbatim të ligjit të Shërbimit Civil, MFK dhe dispozitave të ligjore për pagat e punonjësve, Titullari në bashkëpunim me burimet njerëzore Agjencia Kombëtare e Mjedisit, kanë miratuar strukturën organizative, procedurat e rekrutimit të stafit, përgatitjen e procedurave për punësim e plotësim organikës, ndërsa specialisti financës ka realizuar hartimin dhe ndjekjen e zbatimin e buxhetit, duke siguruar zbatimin e dispozitave ligjore të pagave, kontabilizim të transaksioneve financiare e menaxhimin etj. Ministri Mjedisit me shkresën nr.2073, datë 21.02.2014 ka përcjellë për zbatim VKM nr. 47,

datë 29.01.2014 dhe urdhri Kryeministrit nr.55, datë 13.02.2014 "Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë Kombëtare të Mjedisit" i ndryshuar me Urdhrin nr.150, datë 17.04.2014 "Për një ndryshim në urdhrin nr.55, datë 13.02.2014"Për miratimin e strukturës e organikës Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe të DRM Durrës". Për periudhën raporuese objekt auditimi (30.10.2016 deri 30.10.2018) numri punonjësve në organikë të DRM-së është miratuar me 12 punonjës.
Nga auditimi mbi dokumentacionin e vënë në dispozicion (listë pagesa, libri pagave, shkresat e emërimit, si fotokopje të dosjeve të personelit, etj) konstatohet se, struktura dhe niveli pagave për secilin pozicion janë miratuar sipas lidhjes 2/2 të përcaktuara në kategoria III-b grupi "Drejtor" dhe IV-b grupi "Specilaistë" duke përcaktuar edhe kushtet e punës. Struktura organizative e miratuar për periudhën objekt auditimi përbëhet nga:

*Tabela nr.10*

| *Nr* | *Emërtimi* | *Specialiteti* | *Numri* |
|---|---|---|---|
| 1 | Drejtor | | 1 |
| 2 | Specialist | Për Leje mjedisore dhe VNM | 9 |
| 3 | Specialist | Monitorimi | 1 |
| 4 | Specialist | Finance | 1 |
| | | Totali | 12 |

*Shënim: Të dhënat janë disponuar nga specialisti Financës e Personelit.*

Numri punonjësve me organikën e miratuar është plotësuar, ndërsa janë respektuar kategoritë e pagave përkatëse. Gjatë periudhës objekt auditimi nuk ka lëvizje në pozicioni "Specialist", ndërsa për periudhën 2016 referuar në VKM nr. 395, datë 20.04.2015 "Për miratimin e programit kombëtar të praktikave të punës në administratën shtetërore dhe institucionet e tjera publike", si dhe Udhëzimi MSR nr.25, datë 17.11.2015 "Për zbatimim e VKM nr.395, datë 29.04.2015" në DRM Durrës është punësuar për 1 vit me kontratë në pozicionin "praktikant kualifikuar" i cilësuar "specialist" i cili ka ndërprerë mardhëniet e punës dhe aktualisht nuk është në strukturë. Për nëpunësit në DRM zbatohet legjislacioni "nëpunësi civil" parashikuar për institucione të pavarura, përveç sa parashikohet ndryshe në këtë ligj. DRM Durrës është në vartësi të AKM në përputhje me këto dispozita, drejtori emërohet nga Ministri. Në strukturën organike e miratuar për DRM Durrës nuk është përfshirë pozicioni arkivist/protokollist, rol të cilin e kryen i ngarkuar "specialist për leje mjedisore e VNM" pa trajnim në këtë fushë, ndërsa arkiv/protokoll duhet të funksionojë në zbatim të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 "Për Arkivën" dhe Manuali Rregullator "Norma tekniko-profesionale e metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë".
Për periudhën objekt auditimi në institucion u konstatua se, deri në datë 31.12.2017 numri punonjësve ka qenë 12, kundrejt 12 punonjësve në strukturë organizative, ndërsa për periudhën 01.01.2018 e në vazhdim numri punonjësve është 7 me vende vakanë 5 punonjës përfshi edhe specialisti finacës, për pasojë nuk ka tejkalim të strukturës, ndërsa mos plotësimi i numërit të punonjësve, planifikimi e realizimi i shpenzimeve e kosto personeli është sa më poshtë:

*Tabela nr.11*

*000/lekë*

| Nr | Emërtimi | 3/mujori IV 2016 | | | Periudha 2017 | | | Deri 30.10.2018 | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Plan V | Fakt | % | Plan | Fakt | % | Plan | Fakt | % |
| 1 | Numri i Punonjësve | 12 | 12 | 100 | 12 | 12 | 100 | 12 | 7 | 59 |
| 2 | Llog (600) Pagat | 8.100 | 7.861 | 97 | 8.000 | 6.929 | 87 | 8.500 | 3.772 | 44 |
| 3 | Llog. (601) Sigurime Shoq e Shëndet. | 1.380 | 1.313 | 95 | 1.400 | 1.160 | 83 | 1.500 | 647 | 43 |
| | Totali | 9.480 | 9.173 | 97 | 9.400 | 8.089 | 86 | 10.000 | 4.419 | 44 |

*Shënim: Të dhënat janë disponuar nga specialisti Financë.*

Në tabelë pasqyrohen treguesit e realizimit të fondit të pagave për periudhat raportuese në total 3/mujori III 2016 është 97%, për 2017 është 86% dhe deri 30.10.2018 është 44%. Mosrealizimi i fondit të pagave ka ardhur si rezultat i parashikimit me rezerva në drejtim të kualifikimeve, vjetërsisë, lejes së lindjes, si dhe mosplotësimi strukturës organizative vecanërishtë gjatë vitit 2018 me 3 vakant "Specialist të lejeve dhe VNM" dhe 1 vakant "Specialist i financës". Po kështu mosrealizimi fondit në zëri "Sigurime shoqërore" ka ardhur si rezultat i mosplanifikimit të saktë të pagave, mbi të cilën është përllogaritur fondi për kontributi sigurime shoqërore e shëndetsore. Për perudhën objekt auditimi rezulton se, njësia shpenzuese DRM Durrës nuk ka përllogaritur shpenzime për vendime gjyqësore.
-Krahasimi përmbledhëses së listëpagesave me shumat e urdhër shpenzimit e pagesa e kryer.
U bë krahasimi përmbledhëses së listë pagesave me likuidimet, ndërsa nuk u konstatuan pasaktësi në shpenzimet për paga e sigurime. Pagesat janë shoqëruar me dokumentacionin mbështetës listë-prezencat, urdhër shpenzimet për paga dhe urdhra të veçantë të titullarit të nënshkruara nga nënpunësi urdhërues dhe zbatues (kontabilisti) të nënshkruara nga Dega e Thesarit Durrës.
*-Respektimi i dispozitave ligjore për përcaktimin e nivelit të pagave, hapja dhe azhurnimi periodik i rregjistrit të punëmarrësve (libri i pagave).*
Niveli pagave është përcaktuar me VKM nr. 589, datë 17.07.2013 "Për disa shtesa e ndryshime në VKM nr.545, datë 11.08.2011 "Për miratimin e strukturës dhe të nivelit të pagave të nëpunësve civil, zv/ministrit dhe nëpunësit të kabineteve në Kryeministri, aparatit e ministrive të linjës, administratës të presidentit, komisionit qendror të zgjedhjeve, Prokurorisë së Përgjithshme, disa institucioneve të pavarura, institucioneve në varësi të Këshillit të Ministrave, Kryeministrit, institucione në varësi të ministrive të linjës dhe administratën e prefektit", lidhja 1 "Struktura e pagave për nëpunësit civilë/nëpunësit në të gjitha institucionet pjesë e fushës së veprimit të këtij vendimi" dhe lidhja nr. 9/4 "Kategoritë e pagave dhe shtesat për kushte pune të pozicioneve të punës së nëpunësve për emërtesat "specialist" deri në "titullar institucioni" në drejtoritë e agjencisë së legalizimit, urbanizimit dhe integrimit të zonave/ndërtimeve informale" (e barazvlefshme me pagat e punonjësve të DRM) i ndryshuar me VKM nr.187, datë 08.03.2017.
Nga auditimi me përzgjedhje i listëpagesave për periudhat raportuese (3/mujori IV-të 2016; 3/mujori III-të 2017; 3/mujori II-të 2018) u verifikua niveli pagave për çdo punonjës, arsimimi sipas diplomës, vjetërsia në punë me librezën e secilit, ndërsa nuk u konstatuan mospërputhje të nivelit të diplomës me kategorinë vendi punës dhe funksionit sipas emërimit, në përputhje me VKM nr. 545, datë 11.08.2011 i ndryshuar. Përllogaritjet për kontribute sigurime shoqërore e shëndetësore përballuar nga punëmarrësi e punëdhënësi, deklarimet, ndalesat dhe derdhjet janë në përputhje me ligjin nr.7703, datë 11.05.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, ligjin nr.7770, datë 13.10.1994 "Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar dhe ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar. Listë pagesat janë përpiluar me gjithë elementet përbërës, sipas listë prezencave dhe shumat e tyre janë të rakorduara. Vendosja e pagave e shtesave mbi pagë janë bërë me klasën përkatëse për çdo kategori, ndalesat janë përllogaritur në përputhje me dispozitat ligjore për kontributet e sigurimeve e tatimi mbi të ardhurat, sipas pasqyrës së realizimit të buxhetit.
Në përdorimin e fondit të pagave, sigurime shoqërore e shëndetësore është respektuar ligji nr. 9136, datë 11.09.2013 "Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore e shëndetësore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, UMF nr.26, datë 16.04.2009 "Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore" i

ndryshuar dhe ligji nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar janë bërë llogaritjet dhe ndalesat për tatimin mbi të ardhurat si dhe derdhjet e tyre në favor të tatimeve. Për periudhën objekt auditimi nuk rezultuan pagesa për orë jashtë kohës normale të punës, ndërsa nuk është kryer asnjë pages për ndihmë ekonomike dhe nuk ka tejkalim të numrit të punonjësve në strukturën organizative. Nuk nuk është mbajtur libër për të hedhur pagat për secilin punonjës, për periudhën e përcaktuar nga emërimi, fillimi marrëdhënieve të punës e rakorduar me listë pagesën.

*-Administrimi i dosjeve të personelit dhe regjistrit të personelit:*

Mbështetur në VKM nr. 355, datë 07.07.2000 “Për organizimin e dosjes së personelit”, janë kryer veprime në regjistrin themeltar në bazë të shkresave të emërime e lirime nga AKM. Regjistri i nëpunësve është mbajtur dhe azhurnuar periodikisht në dosjet e punonjësve të kompletuara me dokumentacionin e duhur. Nga auditimi dosjeve të personelit (të cilat mbahen kopje dentifikuara me ato orgjinale të administruara në AKM) rezultoi se, ato administrohen të inventarizuara në zbatim VKM nr. 117, datë 05.03.2014 “Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”, ndërsa për periudhën e audituar për cdo punonjës është kryer vlerësimi periodik i rezultateve individuale në punë të bashkëlidhura në çdo dosje të nëpunësit. Nga verifikimi dosjeve për marrje status i nëpunësit civil për punonjësve aktual të DRM-së Durrës rezultoi se, ligji për shërbimin civil i ka gjetur punonjësit në marrëdhënie pune të cilët kanë përfituar status nëpunësi civil të konfirmuar nga DAP prej shkurtit 2015, të certifikuar edhe nga Shkolla Shqiptare e Administratës Publike (ASPA), personeli i DRM-së Durrës sipas pozicioneve e arsimimit referuar në listëprezencën e mujajit shtator 2018, gjendja paraqitet me të dhënat sa më poshtë:

*Tabela nr.12*

| *Nr* | *Pozicioni në strukturë* | *Periudha* | | *Emeri* | *Mbiemeri* | *Arsimimi (Bachelor/MSC)* | *Lloji Diplomes* |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | *Emerimi* | *Largimi* | | | | |
| 1 | Drejtor | 01.06.2018 | = | B. | H. | MSC | Drejtësi |
| 2 | Specialist i lejeve dhe VNM | 21.02.2014 | = | B. | C. | MSC | Sh. Socilae |
| 3 | Specialist i lejeve dhe VNM | 21.02.2014 | = | E. | Z. | MP | Drejtësi |
| 4 | Specialist i lejeve dhe VNM | 21.02.2014 | = | L. | D. | MSC | Mar.Ndërkon |
| 5 | Specialist i lejeve dhe VNM | 21.02.2014 | = | M. | S. | MP | Ad.Publik |
| 6 | Specialist i lejeve dhe VNM | 21.02.2014 | = | S. | V. | MCS | Kimi |
| 7 | Specialist i lejeve dhe VNM | 21.02.2014 | = | A. | B. | MSC | Drejtësi |
| 8 | Specialist i lejeve dhe VNM | = | = | Vakant | = | = | = |
| 9 | Specialist i lejeve dhe VNM | = | = | Vakant | = | = | = |
| 10 | Specialist i lejeve dhe VNM | = | = | Vakant | = | = | = |
| 11 | Specailsite Monitorimi | = | = | Vakant | = | = | = |
| 12 | Specialiste e Financave | = | = | Vakant | = | = | = |

Shënim: Të dhënat janë disponuar nga specialisti Financës.

Të dhënat në tabelë evidentojnë faktin se, struktura organizative e DRM Durrës pas datës 01.01.2018 rezulton e pa kompletuar me 5 vende vacant, nga të cilët 3 punonjës me detyrë specialist për leje dhe VNM, 1 punonjës me detyrë specialist monitorimi dhe 1 punonjës me detyrë specialist finance, ndërsa bie në sy fakti se nga punonjësit aktual nuk rezulton asnjë specialist me profesion, apo diplomë për mjedisin.

***Pikat nr.5 e programit të auditimit; “Mbi administrimin e pronës shtetërore. Zbatimi dispozitave ligjore për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare. Ligjshmëria dhe saktësia e veprimeve dhe ngjarjeve të kryera me nëpërmjet pagesave me arkën në lekë (me zgjedhje) dhe veprimet në valutë (gjithë periudha). Ligjshmëria dhe saktësia e kryerjes së veprimeve me bankës (me zgjedhje)”.***

*-Auditimi mbi administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare e letrave me vlerë nëpërmjet shqyrtimit të dokumentacionit, në lidhje me veprimet ekonomike të kryera me pagesat nëpërmjet bankës.*

U auditua rregullshmëria dhe përputhshmëria ligjore e shpenzimeve të kryera i shoqëruar me dokumentacion mbështetës e justifikues të likujduara nëpërmjet pagesave me bankë në mënyrë të njëpasnjëshme që përkasin periudhës raportuese objekt i auditimit.
Nga auditimi i transaksioneve financiare (të njëpasnjëshme) të kryera nëpërmjet bankës u konstatua se; veprimet janë regjistruar në mënyrë kronologjike në ditarin e bankës i mbajtur me format (A4), në bazë të urdhër shpenzimit i nënshkruar nga nëpunësi autorizues dhe zbatues të konfirmuara nga nëpunësi i degës Thesarit Durrës të vulosura nga dy palët. Urdhër shpenzimet në shumicë të rasteve kanë bashkëlidhur dokumenta vërtetues, autorizuese, justifikues sipas natyrës së shpenzimit pëfshirë; (autorizim, urdhër prokurimi, procesverbal, oferta ekonomike, kontrata, fatura furnitori, preventiva e situacione, etj, etj), ndërsa për blerjet e materialeve është bashkëlidhur fletëhyrja e artikullit të blerë. Vlerat e shënuara në urdhër shpenzim përputhen me vlerat e dokumenteve financiare që mbështesin shpenzimin. Kontabilizimi veprimeve ekonomike nëpërmjet bankës është bërë sipas destinacionit e natyrës së shpenzimit llog.(602) me shpenzime mujor e progresiv. AK për periudhat objekt auditimi (30.10.2016 deri 30.10.2018) ka mbajtur regjistër parashikimi të prokurimit publike në të cilin janë përfshirë edhe shpenzimet e kushtëzuara (energji, telefoni, shërbim postar, internet, etj) të dërguar në Ministrinë e Mjedisit, jo brenda datës 15 janar të periudhës raportuese apo me regjistër shtesë, në mospërputhje me neni 4 "Regjistri i parashikimeve të prokurimeve publike" të VKM nr.914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, të C.t të pasqyruar paraqiten sa më poshtë:

*Tabela nr.13*

| *Nr* | *Periudha* | *Objekti* | *Fondi në 000/lekë* | *Koha* | *Procedura* | *Financimi* |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | 2016 | Mirmbajte paisje kompju | 20 | Gjatë vitit | B.Vogël | Buxheti |
| 2 | | Kancelari A/4 | 150 | Gjatë vitit | B.Vogël | Buxheti |
| 3 | | Material pastrimi | 20 | Gjatë vitit | B.Vogël | Buxheti |
| 4 | | Toner | 130 | Gjatë vitit | B.Vogël | Buxheti |
| | | Totali | 320 | | | |
| 1 | 2017 | Kancelari A/4 | 100 | Gjatë vitit | B.Vogël | Buxheti |
| 2 | | Material pastrimi | 10 | Gjatë vitit | B.Vogël | Buxheti |
| 3 | | Toner | 100 | Gjatë vitit | B.Vogël | Buxheti |
| | | Totali | 210 | | | |
| 1 | 2018 | Kancelari | 100 | Gjatë vitit | B.Vogël | Buxheti |
| 2 | | Material pastrimi | 10 | Gjatë vitit | B.Vogël | Buxheti |
| 3 | | Toner | 100 | Gjatë vitit | B.Vogël | Buxheti |
| | | Totali | 210 | | | |

*Shënim: Të dhënat janë disponuar nga specialisti i Financës.*

Në regjistëra është parashikuar të kryhen me procedurë "blerje e vogël" dhe për organizimin e procedurës së blerjes Titullari ka nxjerr urdhër prokurimi për krijimin e komisioni të blerjeve me vlerë e vogël me përbërje për vitin 2017 (A.B. kryetare, E.V., B.C. anëtare) dhe për vitin 2018 (E.Z. kryetare, A.B., M.S. anëtare). Komisionet e autorizuara për realizimin e procedurës së blerjes, në asnjë rast nuk kanë kryer procedurë me prokurim elektronik, për pasojë njoftimi për klasifikimin e ofertave konkuruese nuk është njoftuar ofertuesit që nuk janë kualifikuar për mungesa në dokumentacion etj, nuk janë paraqitur, apo janë tërhequr nga lidhja e kontratës, veprime në mospërputhje me Udhëzimi nr. 3, datë 27.01.2015 "Për Proçedurën e Prokurimit me Vlerë të Vogël" i ndryshuar, ku pika 5 e riformuluar citon qartë; "Kur Autoriteti Kontraktor kalon tek ofertuesi i renditur në vend të dytë dhe në vijim, ka detyrimin ta njoftojë atë menjëherë nëpërmjet sistemit elektronik (menusë së mesazheve), mbi klasifikimin e ri të procedurës" dhe pika 1 e 3 të Udhëzimit nr.3, datë 27.01.2015 "Për procedurën e prokurimit me vlerë të vogël" i ndryshuar, për këtë ngarkohet me përgjegjësi Komisioni i blerjes me vlerë e vogël.

Shpenzimet e kryera për likuidimin e faturave të subjekteve furnitore nëpërmjet veprimeve të kryera me bankë janë realizuar me procedurë prokurimi "blerje e vogël" për periudhën objekt auditimi (nga data 30.10.2016 deri në datë 30.10.2018) u konstatuan mangësi, ku në mënyrë analitike dhe për cdo urdhër shpenzim pasqyrohen sa më poshtë;

1-Me Urdhër shpenzim nr.51, datë 15.11.2016 është kryer pagesa në shumën 34,800 lekë me përfitues OE "Niesle"shpk për likujdimin me objekt; "shërbime mirmbajtje informatike". Kjo pagesë është shoqëruar me; urdhër prokurimin nr.4, datë 09.11.2016 (blerje e vogël) me fondi limit 29.100 lekë pa tvsh (34.920 lekë me tvsh); fatura e thjeshtë tatimore nr.46, datë 11.11.2016 me vlerë 34,800 lekë dhe procesverbali marrjes në dorëzim datë 11.11.2016.

Nga auditimi procedurës prokurimit e realizuar "blerje e vogël" rezultoi se; urdhëri prokurimit si referimi ligjor ka pasqyruar procedurën "blerje e vogël" elektronike për të cilën bashkëlidhur mungojnë e duhet të jenë; ftesa për ofertë me kërkesat kualifikuese të OE, si dhe specifikimet teknike për artikujt që do blihen; procesverbali KBVV për vlerësimin e ofertave pjesmarrëse me vlerë e vogël, njoftimi nëpërmjet sistemit elektronik (menusë së mesazheve) për të njoftuar skualifikim, apo tërheqje nga oferta. Ky shpenzim është kryer e realizuar nëpërmjet procedurës me vlerë nën 100,000 lekë e pasqyruar me (formulari 5), ku janë analizuar 3 oferta pjesmarrëse, nga të C.t 2 oferta janë me vlerë më të lartë se vlera e fondit limit, ofertat e paraqitura nuk kanë evidentuar mënyrën e komunikimit, apo njoftimit për pjesmarrje, njëkohësisht kërkesa për shpenzimin është evidentuar në procesverbalin datë 03.09.2016 pa argumentuar proceset e nevojshme dhe domosdoshmëria për mirmbajtje të paisjeve kompjuterike. Shërbimet e kryera janë marr në dorëzim pa komision me procesverbalin datë 11.11.2016 i nënshkruar vetëm nga E.V. pa urdhër nga titullari me arsyetimin se; "në përfundim të kryerjes së shërbimeve, paisjet kompjuterike janë riparuar defektet dhe janë në gjendje pune". Veprime në mospërputhje me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" neni 4/24; 10; 11; 12 dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aseteve në sektorin publik", pika 35; 36, Udhëzimi nr.3, datë 27.01.2015 "Për Proçedurën e Prokurimit me Vlerë të Vogël" i ndryshuar dhe për këtë ngarkohen me përgjegjësi; A. B., E.V., M.S., në cilësinë anëtar të KBVV, ndërsa E.V. dhe në cilësi anëtar i MD, për mungesë në zbatimin e përgjegjësive funksionale.

2-Me Urdhër shpenzim nr.55, datë 16.12.2016 është kryer pagesa në shumën 30,000 lekë me përfitues OE "AlpenPulito"shpk për likujdimin me objekt; "shërbime disinfektimi". Kjo pagesë është shoqëruar me; urdhër prokurimin nr.5, datë 05.12.2016 (blerje e vogël) me fondi limit 25.000 lekë pa tvsh (30.000 lekë me tvsh); fatura tatimore e shitjes nr.172, datë 09.12.2016 me vlerë 30,000 lekë dhe procesverbali marrjes në dorëzim datë 09.12.2016.

Nga auditimi procedurës prokurimit e realizuar "blerje e vogël" rezultoi se; urdhëri prokurimit si referimi ligjor ka pasqyruar procedurën "blerje e vogël" elektronike për të cilën bashkëlidhur mungojnë e duhet të jenë; ftesa për ofertë me kërkesat kualifikuese të OE, si dhe specifikimet teknike për artikujt që do blihen; procesverbali KBVV për vlerësimin e ofertave pjesmarrëse me vlerë e vogël, njoftimi nëpërmjet sistemit elektronik (menusë së mesazheve) për të njoftuar skualifikim, apo tërheqje nga oferta. Ky shpenzim është kryer e realizuar nëpërmjet procedurës me vlerë nën 100,000 lekë e pasqyruar me (formulari 5), ku janë analizuar 3 oferta pjesmarrëse, nga të C.t 2 oferta janë me vlerë më të lartë se vlera e fondit limit, ofertat e paraqitura nuk kanë evidentuar mënyrën e komunikimit, apo njoftimit për pjesmarrje. Kërkesa për shpenzimin është evidentuar në procesverbalin datë 17.11.2016 pa argumentuar dhe justifikuar proceset e nevojshme e të domosdoshme për dizinfektimin e ambjenteve e paisjeve në zyrat e instiucionit. Shërbimet e kryera janë marr në dorëzim pa komision me procesverbalin datë 09.12.2016 i nënshkruar vetëm nga E.V. pa urdhër nga titullari me

arsyetimin se; "ky shërbim u krye në prani të specialistëve dhe nuk pati asnjë dëmtim të sendeve që vjen nga përdorimi preparateve e solucioneve për dezinfektim". Veprime në mospërputhje me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" neni 4/24; 10; 11; 12, UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aseteve në sektorin publik", pika 35; 36, Udhëzimi nr.3, datë 27.01.2015 "Për Proçedurën e Prokurimit me Vlerë të Vogël" i ndryshuar dhe për këtë ngarkohen me përgjegjësi; A. B., E.V., M.S. në cilësinë anëtar të KBVV, ndërsa E.V. në cilësinë anëtar KMD, për mungesë në zbatimin e përgjegjësive funksionale.
3-Me Urdhër shpenzim nr.19, datë 10.07.2017 është kryer pagesa në shumën 98,744 lekë me përfitues OE "Sh.Q."shpk për likujdimin me objekt; "blerje materiale kancelari". Kjo pagesë është shoqëruar me; urdhër prokurimin nr.1, datë 06.07.2017 (blerje e vogël) me fondi limit 83,148 lekë pa tvsh (99.773 lekë me tvsh); fatura tatimore e shitjes nr.5357, datë 07.07.2017 me vlerë 98,774 lekë; procesverbali marrjes në dorëzim datë 07.07.2017, si dhe fletë hyrja nr.1, datë 07.07.2017 me 23 artikuj.
Nga auditimi procedurë prokurimit e realizuar "blerje e vogël" rezultoi se; urdhëri prokurimit si referimi ligjor ka pasqyruar procedurën "blerje e vogël" elektronike për të cilën bashkëlidhur mungojnë e duhet të jenë; ftesa për ofertë me kërkesat kualifikuese të OE, si dhe specifikimet teknike për artikujt që do blihen; procesverbali KBVV për vlerësimin e ofertave pjesmarrëse me vlerë e vogël, njoftimi nëpërmjet sistemit elektronik (menusë së mesazheve) për të njoftuar skualifikim, apo tërheqje nga oferta. Ky shpenzim është kryer e realizuar nëpërmjet procedurës me vlerë nën 100,000 lekë e pasqyruar me (formulari 5), ku janë analizuar 3 oferta pjesmarrëse të datës 06.07.2017, nga të C.t 2 oferta janë me vlerë më të lartë se vlera e fondit limit, ofertat e paraqitura nuk kanë evidentuar mënyrën e komunikimit, apo njoftimit për pjesmarrje, por me (1 ditë përpara hapjes). Shpenzimi është evidentuar në kërkesën për blerje kancelari në datën 06.07.2017 me 29 artikuj, ku 6 artikuj janë evidentuar me kërkesë (0), pa argumentuar e justifikuar sasinë e nevojshme dhe të domosdoshme, si edhe cmimin e tregut. Artikujt janë marr në dorëzim me procesverbalin datë 07.07.2017 nga KMD i nënshkruar nga E.V., K.P., B.C. pa urdhër nga titullari me arsyetimin se; "mallrat sipas tabelës ishin në përputhje me kërkesat, specifikimet dhe sasitë e kërkuara nga DRM Durrës", ndërkohë në urdhër prokurim dhe ofertë nuk është evidentuar asnjë kërkesë dhe specifikim teknik. Veprime në mospërputhje me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" neni 4/24; 10; 11; 12, UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aseteve në sektorin publik", pika 35; 36, Udhëzimi nr.3, datë 27.01.2015 "Për Proçedurën e Prokurimit me Vlerë të Vogël" i ndryshuar dhe për këtë ngarkohen me përgjegjësi; E.V., K.P., B.C. në cilësinë anëtar të KBVV edhe anëtar të KMD, për mungesë në zbatimin e përgjegjësive funksionale.
4-Me Urdhër shpenzim nr.20, datë 04.09.2017 është kryer pagesa në shumën 97,200 lekë me përfitues OE "Sh.Q."shpk për likujdimin me objekt; "blerje tonera". Kjo pagesë është shoqëruar me; urdhër prokurimin nr.2, datë 03.08.2017 (blerje e vogël) me fondi limit 83,010 lekë pa tvsh (99.612 lekë me tvsh); fatura tatimore e shitjes nr.5986, datë 04.09.2017 me vlerë 97,200 lekë; procesverbali marrjes në dorëzim datë 04.09.2017, si dhe fletë hyrja nr.2, datë 04.09.2017 me 3 artikuj.
Nga auditimi procedurës prokurimit e realizuar "blerje e vogël" rezultoi se; urdhëri prokurimit si referimi ligjor ka pasqyruar procedurën "blerje e vogël" elektronike për të cilën bashkëlidhur mungojnë e duhet të jenë; ftesa për ofertë me kërkesat kualifikuese të OE, si dhe specifikimet teknike për artikujt që do blihen; procesverbali KBVV për vlerësimin e ofertave pjesmarrëse me vlerë e vogël, njoftimi nëpërmjet sistemit elektronik (menusë së mesazheve) për të njoftuar skualifikim, apo tërheqje nga oferta. Ky shpenzim është kryer e realizuar nëpërmjet procedurës

me vlerë nën 100,000 lekë e pasqyruar me (formulari 5), ku janë analizuar 3 oferta pjesmarrëse të datës 04.09.2017, nga të C.t 2 oferta janë me vlerë më të lartë se vlera e fondit limit, ofertat e paraqitura nuk kanë evidentuar mënyrën e komunikimit, apo njoftimit për pjesmarrje. Shpenzimi është evidentuar në kërkesën për blerje kancelari në datën 07.07.2017 me 3 artikuj, pa argumentuar e justifikuar sasinë e nevojshme dhe të domosdoshme, si edhe cmimin e tregut. Artikujt janë marr në dorëzim me procesverbalin datë 04.09.2017 nga KMD i nënshkruar nga E.V. ndërsa (K.P., B.C. pa nënshkruar), pa urdhër nga titullari me arsyetimin se; "mallrat sipas tabelës ishin në përputhje me kërkesat, specifikimet dhe sasitë e kërkuara nga DRM Durrës, tonerat ishin orgjinal dhe cilësor", ndërkohë që në urdhër prokurimim dhe ofertë nuk është evidentuar asnjë kërkesë dhe specifikim teknik. Veprime në mospërputhje me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" neni 4/24; 10; 11; 12, UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aseteve në sektorin publik", pika 35; 36, Udhëzimi nr.3, datë 27.01.2015 "Për Proçedurën e Prokurimit me Vlerë të Vogël" i ndryshuar dhe për këtë ngarkohen me përgjegjësi; E.V., K.P., B.C. në cilësinë anëtar të KBVV dhe anëtar të KMD, për mungesë në zbatimin e përgjegjësive funksionale.

-Për këtë periudhë raportuese 2017 nga AK me 2 urdhëra prokurimi në datat (06.07.2017 dhe 03.08.2017) janë realizuar 2 procedura prokurimi "blerje e vogël" me objekt; "blerje materiale kancelari dhe blerje tonera" e njëjta natyrë blerje të copëzuara me vlerë totale 166,150 lekë pa tvsh të likujduara nëpërmjet 2 urdhra shpenzimi me vlerë totale 195,944 lekë me tvsh, ndërsa blerja duhej të ishte realizuar me procedurë të zakonshme prokurimi e grupuar me qëllim përdorimin me efektivitet, eficencë dhe ekonomicitet të fondit publik, në mospërputhje me pika 8 e nenit 40 "Procedura e prokurimit mre vlerë të vogël" VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, për këtë ngarkohet me përgjegjësi Specialisti i financës dhe Komisioni i blerjeve me vlerë të vogla.

5-Me Urdhër shpenzim nr.23, datë 07.11.2017 është kryer pagesa në shumën 9,953 lekë me përfitues OE "Z.T." P.fizik për likujdimin me objekt; "blerje materiale pastrimi dhe shërbimi". Kjo pagesë është shoqëruar me; urdhër prokurimin nr.3, datë 02.11.2017 (blerje e vogël) me fondi limit 8,322 lekë pa tvsh (9,986 lekë me tvsh); fatura tatimore e shitjes nr.84, datë 06.11.2017 me vlerë 9,8952 lekë; procesverbali marrjes në dorëzim datë 06.11.2017, si dhe fletë hyrja nr.3, datë 06.11.2017 me 15 artikuj.

Nga auditimi procedurës prokurimit e realizuar "blerje e vogël" rezultoi se; urdhëri prokurimit si referimi ligjor ka pasqyruar procedurën "blerje e vogël" elektronike për të cilën bashkëlidhur mungojnë e duhet të jenë; ftesa për ofertë me kërkesat kualifikuese të OE, si dhe specifikimet teknike për artikujt që do blihen; procesverbali KBVV për vlerësimin e ofertave pjesmarrëse me vlerë e vogël, njoftimi nëpërmjet sistemit elektronik (menusë së mesazheve) për të njoftuar skualifikim, apo tërheqje nga oferta. Ky shpenzim është kryer e realizuar nëpërmjet procedurës me vlerë nën 100,000 lekë e pasqyruar me (formulari 5), ku janë analizuar 3 oferta pjesmarrëse të datës 06.11.2017, nga të C.t 2 oferta janë me vlerë më të lartë se vlera e fondit limit, ofertat e paraqitura nuk kanë evidentuar mënyrën e komunikimit, apo njoftimit për pjesmarrje, por me (1 ditë përpara hapjes). Shpenzimi është evidentuar në kërkesën për blerje detergjente në datën 02.11.2017 me 20 artikuj, ku 5 artikuj janë evidentuar me kërkesë (0), pa argumentuar e justifikuar sasinë e nevojshme dhe të domosdoshme, si dhe përllogaritja e cmimit të tregut. Artikujt janë marr në dorëzim me procesverbalin datë 06.11.2017 nga KMD i nënshkruar nga E.V., K.P., B.C. pa urdhër nga titullari me arsyetimin se; "mallrat sipas tabelës ishin në përputhje me kërkesat, specifikimet dhe sasitë e kërkuara nga DRM Durrës", ndërkohë që në urdhër prokurimi dhe ofertë nuk është evidentuar asnjë kërkesë dhe specifikim teknik. Veprime në mospërputhje me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe

kontrollin" neni 4/24; 10; 11; 12, UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aseteve në sektorin publik", pika 35; 36, Udhëzimi nr.3, datë 27.01.2015 "Për Proçedurën e Prokurimit me Vlerë të Vogël" i ndryshuar dhe për këtë ngarkohen me përgjegjësi; E.V., K.P., B.C. në cilësinë anëtar të KBVV dhe anëtar të KMD, për mungesë në zbatimin e përgjegjësive funksionale.

6-Me Urdhër shpenzim nr.24, datë 13.06.2018 dhe nr.29, datë 16.06.2018 janë kryer 2 pagesa shuma 9,000 lekë dhe 16,000 lekë me përfitues OE "A.C."shpk për likujdimin me objekt; "blerje materiale për funksionimin e paisjeve të zyrës(tonera)". Këto pagesa janë të shoqëruara me; urdhër prokurimin nr.1, datë 01.06.2018 (blerje e vogël) me fondi limit 25,000 lekë pa tvsh (30,000 lekë me tvsh); fatura tatimore e shitjes nr.382, datë 01.06.2018 me vlerë 25,000 lekë; procesverbali marrjes në dorëzim datë 01.06.2018, si dhe fletë hyrja nr.1, datë 01.06.2018 me 3 artikuj.

Nga auditimi procedurës prokurimit e realizuar "blerje e vogël" rezultoi se; urdhëri prokurimit si referimi ligjor ka pasqyruar procedurën "blerje e vogël" elektronike për të cilën bashkëlidhur mungojnë e duhet të jenë; ftesa për ofertë me kërkesat kualifikuese të OE, si dhe specifikimet teknike për artikujt që do blihen; procesverbali KBVV për vlerësimin e ofertave pjesmarrëse me vlerë e vogël, njoftimi nëpërmjet sistemit elektronik (menusë së mesazheve) për të njoftuar skualifikim, apo tërheqje nga oferta. Ky shpenzim është kryer e realizuar nëpërmjet procedurës me vlerë nën 100,000 lekë, ndërsa nuk janë pasqyruar, evidentuar dhe analizuar ofertat pjesmarrëse nëpërmjet (formulari 5), por vetëm është evidetuar me procesverbal sasia e kërkuar e artikujve, bashkëlidhur të cilit janë 3 oferta pjesmarrëse pa datë ofertimi, pa vlerë me cmime pa tvsh përfshi edhe fituesin, ofertat e paraqitura nuk kanë evidentuar mënyrën e komunikimit, apo njoftimit për pjesmarrje. Shpenzimi nuk është shoqëruar me kërkesë për blerje artikulli tonera për 3 copë, pa argumentuar e justifikuar sasia e nevojshme e domosdoshme, si dhe përllogaritja e cmimit të tregut. Artikujt janë marr në dorëzim me procesverbalin datë 01.06.2018 nga KMD i nënshkruar nga L. D., E.Z., B.C. pa urdhër nga titullari me arsyetimin se; "mallrat u morën në dorëzim nga komisioni sipas tabelës", ndërkohë që në urdhër prokurimi dhe ofertë nuk janë evidentuar asnjë kërkesë dhe specifikim teknik. Veprime në mospërputhje me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" neni 4/24; 10; 11; 12, UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aseteve në sektorin publik", pika 35; 36, Udhëzimi nr.3, datë 27.01.2015 "Për Proçedurën e Prokurimit me Vlerë të Vogël" i ndryshuar dhe për këtë ngarkohen me përgjegjësi; E.Z., A. B., M.S. në cilësinë anëtar të KBVV dhe L. D., E.Z., B.C. anëtar të KMD, për mungesë në zbatimin e përgjegjësive funksionale.

7-Me Urdhër shpenzim nr.41, datë 13.06.2018 është kryer pagesë shuma 17,000 lekë me përfitues OE "I."shpk për likujdimi me objekt; "blerje materiale për funksionimin e paisjeve të zyrës(tonera)". Kjo pagesë është ë shoqëruar me; urdhër prokurimin nr.2, datë 03.10.2018 (blerje e vogël) me fondi limit 14,166 lekë pa tvsh (17,000 lekë me tvsh); fatura tatimore e shitjes nr.327, datë 04.10.2018 me vlerë 17,000 lekë; procesverbali marrjes në dorëzim datë 04.10.2018, si dhe fletë hyrja nr.3, datë 03.10.2018 me 9 artikuj.

Nga auditimi procedurës prokurimit e realizuar "blerje e vogël" rezultoi se; urdhëri prokurimit si referimi ligjor ka pasqyruar procedurën "blerje e vogël" elektronike për të cilën bashkëlidhur mungojnë e duhet të jenë; ftesa për ofertë me kërkesat kualifikuese të OE, si dhe specifikimet teknike për artikujt që do blihen; procesverbali KBVV për vlerësimin e ofertave pjesmarrëse me vlerë e vogël, njoftimi nëpërmjet sistemit elektronik (menusë së mesazheve) për të njoftuar skualifikim, apo tërheqje nga oferta. Ky shpenzim është kryer e realizuar nëpërmjet procedurës me vlerë nën 100,000 lekë, ndërsa nuk janë pasqyruar, evidentuar dhe analizuar ofertat

pjesmarrëse nëpërmjet (formularit 5), por vetëm është evidetuar me procesverbal sasia e kërkuar e artikujve, bashkëlidhur të cilit janë 3 oferta pjesmarrëse, të C.t nuk kanë evidentuar mënyrën e komunikimit, apo njoftimit për pjesmarrje. Shpenzimi nuk është shoqëruar me kërkesë për blerje të artikujve, pa argumentuar e justifikuar sasia e nevojshme e domosdoshme, si dhe përllogaritja e cmimit të tregut. Artikujt janë marr në dorëzim me procesverbalin datë 04.10.2018 nga KMD i nënshkruar nga L. D., E.Z., B.C. pa urdhër nga titullari me arsyetimin se; “mallrat u morën në dorëzim nga komisioni sipas tabelës”, ndërkohë që në urdhër prokurimi dhe ofertë nuk janë evidentuar asnjë kërkesë dhe specifikim teknik. Veprime në mospërputhje me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 4/24; 10; 11; 12, UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aseteve në sektorin publik”, pika 35; 36, Udhëzimi nr.3, datë 27.01.2015 “Për Proçedurën e Prokurimit me Vlerë të Vogël” i ndryshuar dhe për këtë ngarkohen me përgjegjësi; E.Z., A. B., M.S. në cilësinë anëtar të KBVV dhe L. D., E.Z., B.C. anëtar të KMD, për mungesë në zbatimin e përgjegjësive funksionale.

*-Administrimi i aktiveve qarkulluese të administruara në njësinë shpenzuese dhe magazinë.*

Njësia shpenzuese nuk ka në administrim AQT të patundshme si ndërtesa, mjete transporti, shpenzime në proces për rritje AQT, apo për transferime kapitale, etj, pasi administrata e DRM Durrës kryen aktivitetin e instaluar në 4 zyra të godinës së ISHMPU Durrës, në të cilën janë instaluar edhe institucione të tjera, të C.t përvec pamjaftueshmërisë nuk janë pjesë e inventarit të DRM Durrës në vlerë të pasqyruara në kontabilitet. Magazina funksionon duke dokumentuar lëvizjen e vlerave materiale sipas parashikimit në ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe aktet nënligjore të dalë në zbatim. Dokumentimi vlerave materiale në kontabilitet, rakordimi dhe kuadrimi tyre në mënyrë analitike është pasqyruar dhe në pasqyrat financiar. Hyrjet e daljet dokumentohen në ditarin e magazinës në formë dokumentare, ku cdo regjistrim bëhet i dokumentuar me fletë hyrje sipas faturës shitësit dhe fletë dalje, ndërsa dokumentacioni konfirmohet nga magazinieri e marrësi në dorëzim, ku rezultoi se veprimet në librin e magazinës vecanërishtë daljet nuk janë të shoqëruara me autorizim nga nëpunësi urdhërues, ndërsa gjendja e artikullit pas daljes nuk pasqyrohet në kollonë mbetje, por në kollonën daljes.

Janë hapur 11 kartela për zyrat e punonjësit me përgjegjësi materiale në llog.(218) “Inventar ekonomik” dhe llog.(327/1) “Objekte inventar” të tërhequr nga magazina mbi të C.t specialisti financës siguron kontrollin e vlerave materiale për gjatë kohës që ato janë në ngarkim nga punonjësi, duke nxjerr përgjegjësi për çdo rast lëvizje, shpërdorimi, dëmtimi, apo humbje. Në magazinë nuk rezultoi diferencë ndërmjet vlerës konatabile e paraqitur në pasqyrën financiare e vlerës kontabile në kartelën e magazinës sepse, artikulli menjëherë pas hyrjes është bërë dalje, për pasojë gjendja në magazinë në fund të periudhave raportuese 31.12.2016 dhe 31.12.2017 pasqyrohet me zero (0).

***Pika nr.6 e programit të auditimit; “Mbi organizimin e mbajtjen e kontabilitetit, sipas Planit Kontabël i miratuar për institucionet. Nxjerrja e pasqyrave financiare (bilanci kontabël) në afat, plotësimi formularëve të bilancit dhe anekset përkatëse. Inventarizimi i pronës shtetërore, sipas llogarive të aktiveve e pasurisë publike dhe regjistrimi në zyrat e pasurisë”.***

*-Auditimi mbi hartimin e pasqyrave financiare (bilanci kontabël).*

Nga verifikimi për rregullshmërinë dhe përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore, shumat e llogarive të aktivit e pasivit, nga ana formale përputhen me shumat e anekseve të pasqyrave financiare, llogaritë sintetike kuadrojnë me ato analitike për gjendjet e llogarive në fund të periudhës, ndërsa llogarit që evidentohen në aktiv e pasiv të pasqyrës financiare në përfundim të periudhës raportuese janë hedhur në pozicionet e duhura. Nga krahasimi gjendjes së

llogarive të periudhës së mëparshme 2016 me ato të paraqitura në mbyllje të pasqyrës financiare të periudhës raportuese 2017 objekt auditimi rezultojnë me këto gjendje:
*Tabela nr.13*

*në/000 lekë*

| Grupet | Emërtimi | Periudha 2016 | Periudha 2017 | Ndryshimi | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | | pakësim | shtesë |
| A | Aktive të qëndrueshme | 359 | 307 | 52 | 0 |
| B | Aktive qarkulluese | 665 | 732 | 0 | 67 |
| C | Llogari të tjera aktive | 0 | 0 | 0 | 0 |
| | Totali | 1,024 | 1.039 | 52 | 67 |

*Shënim: Të dhënat janë disponuar nga specialisti Financë.*

Për periudha ushtrimore 2016; Zyra e financës në përfundim të përiudhës raportuese me shkresë nr. 170 port, datë 28.02.2017 ka paraqitur me konfirmim nga dega e thesarit Durrës përgatitjen e raportimin e pasqyrave financiare vjetore njësia shpenzuese me anekset përkatëse brenda afatit të caktuar ligjor.

*Në aktivi bilancit*; Të dhënat në tabelë pasqyrojnë në aktivin e bilancit kontabël, ku në datën 31.12.2016 "Aktivet e Qëndrueshme" zënë 35% të vlerës totale të aktivit eC. e krahasuar me periudhën ushtrimore parardhëse 2015 "Aktivet e Qëndrueshme" janë pakësuar në vlerë 71 mijë lekë vetëm me vlerën e amortizimit, ndërsa gjendja fizike është e pa ndryshuar (pa shtesa e paksime) në "Aktive të qëndrueshme të trupëzuara" e analizuar vetëm llog.(218) "Inventar ekonnomik" me vlerë fizike të pa ndryshuar për 636 mijë lekë.

Ndërsa "Aktivet Qarkulluese" zënë 65% të vlerës totale të aktivit eC. e krahasuar me periudhën ushtrimore parardhëse 2015 "Aktivet Qarkulluese" janë pakësuar në vlerë 120 mijë lekë (785-665), ndryshim i pasqyruar vetëm në (Klasa 4) "Kërkesa arkëtimi mbi debitorët" me llog.(4342) "Të tjera operacione me shtetin (debitorë)" në çelje të periudhës ushtrimore nga 781 mijë lekë në fund të periudhës është 661 mijë lekë, pakësim shuma 120 mijë lekë, që janë kryesishtë detyrimet debitore të mbartura e të krijuara për gjatë dhe përpara periudhës raportuese. Në këtë shumë nuk janë të përfshira detyrimet debitore të rekomanduara nga KLSH në audimin e mëparshëm me vlerën 1.409.000 lekë për 672 subjektë debitore.

Për periudha ushtrimore 2017; Zyra e financës në përfundim të përiudhës raportuese me shkresë nr. 390 port, datë 27.02.2017 ka paraqitur me konfirmim nga dega e thesarit Durrës përgatitjen e raportimin e pasqyrave financiare vjetore të njësisë shpenzuese DRM me anekset përkatëse brenda afatit të caktuar ligjor.

Në aktivi bilancit; Të dhënat në tabelë pasqyrojnë në aktivin e bilancit kontabël, ku në datën 31.12.2017 "Aktivet e Qëndrueshme" zënë 29% të vlerës totale të aktivit eC. e krahasuar me periudhën ushtrimore parardhëse 2016 "Aktivet e Qëndrueshme" janë pakësuar në vlerë 52 mijë lekë, vetëm me vlerën e amortizimit, ndërsa gjendja fizike është e pa ndryshuar me shtesa e paksime në "Aktive të qëndrueshme të trupëzuara" e analizuar me llog.(218) "Inventar ekonnomik" me vlerë fizike të pa ndryshuar për 636 mijë lekë.

Ndërsa "Aktivet Qarkulluese" zënë 71% të vlerës totale të aktivit eC. e krahasuar me periudhën ushtrimore parardhëse 2016 "Aktivet Qarkulluese" janë shtuar në vlerë 67 mijë lekë (665-732), ndryshim i pasqyruar vetëm në (Klasa 4) "Kërkesa arkëtimi mbi debitorët" me llog.(4342) "Të tjera operacione me shtetin (debitorë)" në çelje të periudhës ushtrimore nga 661 mijë lekë në fund të periudhës është 726 mijë lekë, shtesë shuma 67 mijë lekë. Në këtë shumë nuk janë të mbartura detyrimet debitore të rekomanduara nga KLSH në audimin e mëparshëm për tu analizuar në përiudhën raportuese 2016.

-Llogaritë (423-429); "Personeli, paradhënie, deficite e gjoba" në fund të vitit 2017 rezulton me gjendje debitore (0) lekë me të njëjtën gjendje në fillim të vitit pa analizuar sipas llogarive në aktiv të bilancit për tepricë kreditore dhe llog.(435) "Sigurime shoqërore" në fund të vitit

2017 rezulton me gjendje debitore (0) lekë, nga (0) lekë në fillim të vitit e pa analizuar sipas llogarive në aktiv për tepricën debitore.
Në grupi A pasivit; "Fonde të veta" në fund të periudhës raportuese në datë 31.12.2017 pasqyrohet me shumën 311 mijë lekë, nga gjendja në fillim të periudhës në shumën 434 mijë lekë me paksim shuma 123 mijë lekë e analizuar ndryshimi dhe gjendja me llogarinë (10) "Fonde të veta", me nën/llogaritë respektive llog.(101) "fonde bazë", apo me llogarit e tjera përfaqësuese me të njëjtën vlerë.
Në grupi B pasivit; llogaria "Detyrime" e përfaqësuar nga Klasa (4) "Detyrime afatshkurta" në fund të periudhës raportuese 31.12.2017 pasqyrohet me shumën 727 mijë lekë, nga gjendja në fillim të periudhës në shumën 661 mijë lekë e pa ndryshuar e analizura sa më poshtë;
-Llogaria 42; "Personeli e llogari të lidhura me to", në mbyllje të vitit ushtrimor rezulton me tepricë kreditore shuma 490 mijë lekë eC. pasqyron detyrime ndaj punonjësve për pagat e personelit të likuiduara në Janar 2018.
-Llogaria (431);"Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa" në mbyllje të vitit ushtrimor rezulton me tepricë kreditore shuma 31 mijë lekë eC. pasqyron detyrimet për tu derdhur tatim mbi të ardhurat, likuidimi të C.ve është bërë në Janar 2018.
-Llogaria (435); "Sigurime shoqërore" në mbyllje të vitit ushtrimor rezulton me tepricë kreditore shuma 144 mijë lekë eC. pasqyron detyrimet për tu derdhur kontribut i sigurimeve shoqërore, likuidimi të C.ve është bërë në Janar 2018.
-Llogaria (436); "Sigurime shëndetësore", në mbyllje të vitit ushtrimor rezulton me tepricë kreditore shuma 20 mijë lekë eC. pasqyron detyrime për tu derdhur kontribut i sigurimeve shëndetësore, likuidimi të C.ve është bërë në muajin Janar 2018.
Pra llogaritë kreditore (42; 431; 435; 436) përfaqësojnë detyrime në mbyllje të vitit ushtrimor për paga, sigurime shoqërore e shëndetsore dhe tatim mbi page të përllogaritura të muajit dhjetor të C.t kuadrojnë me pagesat e kryera në vitit pasardhës në muaji janar 2018.
-Llogaria (467);"Kreditor të ndryshëm" në mbyllje të vitit ushtrimor rezulton me gjendje në shumën 41 mijë lekë, nga gjendja në fillim të periudhës 12 mijë lekë me shtesë shuma 29 mijë lekë e pa ekujvalentuar me llogaritë (434/1) "Të tjera operacione me shtetin kreditor" eC. pasqyrohet me shumën (0) lekë.
Për periudha ushtrimore deri 30.10.2018; Përgatitja e raportimi pasqyrave financiare vjetore i njësisë shpenzuese DRM Durrës me anekset përkatëse për përiudhë raportuese 2018 bëhet brenda afatit ligjor deri në datën 28.02.2019, periudhë eC. është jashtë periudhës objekt auditimi, për të cilën kërkohet të përfundoj brenda afatit ligjor.
*-Auditimi mbi organizimin dhe mbajtjen e kontabilitetit rezultoi se:*
Njësia shpenzuese DRM Durrës organizimin dhe mbajtjen e kontabilitetit e ka realizuar nëpërmjet regjistrimit të veprimeve (në mënyrë manuale e excel) nga jashtë në mënyrë ekstra kontabile të faturave të blerjes, ndërsa janë hapur evidenca në excel për rregjistrim të shpenzimeve me klasifikim të ndara në kapituj, tituj e nën/tituj në evidencë. Fletë hyrjet dhe daljet janë prerë për lëvizjet nga magazina të regjistruara si shpenzim nga specialisti fiancës (i ngarkuar), ndërsa në fund të periudhës, nuk janë bërë azhornime në evidencat përkatës të mbajtura në (Excel) me regjistrime për rakordim të pagësës, sepse njësia shpenzuese nuk ka hapur partitar, ditari veprimeve të ndryshme, libri madh e libra për rregjistrim të shpenzimeve e klasifikim të tyre, për pasojë pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve në fund të periudhës raportuese ushtrimore e konfirmuar nga dega e thesarit Durrës është kryer pa regjistrime kontabile në ditar e rregjistra, veprim në mospërputhje me UMF nr. 2, datë 06.02.2012 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit", Kap (II), pika 100, 101, për këtë ngarkohet me përgjegjësi i ngarkuari specialisti i fiancës.

*-Auditimi mbi inventarizimin e llogarive të aktiveve, pasurisë publike rezultoi se:*

Në zbatim të ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin e pasqyrat financiare", pika 1, neni 7 "Inventari aktiveve e detyrimeve"; ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar me ligjin nr.110/2015, datë 15.10.2015, UMF nr.30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", Kreu IV "Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve, inventarizimi i aktiveve" dhe Udhëzimi nr.28, datë 15.12.2011 "Mbi paraqitjen e deklaratës dhe raportit vjetor për cilësinë e sistemit te kontrollit te brendshëm në njësite publike" në DRM Durrës u audituan procedurat e ndjekura nga njësia shpenzuese për kryerjen e inventarizimit të pasurisë "aktive të qëndrueshme të trupëzuara"; "gjendje inventari"; "materiale" e "objekte inventar".

Nga auditimi mbi dokumentacionin e vendosur në dispozicion nga specialisti i financës në njësia shpenzuese DRM Durrës për periudhat raportuese (30.10.2016; 2017 deri 30.10.2018), në lidhje me procesin e inventarizimit fizik të vlerave të aktiveve, të pasurisë, aseteve e materialeve, nxjerrjen e rezultatit dhe rakordimin me qëllim që procesi i inventarizimit të përfshihet në pasqyrat financiare, respektimin e dispozitave ligjore të ndjekura për vlerësimin e nxjerrjes jashtë përdorimit dhe mënyrës së asgjësimit të artikujve të vlerësuar jashtë përdorimi, si dhe kryerjen e veprimeve kontabile për shkarkimin nga librat e llogarisë dhe regjistrat përkatës u konstatuan, mangësi e shkelje në zbatimin e dispozitave ligjore të konsideruara të përgjithëshme të njëta për 2 periudhat raportuese 2016 dhe 2017 me analizë të hollësishme për sa më poshtë;

1-Komisionet e inventarizimit të ngritura me urdhër të titullarit, në fillim të procesit të inventarizimit nuk kanë në dispozicilon listën e aktiveve për inventarizim e hartuar nga Nënpunësi zbatues, mbi bazën e të dhënave të pasqyruara në regjistrat kontabël të njësisë, në mospërputhje me pika 81 e UMF nr.30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", për këtë ngarkohet me përgjegjësi Komisioni inventarizimit.

2-Në momentin e fillimit të procesit të inventarizimit në objekt, anëtarët e komisionit në asnjë rastë nuk kanë përpiluar deklarata në se kanë, ose jo konflikt interesi me punonjësin me përgjegjësi materiale, ose që kanë në përdorim aktive edhe në rastin kur anëtar komisioni inventarizimi është drejtuesi i njësisë që inventarizohet, njëkohësisht dhe përgjegjës material, veprim në mospërputhje me ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike" dhe UMF nr.30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik",pika 82, ku përcaktohet se: ".. Anëtarët e komisionit nuk duhet të kenë konflikt interesi..", për këtë ngarkohet me përgjegjësi Komisioni i inventarizimit.

3-Komisionet në fillim të procesit të inventarizimit, nuk kanë hartuar akt-rakordim për të përcaktuar e fiksuar në cdo objekt që inventarizohet, numrin rendor të fletëhyrjes e fletëdaljes të fundit, veprim në mospërputhje me pika nr.83 e UMF nr.30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin aktiveve në njësitë e sektorit publik" e C. përcakton qartësishtë se: "Para fillimit të inventarit fiksohet numri rendor i fletëhyrjes dhe fletëdaljeve nëpërmjet një proces verbali të mbajtur midis përgjegjësit material dhe komisionit të inventarizimit dhe bëhet mbyllja dhe dyllosja e magazinës. Hapja e mbyllja bëhet në prani të komisionit e përgjegjësi material", për këtë ngarkohet me përgjegjësi Komisioni i inventarizimit.

4-Komisioni inventarizimit fizik në përfundim të procesit, nuk ka përgatitur raportin informues për të paraqitur te Titullari i njësisë shpenzuese informacion mbi gjendjen fizike të vlerave të aktiveve, pasurisë, aseteve e vlerave materialeve të institucionit, përfshirë dhe përmbledhëse e inventrizimit sipas llogarive në objektet përkatëse; sipas inventarizimit të kryer në fakt, me gjendjen fizike të vlerave materiale në përfundim të periudhës raportues 31.12.2016, veprim në

mospërputhje me pika 85, gërma (c) dhe 86 e UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë sektori publik", për këtë ngarkohet me përgjegjësi Komisioni inventarizimit.

5-Komisioni në fletë inventarin fizik në objekte, ka pasqyruar gjendje (jashtë përdorimi) për 2 artikuj me vlerë 8,780 lekë, ndërsa nuk është bërë vlerësimin e gjendjes cilësore tyre me qëllim mos riqarkullimi në periudhën pasardhëse, sepse po këta artikuj janë evidentuar në këtë gjendje edhe në periudhën raportuese 2016 të mbartur në periudhën 2017 jashtë përdorimi dhe mandej të bëhej procedura e asgjësimit, veprim në mospërputhje me pika 85, gërma (a); 86 dhe 95 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", për këtë ngarkohet me përgjegjësi Komisioni i inventarizimit.

Ndërsa me analizë për secilën periudhë raportuese, sipas vlerës së aktiveve e vlerave materiale rezultatet e inventarizimit fizik pasqyrohen për sa më poshtë;

-Për periudhën ushtrimore raportuese 2016; Titullari njësisë shpenzuese për inventarizimin e vlerave të aktiveve, pasurisë, aseteve e vlerave materiale të institucionit, ka nxjerrë Urdhërin e brendshëm nr.24, datë 27.12.2016 "Për ngritjen e komisionit për inventarizimin e mallrave dhe materialeve për vitin 2017" me përbërje sa më poshtë; E.Sh. kryetare, E.Z., E.V. anëtarë. Procesi inventarizimit nga komisioni do përfundojë në datë 31.12.2016.

Nga auditimi mbi dokumentacionin e vendosur në dispozicion në zbatim të urdhërit të titullarit për realizimin inventarizimit fizik të aktiveve, pasurisë, aseteve e gjendjes materiale rezultoi se; Komisioni inventarizimit në përfundim të procesit ka evidentuar gjendjen fizike e krahasuar me gjendjen kontabile në fletë inventarin e objekteve të inventarizuara me llogari inventariale, ndërsa nuk ka përpilar përmbledhëse me rezultatet e inventarizimit. Referuar në rezultatet e pasqyruara në fletë inventarët gjendja fizike e aktiveve, pasurisë, aseteve e vlerave materiale të institucionit e krahasur me gjendjen e kontabile në përfundim të periudhës raportuese në pasqyrat financiare në datën 31.12.2016 për 2 llogari të inventarizuara rezulton sa më poshtë:

*Tabela nr.14*

| *Llog* | *Përshkrimi* | *Inventari fizik sipas (Permbledheses)* | *Gjendja sipas Pasqyrës financiare* | *Diferenca* | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Mbi | Nën |
| 218 | Inventar ekonomik | 541,699 | 635,619 | = | 93,920 |
| 327/1 | Objekte inventar | 40,300 | 4,700 | 35,600 | = |
| | Totale | 581,999 | 640,319 | | 58,320 |

*Shënim: Të dhënat janë disponuar nga specialisti Financë.*

Në përfundim të dhënat e pasqyruara në tabelë evidentojnë diferenca ndërmjet gjendjes fizike dhe gjendjes së deklaruar në pasqyrën financiare në llog.(218) rezulton më tepër gjendja e pasqyrës financiare se gjendja fizike në shumën 93,920 lekë dhe në llog.(327/1) rezulton më tepër gjendja e inventarit fizik se pasqyra financiare në shumën 35,600 lekë, ndërsa rezultatet e inventarizimit fizik duhen të parashikohen dhe evidentohen sa më të sakta në gjendjen e pasqyrës financiare për periudhën raportuese.

Në rezultatet e pasqyruara në fletë inventarët gjendja fizike e aktiveve, pasurisë, aseteve e vlerave materiale të institucionit në datë 31.12.2016 edhe në datë 31.12.2017, gjendja kontabile është krahasuar me gjendjen fizike për 8 artikuj vetëm me sasi, pa vlerë sa më poshtë:

*Tabela nr.15*

| *Nr* | *Llog* | *Përshkrimi artikullit* | *Cmimim* | *Sasia* | | *Vlera* | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | *Inventari fizik* | *Gjendja kontabile* | *Fizike* | *Kontabile* |
| 1 | 218 | Tavolina | 1 | 1 | 1 | 1 | 1 |
| 2 | 218 | Kompjuter | 1 | 1 | 1 | 1 | 1 |
| 3 | 218 | Printer | 1 | 1 | 1 | 1 | 1 |
| 4 | 218 | UPS triple 750V | 1 | 1 | 1 | 1 | 1 |
| 5 | 218 | Kabëll USB | 1 | 1 | 1 | 1 | 1 |
| 6 | 218 | Keypad | 5 | 1 | 1 | 5 | 5 |
| 7 | 218 | Maus GENIUS | 3 | 1 | 1 | 3 | 3 |
| 8 | 327/1 | Karrike | 0 | 7 | 7 | 7 | 7 |

*Shënim: Të dhënat janë disponuar nga specialisti Financë.*

Të dhënat në tabelë evidentojnë gjendjen fizike e krahasuar me gjendjen kontabile për 8 artikuj pa vlerës në aktivet qarkulluese llog.(218) dhe llog.(327/1) të cilët duhej të ishin vlerësuar në procesin e inventarizimit fizik. Në këto kushte rezultati inventarizimit fizik i njësisë shpenzuese, nuk i shërben ndërtimit të pasqyrës financiare të periudhës raportuese dhe për pasojë hartimi pasqyraës financiare (bilanci kontabël) nuk mund të quhet se pasqyron realitetin e gjendjes së aktiveve, pasurisë, aseteve e vlerave materiale të institucionit. Veprime në mospërputhje me UMF nr. 28, datë 18.12.2014 "Për procedurat e mbylljes së llogarive vjetore të buxhetit", Kap VI "Rakordimi dhe mbyllja e llogarive të tjera vjetore të qeverisjes se përgjithshme", pika 33 "Rakordimi, mbyllja e llogarive të tjera vjetore të njësive dhe hartimi i pasqyrave financiare do të vazhdojë të kryhet në bazë të UMF nr. 14, datë 28.12.2006 dhe nr. 26, datë 27.12.2007 ndryshuar me udhëzimi nr. 10, datë 27.02.2008" dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", Kreu IV"Sistemi kontrollit periodik aktiveve", pika 74 "Inventarizimi aktive", për këtë ngarkohen me përgjegjësi; znj.D.D. me detyrë në cilësinë e ngarkuar me detyrë hartuese e pasqyrës financiare, znj.K.K. me detyrë në cilësinë ish/Drejrtore dhe Komisioni inventarizimit fizik, për mungesë në zbatimin e përgjegjësive funksionale.

-Për periudhën ushtrimore raportuese 2017; Titullari njësisë shpenzuese për inventarizimin e vlerave të aktiveve, pasurisë, aseteve e vlerave materiale të institucionit, ka nxjerr urdhërin e brendshëm nr.23, datë 26.12.2017 "Për ngritjen e komisionit për inventarizimin e mallrave dhe materialeve për vitin 2017" me përbërje sa më poshtë; S.V. kryetare, K.P., E.Z., R.L., E.V. anëtarë. Procesi inventarizimit fizik nga komisioni do të përfundojë në datën 31.12.2017.

Nga auditimi mbi dokumentacionin e vendosur në dispozicion në zbatim të urdhërit të titullarit për realizimin inventarizimit fizik të aktiveve, pasurisë, aseteve e gjendjes materiale rezultoi se; Komisioni në përfundim të procesit të inventarizimit ka evidentuar gjendjen fizike të krahasuar me gjendjen kontabile e pasqyruar në fletë inventarizimin fizik, sipas objekteve të inventarizuara me llogari inventariale, ndërsa nuk ka përpilar përmbledhëse me rezultatet e inventarizimit. Referuar në rezultatet e pasqyruara në përmbledhësen e inventarizimit fizik gjendja fizike e vlerave të aktiveve, të pasurisë dhe aseteve të institucionit në datë 31.12.2017 e krahasur me gjendjen e kontabile në pasqyrat financiare në datën 31.12.2017 për 2 llogarit e inventarizuara me analizë rezulton sa më poshtë:

*Tabela nr.16*

| *Llog* | *Përshkrimi* | *Inventari fizik sipas (Permbledheses)* | *Gjendja sipas Pasqyrës financiare* | *Diferenca* | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | | *Mbi* | *Nën* |
| 218 | Inventar ekonomik | 646,119 | 635,619 | 10,500 | = |
| 327/1 | Objekte inventar | 18,700 | 4,700 | 14,000 | = |
| | Totale | 664,819 | 640,319 | 24,500 | = |

*Shënim: Të dhënat janë disponuar nga specialisti Financë.*

Në përfundim të dhënat në tabelë evidentojnë diferencat ndërmjet gjendjes fizike dhe gjendjes e deklaruar në pasqyrat financiare shuma 24,500 lekë, ndërsa rezultati inventarizimit fizik duhet të parashikohet dhe evidentohen në pasqyrat financiare për periudhën raportuese, në këto kushte rezultati inventarizimit fizik të njësisë shpenzuese nuk i shërben ndërtimit të pasqyrave financiare të periudhës raportuese, për pasojë hartimi pasqyrave financiare (bilanci kontabël) nuk mund të quhet se pasqyron realitetin e gjendjes së aktiveve, pasurisë, aseteve e gjendjes materiale të institucionit.

Njëkohësishtë nga auditimi procesit të inventarizimit u konstatua se, në 4 zyra të institucionit rezultojnë gjendje fizike edhe 9 artikuj të pa inventrizuar, pavlerësuar e administruar në kartelat e llogarisë dhe librat e kontabilitetit për artikujt sa më poshtë:

*Tabela nr.17*

| *NR* | *Emertimi* | *Njesia* | *Zyrat që i disponojnë* | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | *Drejtori* | *Financa* | *Specialisti (V)* | *Specialiti (M)* | *Totali* | *Vlera* |
| 1 | Kondicioner | Cope | 1 | = | = | 1 | 2 | Pa vlere |
| 2 | Perde dritare | Cope | 2 | 2 | = | = | 4 | Pa vlere |
| 3 | Bibliotek raft | Cope | = | 2 | = | = | 2 | Pa vlere |
| 4 | Kosh mbeturinave | Cope | 1 | 1 | 1 | 1 | 4 | Pa vlere |
| 5 | Ngrohëse korenti | Cope | = | = | 1 | = | 1 | Pa vlere |

*Shënim: Të dhënat janë disponuar nga specialisti Financës.*

Këta artikuj gjendje fizike në institucion të pa administruar, rezultojnë gjendje nga periudha përpara objekt auditimi, ndrsa kërkohet të vlerësohen, administrohen, evidentohen me hyrje në kartelat inventar të zyrave përkatëse, në mospërputhje me UMF nr. 28, datë 18.12.2014 "Për procedurat e mbylljes së llogarive vjetore të buxhetit për vitin 2014", Kap VI "Rakordimi dhe mbyllja e llogarive të tjera vjetore të qeverisjes se përgjithshme", pika 33 "Rakordimi, mbyllja e llogarive të tjera vjetore të njësive dhe hartimi i pasqyrave financiare do të vazhdojë të kryhet në bazë të UMF nr. 14, datë 28.12.2006 dhe nr. 26, datë 27.12.2007 ndryshuar me udhëzimi nr. 10, datë 27.02.2008" dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", Kreu IV "Sistemi kontrollit periodik aktiveve", pika 74 "Inventarizimi aktive", për këtë ngarkohen me përgjegjësi; znj.D.D. me detyrë në cilësinë e ngarkuar me detyrë hartuese e pasqyrës financiare, znj.K.K. me detyrë në cilësinë ish/Drejtore, z.B.Gj. me detyrë në cilësinë ish/Drejtor i komanduar dhe Komisioni inventarizimit fizik, për mungesë në zbatimin e përgjegjësive funksionale.

*-Respektimi i dispozitave ligjore për nxjerrjen jashtë përdorimit dhe asgjësimit të vlerave materiale, kryerja e veprimeve kontabile për shkarkimin nga magazina.*

Në periudhën raportuese objekt auditimi referuar në fletë inventarët fizik janë evidentuar për këtë periudhë 2 artikuj jashtë përdorimit për të C.t komisioni vlerësimit nuk ka i sygjeruar titullarit të njësisë shpenzuese DRM Durrës për të vepruar në lidhje me nxjerrjen jashtë.

Nga auditimi i procedurave të ndjekuara në komisioni vlerësimit të njësisë shpenzuese për nxjerrjen jashtë përdorimit, por të pa asgjësuara të artikujve që përkasin llog.218 "Inventar ekonomik" dhe llog.327/1 "Objekte inventar" i kryer në periudhat raportuese 2016 dhe 2017 u konstatua se:

*Tabela nr.18*

| *Artikulli* | *Llogaria* | *2016* | | | *2017* | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | *Saia* | *Cmimi* | *Përgjegjes material* | *Sasia* | *Cmimi* | *Përgjegjes material* |
| Karrike importi | 218 | 1 | 7,980 | A.B. | 1 | 7,980 | S.M. |
| Hapse vrimash | 327/1 | 1 | 800 | A.B. | 1 | 800 | S.M. |
| | | | 8,780 | | | 8,780 | |

*Shënim: Të dhënat janë disponuar nga specialisti Financës.*

Megjithëse komisioni inventarizimit fizik i aktivit, pasurisë e vlerave materiale për secilën periudhë ushtrimore ka sygjeruar e vlerësuar 2 artikuj për jashtë përdorimi, ndërsa njësia shpenzuese nuk rezulton se ka kryer procedurë për asgjësim e artikujve të cilësuar jashtë përdorimi me qëllim mos riqarkullimi tyre në periudha pasardhëse, në mospërputhje me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" dhe ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", për këtë ngarkohen me përgjegjësi; znj.K.K. me detyrë në cilësinë ish/Drejrtore z.B.Gj. me detyrë në cilësinë ish/Drejtor i komanduar, znj.E.Z. dhe z.A.P. me detyrë në cilësinë ish/Specialist të financës dhe znj.D.D. me detyrë në cilësinë e ngarkuar për përpilimin e pasqyrës financiare periudha ushtrimore 2016 dhe 2017, për mungesë në zbatimin e përgjegjësive funksionale.

Më poshtë kemi listuar aktet ligjore dhe nënligjore me të C.t DRM Durrës ka mospërputhje:

*1-Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimi financiar e kontrolli" neni 4/24; 10-12.*

*2-Ligjin nr. 8485, datë 12.05.1999 "Kodi i Procedurave Administrative te RSH".*

*3-Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH", neni 44.*

*4-Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin e pasqyrat financiare".*
*5-Ligjin nr. 9643, datë 26.11.2006 "Për prokurimin publik" i ndryshuar.*
*6-UKM nr. 3, datë 27.01.2015 "Për Proçedurën e Prokurimit me Vlerë të Vogël".*
*7-UMF nr.2, datë 06.02.2012 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit".*
*8-Udhëzimin plotësues nr. 1, datë 15.01.2016 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2016".*
*9-UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aseteve në sektorin publik", pika 35, 36.*

*Sa më sipër për të dy periudhat e audituara arrihet në konkluzionin se;*
*-Rezultati procesit të inventarizimit fizik të aktiveve, pasurisë, aseteve e vlerave materiale të njësisë shpenzuese DRM Durrës nuk është i njëtjë me gjendjen që evidneton (pasqyra financiare) në periudhat raportuese 2016; 2017, në këto kushte ky rezultat i inventarizimit fizik të aktiveve, astetve, pasurisë e vlerave materiale nuk i ka shërbyer ndërtimit dhe hartimit të pasqyrës financiare për këto periudha raportuese, për pasojë pasqyrat financiare (bilanci kontabël) konsiderohen se nuk tregojnë dhe nuk pasqyrojnë të plotë realitetin e pasurisë, aseteve e vlerave materiale të institucionit të njësisë shpenzuese.*
*-Procesi inventarizimit fizik i kryer nga komisionet e inventarizimit në përfundim të periudhës raportuese ushtrimore objekt auditimi nuk është kryer në përputhje me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aseteve në sektorin publik", pasi komisioni nuk ka evidentuar e pasqyruar saktësisht sasinë e vlerat e aktiveve për gjatë kryerjes së inventarizimit fizik, duke mos evidentuar cdo vlerë dhe artikull në përdorim.*
*-Për shpenzimet e kryera nga njësia shpenzuese nëpërmjet procedurës së prokurimit "blerje me vlerë e vogël", veprimtaria e anëtarëve të KBVV dhe KMD ka qenë në mospërputhje me Udhëzimin nr. 3, datë 27.01.2015 "Për procedurën e prokurimit me vlerë të vogël".*

***Pika nr.7 e programit të auditimit; "Mbi prokurimin e fondeve publike. Vlerësimi i hartimit të nevojave për mallra, shërbime, nga subjekti audituar. Analizimi dhe vlerësimi i zbatimit të procedurave të prokurimit nga momenti i nxjerrjes së urdhër prokurimit deri në lidhjen e kontratave. Auditimi i lidhjes së kontratës deri në marrjen në dorëzim të mallrave, ndërtimeve e shërbimeve".***

Autoritet Kontraktor (DRM Durrës) për periudhën objekt auditimi (01.10.2016; viti 2017 deri 30.10.2018) ka planifikuar dhe alokuar fonde në buxhetin e institucionit në llog.(602), trajtuar më sipër me buxhetin shpenzime të realizuara për blerje mallra, shërbime dhe punë, ndërsa referuar në regjistrat e parashikimit dhe realizimit të prokurimit publik rezulton se, AK nuk ka përdorur asnjë procedurë prokurimi, sepse fondet e alokuara janë realizuar me procedurë prokurimi "vlerë e vogël nën 100,000 lekë" nëpërmjet rrugës shkresore trajtuar më sipër me urdhër shpenzime, për pasojë kjo pikë e programit të auditimit do të ezaurohet vetëm me këtë shpjegim.

(*Për sa është trajtuar më sipër në pikat nr.2; 3; 4; 5; 6; 7 të programit të auditimit u mbajt Aktkonstatimi nr.2, datë 18.01.2019*).

*Për Projektraportin e Auditimit nga subjekti i audituar me shkresë nr.598/2 prot, datë 23.04.2019 e protokolluar në KLSH[ë] me nr.1275/3 prot, datë 23.04.2019, si dhe nëpërmjet postës elektronike në adresën (vrisvani@klsh.org.al) janë dërguar dhe paraqitur shpjegime me observacion vetëm për sa i përket trajtimit në projektraport për pikat nr.3 dhe 5 të programit të auditimit, duke kundërshtruar e përshkruar me shpjegime për secilin trajtim në projektraporti auditimit. Për kundërshtimet e dërguara nga subjekti i audituar DRM Durrës* ***Sqarojmë se:***
*Kundërshtime me shpjegime janë paraqitur vetëm për sa i përket trajtimit të procedurës të blerjes me vlerë e vogël, shpjegime të C.t nuk kanë asnjë mbështetje dhe argumente ligjore, ndërsa janë vetëm*

*justifikime nga subjekti audituar DRM Durrë dhe nuk shpjegohet pse nuk është zbatuar referimi ligjor i parashikuar në urdhër prokurimi (blerje e vogël) me procedurë elektronike, por është realizuar blerje me vlerë nën 100 mije lekë. Në këto kushte kundërshtimet e dërguara nuk merren në konsideratë dhe mangësitë e konstatuara do trajtohen përsëri në Raportin Përfundimtar të Auditimit.*

**Pika 8 e programit të auditimit e trajtuar me Akt Konstatimin nr. 3: - *Auditim mbi zbatimin e procedurave të vlerësimit të ndikimit në mjedis si dhe dhënia e mendimit për pajisjen e subjektit me leje mjedisore.***

Në zbatim të pikës 8 të programit të auditimit u shqyrtua dokumentacioni i vendosur në dispoozicion sa më poshtë:

1-Aplikimet online, dosjet fizike për Lejet mjedisore të Tipit (C) për periudhën e auditimit 01.10.2016-01.10.2018, të miratuara ose të refuzuara;.

2- Procedura me dokumenta shkresore dhe elektronike në institucion në zbatim për mjedisin.

Në DRM Durrës, nga auditimi i dokumentacionit u konstatuan të meta e mangësi në përcaktimet ligjore në lidhje me zbatimin e procedurave të ndikimit në mjedis dhe paisjen e subjekteve me leje mjedisore.

*Baza ligjore;*

*-ligji nr.10431, datë 9.06.2011 "Për mbrojtjes e mjedisit" ndryshuar me ligji nr.10266, datë 15.04.2010 "Për mbrotjen e ajrit nga ndotja".*

*-ligji nr.19463, datë 22.09.2011"Për manaxhimin e integruar të mbetjeve".*

*-ligji nr.10448, datë 14.07.2011 "Për lejet e mjedisit" ndryshuar me ligji nr.60/2014, datë 19.06.2014 "Për lejet në mjedis".*

*-ligji nr.10081, datë 23.02.2009 "Për liciensat, autorizimet dhe lejet".*

*-VKM nr.47, datë 29.01.2014 "Për Përcaktimin e Rregullave për Organizimin dhe Funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit e të Agjencive Rajonale të Mjedisit"dhe Rregulloren "Për organizimin dhe veprimtarinë e AKM dhe të ARM-ve/ DRM-ve", miratuar datë 20.10.2014 nga Ministri i Mjedisit),*

*-VKM nr.419, datë 25.06.2014 "Për Miratimin e Kërkesave të Posaçme për Shqyrtimin e Kërkesave për Leje Mjedisi të Tipave A,B dhe C, për Transferimin e Lejeve nga një Subjekt tek tjetri, të Kushteve për Lejet Respektive të Mjedisit si dhe Rregullave të Hollësishme për Shqyrtimin e tyre nga Autoritetet Kompetente deri në Lëshimin e Këtyre Lejeve nga QKL" kreun IV pika 3, dhe me pikat 2, pika 4 dhe pika 5 ,ku përcaktohen afatet e procedurës së vendim-marrje.*

*-VKM nr.686, datë 29.05.2015 "Për rehabilitimin e shtretërve dhe brigjeve të lumejve ,të dëmtuara nga shfrytëzimi i inerteve".*

*-VKM nr.189, datë 18.11.2009 "Për rregullat dhe procedurat për hartimin dhe zbatimin e Programit Kombëtar të monitorimit të mjedisit".*

*-VKM nr.435, datë 12.09.2002 "Për miratimin e normave të shkarkimeve në ajër në Repuplikën e Shqipërsië".*

*-VKM nr.247, datë 30.04.2014 "Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e procedurave dhe përfshirjen e publikut në vendimarrjen mjedisore".*

*-VKM nr.10440, datë 7.07.2011"Për vlersimin në mjedis".*

*-VKM nr.417, datë 23.02. 2009 "Për miratimnin e tarifave të lejeve të mjedisit".*

*-VKM nr.371, datë 11.06.2014 "Për mbetjet e rrezikëshme".*

*-VKM nr.229, datë 23.04.2014 "Për miuratimin e rregullave për trasferimin e mbetjeve jo të rrezikëshme".*

<u>Për këtë pikë të programit u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:</u>

-Rregjistri i lejeve të tipi (C) administruar nga DRM Durrës.

-Praktikat e miratim/refuzimit të leje tipi (C) për periudhën e auditimit 01.10.2016-01.10.2018.

-Evidencat e hartuara për lejet e miratuara të tipi (C) për tërheqjen e mendimeve nga NJQV.

-Tabela e miratim/refuzimit i lejes tipi (C) për periudhën e auditimit 01.10.2016-01.10.2018 të grupuara sipas aktivitetit.
-Tabela e miratimeve të lejeve tipi (C) për periudhën e auditimit 01.10.2016-01.10.2018 me afatet e trajtimit në akt-kontrollet e DRM Durrës.
-Tabela e rasteve të refuzimeve të lejes tipi (C) për periudhën e auditimit 01.10.2016-01.10.2018 të grupuara sipas aktivitetit, afatet e trajtimit, aktkontrollet e DRM Durrës.

**8.a. *Auditimi i praktikave të miratimit të lejeve mjedisore të tipit C në drejtim të marrjes së përgjigjeve nga NJ.Q.V-të për mbështetjen e miratimeve të lejeve si pjesë e dokumentacionit ligjor.***

DRM Durrës për periudhën e auditimit 01.10.2016-01.10.2018, sipas të dhënave në tre tabelat e mëposhtme, ka lejuar vendimarrjen për miratim dhe refuzim leje mjedisore tipi (C) në mungesë të mendimit të NjQV$^{-se}$, duke vijuar me procedurat "***pa kthim përgjigje***" brenda afatit 3 ditor nga NJQV$^{-të}$ për mendim veprim, në kundërshtim me VKM nr.419, datë 25.06.2014 "Për Miratimin e Kërkesave të Posaçme për Shqyrtimin e Kërkesave për Leje Mjedisi të Tipave A, B, C për Transferimin e Lejeve nga një Subjekt tek tjetri, të Kushteve për Lejet Respektive të Mjedisit si dhe Rregullave të Hollësishme për Shqyrtimin e tyre nga Autoritetet Kompetente deri në Lëshimin e Këtyre Lejeve nga QKL*",* Kreun IV, pika 3 me pikat 2, 4, 5, ku përcaktohen afatet e procedurës së vendimarrjes (*3 ditë AKM-DRM+3 ditë DRM-NJQV+3 ditë NJQV-DRM 7 ditë pune*), pasqyruar në tabelën të mëposhtme:

*Tabela e njoftimeve të DRM Durrës të aplikimeve për tërheqje mendimi (konfirmimi) nga NJQV për lejet të Tipit C dhe përgjigjet nga NJQV-të për periudhën* ***tetor-dhjetor 2016***

*Tabela nr.19*

| VITI 2016 | Bashkia Krujë | Bashkia Shijak | Bashkia Durrës |
|---|---|---|---|
| **Dërguar** | 5 | 8 | 20 |
| **Kthim Përgjigje** | 5 | 0 | 20 |

Nga të dhënat e pasqyruara në tabelën më lart rezulton se:

**<u>Për gjithë vitin 2016</u>** DRM Durrës për **86** raste aplikimi për Leje Tipi C + VNM (ose 18+68 raste) ka dërguar në tre bashkitë Durrës, Krujë e Shijak **33** njoftime për vendimarrje për leje të tipi (C) për të C.t ka marrë mendimin e NJQV$^{-ve}$ për 25 raste. DRM Durrës ka dërguar për mendim 38% të rasteve duke mos dërguar për mendim në NJQV 62% të rasteve të marra në shqyrtim L.C+VNM për këtë periudhë. Nga ana e NJQV është kthyer përgjigje mbi njoftimet në masën 76% dhe nuk është kthyer në 8 raste në masën 24%. DRM Durrës ka vijuar me të drejtë procedurat e miratimit të lejeve pa kthim përgjigje për këto 8 raste nga ana e NJQV, referuar pikës 3, VKM nr. 419, datë 25.06.2014 "***Mbi afatin 3 ditor***` të përgjigjes për mendimin e NJQV për miratimin e lejeve mjedisore tipi (C). Nga ana tjetër, DRM Durrës duhej të kishte dërguar për mendim edhe 25 rastet e tjera.

*Tabela e njoftimeve të DRM Durrës të aplikimeve për tërheqje mendimi (konfirmimi) nga NJQV për lejet të Tipit C dhe përgjigjet nga NJQV-të për* ***vitin 2017***

*Tabela nr.20*

| VITI 2017 | Bashkia Krujë | Bashkia Shijak | Bashkia Durrës |
|---|---|---|---|
| **Dërguar** | 20 | 17 | 63 |
| | 16 | 3 | 56 |

| Kthim Përgjigje | | | |
|---|---|---|---|

*Burimi: DRM Durrës*

**Për vitin 2017** DRM Durrës për **258** dosje aplikimi për Leje Tip C + Mendim për VNM ka njoftuar NJQV në tre bashkitë Durrës, Krujë e Shijak në **100** raste ose në masën 39% dhe nuk ka kryer noftime në 158 raste në masën 61%. Nga 100 raste që ka marrë njoftim, NJQV janë përgjigjur në 75 raste ose në masën 75%. Në rastet e moskthimit të përgjigjes nga ana e NJQV DRM Durrës ka kryer vendimarrje për miratim ose refuzim për leje tipit (C) në mungesë të mendimit të NJQV$^{-ve}$ për 25 raste të tilla. DRM ka vijuar për këto raste procedurat e miratimit të lejeve pa kthim përgjigje, sipas pikës 3 të VKM nr.419, datë 25.06.2014 "***Mbi afatin 3 ditë"*** të përgjigjes për mendimin e NJQV për miratimin e lejeve mjedisore tipi (C).

*Tabela e njoftimeve të DRM Durrës të aplikimeve për tërheqje mendimi (konfirmimi) nga NJQV për lejet të Tipit C dhe përgjigjet nga NJQV-të për periudhën e 9 mujorit te parë të **Vitit 2018***

*Tabela nr.21*

| NJQV/Durrës, Krujë,Shijak | Dërguar | Kthim përgjigje |
|---|---|---|
| Janar | 3 | 3 |
| Shkurt | 12 | 10 |
| Mars | 10 | 8 |
| Prill | 13 | 9 |
| Maj | 12 | 10 |
| Qershor | 16 | 8 |
| Korrik | 19 | 7 |
| Gusht | 16 | 10 |
| Shtator | 18 | 4 |
| Tetor | 25 | 19 |

*Burimi: DRM Durrës*

**Për periudhën e 9 mujorit te parë të vitit 2018** DRM Durrës për **326** dosje aplikimi për Leje Tip C + Mendim për VNM ka njoftuar NJQV në tre bashkitë Durrës, Krujë e Shijak në **144** raste ose në masën 44% dhe nuk ka kryer noftime në 144 raste ose në masën 66%. Nga 144 raste që ka marrë njoftim, NJQV janë përgjigjur në 88 raste ose në masën 61% të rasteve të njoftuara. Në rastet e moskthimit të përgjigjes nga ana e NJQV DRM Durrës ka kryer vendimarrje për miratim ose refuzim për leje tipit (C) në mungesë të mendimit të NJQV$^{-ve}$ për 56 raste të tilla. DRM ka vijuar për këto raste procedurat e miratimit të lejeve pa kthim përgjigje, sipas pikës 3 të VKM nr.419, datë 25.06.2014 "***Mbi afatin 3 ditë"*** të përgjigjes për mendimin e NJQV për miratimin e lejeve mjedisore tipi (C).

**Për periudhën 1 tetor 2016 – 1 tetor të vitit 2018** DRM Durrës ka shqyrtuar gjithësej për gjithë periudhën e auditimit **670** dosje për Leje Tip C + mendim VNM (ose respektivisht 526+ 144 dosje gjithësej) duke kryer njoftim në NJQV në **277** raste, në masën **41 %** të tyre. NjQV janë përgjigjur gjithësej në **188** raste ose në masën **67%** të rasteve të njoftuara, në mungesë të të C.ve DRM ka vijuar procedurat e miratimit të lejeve pa kthim përgjigje duke mos zbatuar nga NJQV, pika 3 VKM nr.419, datë 25.06.2014 "***Mbi afatin 3 ditor"*** të përgjigjes për mendimin e NJQV për miratimin e lejeve mjedisore tipi (C).

**Konkluzion:** Nga sa u trajtua më sipër në zbatimin e procedurës së licencimit tipi (C) dhe VNM për periudhën e auditimit 01.10.2016-01.10.2018, ka mangësi nga ana e DRM Durrës në

njoftimin e NJQV si edhe mungesë pjesëmarrje të NJQV-ve në vendimarrjet e saj, shprehur me vonesat apo me moskthimin e përgjigjeve, të C.t janë bërë shkak mos bashkëpunimi me institucionet e tjera. Si pasojë DRM Durrës i është përmbajtur përcaktimit ligjor të pikës 4 Kreu IV VKM nr.419, datë 25.06.2014 ku thuhet se: "*...nëse NJQV-ja përkatëse nuk shprehet brenda afatit (3 ditë), DRM-ja vazhdon procedurën....*".

***Për këtë DRM/ARM Durrës duhej ti drejtohej AKM Tiranë për mos zbatimin e pikës 3 të afatit të vendosur prej 3 ditësh sipas VKM nr.419, datë 25.06.2014, me synim tërheqjen e vëmendjes nga Institucionet Qendrore për rritjen e pjesëmarrjes së NJQV-ve në procesin e liçencimit, pasi veprimtaritë zhvillohen dhe mbrojtja e mjedisit arrihet në territorin nën juridiksionin e tyre.***

Përsa më sipër bazuar në VKM nr.47, datë 29.01.2014 "Për Përcaktimin e Rregullave për Organizimin dhe Funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit e të Agjencive Rajonale të Mjedisit" dhe rregullores "Për organizimin dhe veprimtarinë e AKM dhe të DRM-ve" e miratuar datë 20.10.2014 nga Ministri i Mjedisit, ngarkohen me përgjegjësi për insistim më të madh për plotësimin e kërkesave të sipërcituara: Znj. K.K. për periudhën e auditimit 1.10.2016- 22.01.2018; Z. B.Gj. për periudhën 23.01.2018-17.5.2015 dhe Znj. B. H. për periudhën 17.05.2018-1.10.2018 dhe specialistët e vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) E.V., S.V., K.P., E.Sh., L. D..

***8.b.Mbi zbatimin e procedurave ligjore dhe plotësimin e dokumentacionit të Akt Miratimeve në dhënien e Leje Mjedisore Tipi (C).***

Auditim mbi zbatimin e procedurave dhe hartimin e dokumentacionit të lejeve tip (C), në zbatim të VKM nr. 419, datë 25.06.2014 "Për Lejet e Mjedisit" Kreu IV, pika 5,

Nga auditimi u konstatua se, DRM Durrës ka filluar aktivitetin e saj në zbatim të VKM nr.47, datë 29.01.2014 "Për përcaktimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit e të Agjencive Rajonale të Mjedisit" eC. në kapitulli V citon se; "Funksionet e AKM dhe ARM-ve (DRM) pika 2, "*Agjencitë Rajonale të Mjedisit brenda kompetencave që u njeh ligji, ushtrojnë funksionet e mëposhtme: japin lejen e mjedisit të tipit C, sipas përcaktimeve në ligjin nr.10448, datë 14.7.2011 "Për lejet e mjedisit"" i ndryshuar*.

DRM Durrës ka mbajtur dhe ka përditësuar në formë fizike dhe elektronike regjistrin e akt miratimeve dhe akt refuzimeve sipas formatit standard të shtojcës 4 të Urdhri Ministrit të Mjedisit nr.1964, datë 13.11.2014 "Për miratimin e procedurave të administrimit dhe formatit të regjistrave të lejeve të mjedisit të tipit A, B, C" që "*mbajnë dhe përditësojnë regjistrin sipas shtojcës 6 të VKM nr. 419, datë 25.06.2014, me të dhëna për instalimet e kategorisë C, që ndodhen brenda territorit ku shtrihet fusha e kompetencave të tyre"*. Por gjatë auditimit u konstatua se DRM Durrës nuk ka të evidentuar listën e subjekteve aktive, të përditësuar, të subjekteve që duhet të jenë të pajisura me leje mjedisore të tipit (C), të nxjerrë nga bashkëpunimi periodik me DRT, Durrës, QKL, ISHMPUT apo dhe me NJVQV-të (3 bashki) për numrin e përgjithshëm të subjekteve që ushtrojnë veprimtari në qarkun Durrës e që kanë ndikim në mjedis, me detyrim pajisjen me leje mjedisi për ushtrimin e veprimtarive ekonomike.

Për miratimin e lejeve të tipi C në zbatim të VKM nr.47, datë 29.01.2014 Kreu V "Funksionet e AKM, ARM (DRM) dhe kërkesave të ligjit nr. 10448, datë 14.07.2011 "Për Lejet e Mjedisit" dhe Urdhri nr. 38, datë 17.03.2015 të Drejtorit të Përgjithshëm të AKM, Drejtori i DRM Durrës me urdhëra të vecanta ka ngritur komisionin e shqyrtimit të aplikimeve për leje mjedisi tipi (C) i përbërë nga Drejtori dhe specialistet e monitorimit. Shqyrtimi i aplikimeve për leje mjedisi bëhet nga komisioni ku për shkak të numrit të kufizuar mungon grafiku i hartuar nga drejtori DRM Durrës në zbatim të urdhërave nr.109 dhe 1847, datë 06.10.2015 "Për zbardhjen

e akt miratimeve dhe refuzimeve për leje mjedisi tipi C". Në DRM Durrës u audituа edhe libri i protokollit dhe u konstatua se mbajtja e procesverbaleve të mbledhjeve të komisioneve kishte mangësi nga ana drejtshkrimore dhe zbatimi i rregullave të korrektimit dhe fjalitë shpesh herë kanë qenë të paplota dhe të pakuptueshme dhe pa koherence kuptimore për të paraqitur me saktësi qëndrimin e antarëve të komisionit gjatë shqyrtimit të aplikimeve për leje.

Subjektet kanë aplikuar për leje mjedisi tipi (C), konform legjislacionit në fuqi dhe nëpërmjet QKL Tiranë. Në rrugë elektronike QKL i ka dërguar aplikimet në AKM Tiranë eC. po në mënyrë elektronike, me postë elektronike (e-mail) zyrtar i ka përcjellë kërkesat për leje në DRM Durrës. Të gjitha kërkesat e subjekteve që kanë ardhur në formë elektronike në DRM Durrës janë të qarta dhe jo të dëmtuara, gjë që lejon mundësinë e verifikimit të tyre, nëse janë kryer procedurat e përcaktuara në Kreu IV, VKM nr. 419, datë 25.06.2014 "Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipit A, B, C, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullat e hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKL-ja".

Nga DRM Durrës kryhej edhe ruajtja e dokumentacionit të kërkesave për aplikimet e bëra për leje mjedisi tipi (C) në formë shkresore, gjë eC. bën të mundur ruajtjen e tyre në dosje të veçanta për çdo subjekt. Kështu në rast dëmtimi të dokumentacionit elektronik, disponohen të dhënat shkresore për dokumentacionin e subjekteve. Në përmbushje të kërkesave të ligjit nr.10448, datë 14.07.2011 "Për lejet e mjedisit" e në zbatim të VKM nr. 419, datë 25.06.2014 konstatohet se, aplikuesit për leje mjedisi nuk i plotësojnë saktë formularët standard të aplikimit.

Nga auditimi u konstatua se ka pa aftësi në përgatitjen e dokumentacionit për aplikimet e më poshtëme.

**<u>1 Tetor 2016-31 dhjetor Viti 2016</u>**

Për periudhën **1 Tetor - 31 Dhjetor 2016** për shqyrtimin e aplikimeve për leje tipi (C) komisioni i shqyrtimit të aplikimeve është mbledhur për të shqyrtuar dokumentacionin e dhënies së lejeve mjedisit. Lista e aplikimeve leje tip (C) e subjekteve sipas disa aktiviteteve më të zakonshme të biznesit që kryejnë aktivitet pasi janë pajisur me këtë leje, pasqyrohet me poshtë:

*Përmbledhëse e shkurtuar sipas aktivitetit - miratime e refuzime numer leje DRM Durrës për disa kategori biznesesh për periudhën* **1.10.-31.12. Viti 2016**

*Tabela nr.22*

| Nr | Aktiviteti | 1.10.-31.12. Viti 2016 | |
|---|---|---|---|
| | | Miratim | Refuzim |
| 1 | Karburant+ gaz | 2 | 5 |
| 2 | Materiale ndërtimi | Nuk jane më objekt i paisjeve me leje mejdisi tipi c | |
| 3 | Prerja, gdhendja dhe lustrimi i gurit | 0 | 0 |
| 4 | Magazinim skrapi | 1 | 0 |
| 5 | Baxho Përpunim qumështi | 0 | 0 |
| 6 | Furra të prodhimit të bukës | 4 | 1 |
| 7 | Riparim e paisje motorrike | 2 | 3 |
| 8 | Labarator mjekësore | 0 | 2 |
| 9 | Prodhim mobilje | 2 | 2 |
| 10 | Servis dhe gomisteri | 0 | 0 |
| 1 | Lavazh | 0 | 0 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| 1 | | | |
| 12 | Prodhim i produkteve te perbere kryesisht apo teresisht nga druri | 1 | 0 |
| **TOTALI** | | **12** | **12** |

*Burimi: DRM Durrës*

Më poshtë po japim sipas tre periudhave të auditimit në mënyrë më të detajuar numrin e subjekteve të miratuara të gjetura nga auditimi me zgjedhje i **323** dosjeve (nga 526 dosje të tilla në total si aplikime) për këto tre periudha, **me shkelje të ndryshme ligjore** nga ana e DRM Durrës, në pajisjen me **Leje të Tipit C**, sipas kategorive të ndryshme të aktivitetit të biznesit, veprime këto **në kundërshtim** me me shtojcën 6, pika 9 (Formati standard i aktit të miratimit dhe aktit të refuzimit të aplikimit për lejet e mjedisit të tipit C është sipas shtojcës 6), Kreu IV formulari i akt-miratimit, pika 10 (Akti i miratimit për lejen e mjedisit të tipit C, për çdo instalim, përmban:), germat a, b, c, ç , d, dhe dh të VKM nr. 419, datë 25.6.2014 “Për Miratimin e Kërkesave të Posacme për Shqyrtimin e Kërkesave për Leje Mjedisi të Tipave A, B dhe C, për Transferimin e Lejeve nga një Subjekt tek tjetri, të Kushteve për Lejet Respektive të Mjedisit si dhe Rregullave të Hollësishme për Shqyrtimin e tyre nga Autoritetet Kompetente deri në Lëshimin e Këtyre Lejeve nga QKL”

**<u>a. Miratimet e dhënies së lejeve tipi C për periudhën 1 Tetor 2016-31 dhjetor 2016.</u>**

Nga auditimi për periudhën 1 Tetor - 31 Dhjetor 2016 u konstatua se janë marrë **68 vendime** nga të C.t janë miratuar **45** leje mjedisore tipi (C) dhe janë refuzuar **23** aplikime për leje mjedisore të tilla.

Nga auditimi i dokumentacionit të dosjeve mbajtur në format elektronik dhe shkresor, pas auditimit me zgjedhje të rastit të akteve të miratimit, rezultoi se në disa praktika të lejeve mjedisore Tipi C të miratuara ka mangësi si mungesa e aktverifikimeve, relacioneve, nga specialistet dhe vendosjen e kushteve për mbrojtjen e mjedisit, veprime në kundërshtim me shtojcën 6, pika 9, Kreu IV formulari akt-miratimit pika 10, germa a, b, c, ç , d, dh VKM nr. 419, datë 25.6.2014 “Për Miratimin e Kërkesave të Posacme për Shqyrtimin e Kërkesave për Leje Mjedisi të Tipave A, B dhe C, për Transferimin e Lejeve nga një Subjekt tek tjetri, të Kushteve për Lejet Respektive të Mjedisit si dhe Rregullave të Hollësishme për Shqyrtimin e tyre nga Autoritetet Kompetente deri në Lëshimin e Këtyre Lejeve nga QKL”, pasqyruar në tabelën emërtuar si mësipër.

**a/1** -Për periudhën **Tetor, Nëntor dhe Dhjetor të vitit 2016** nga auditimi me zgjedhje i ushtruar në dosjet e aplikimit të miratuara për **ID 7.7.n** (Gatimi dhe tregtimi i produkteve ushqimore të gatshme dhe gjysmë të gatshme), referuar Shtojcës I të Ligjit nr. 10 448, datë 14.07.2011 “Për Lejet e Mjedisit” te ndryshuar, në miratimet për këtë aktivitet në listën më poshtë për 5 subjekte u konstatuan disa mangësi si më poshtë vijon:

**Gjetje 1. M.G.,** miratuar kërkesa për leje të tipit C në dt. 02.11.2016 me aktivitet ‘Gatimi dhe tregtimi i produkteve ushqimore të gatshme dhe gjysmë të gatshme’ kërkesa eshtë bërë për impiante dhe instalime te reja ndërkohë që janë instalime ekzistuese dhe përshkrimet e instalimeve për zhvillimin e aktivitetve nuk rezultojnë të plota referuar Shtojcës I të Ligjit nr. 10 448, datë 14.07.2011 “Për Lejet e Mjedisit” te ndryshuar. Cito nenin perkates dhe pasoja dhe pergjegjesia .

**Gjetje 2.** Aplikanti **A.H.** miratuar kërkesa për leje të tipit C në dt.06.10.2016 nuk është e plotësuar Tabela e shkarkimeve në ajër në kundërshtim me përcaktimet në Shtojcën I të Ligjit nr. 10 448, datë 14.07.2011 “Për Lejet e Mjedisit” te ndryshuar.

**Gjetje 3.** Subjekti aplikant **T.Sh.I.**, miratuar kërkesa për leje të tipit C në dt.14.11.2016 me aktivitet ‘Gatimi dhe tregtimi i produkteve ushqimore të gatshme dhe gjysmë të gatshme’, nga auditimi u konstatua se në aplikim nuk deklarohet sasia e vajrave të përdorur ose burimi dhe ka

mangësi në lidhje me përcaktimin e shkarkimit të ujrave; gjithashtu nuk është e plotësuar as Tabela e shkarkimeve në ajër.

**Gjetje 4.** Aplikanti **A.B.,** miratuar kërkesa për leje të tipit C në dt. 02.11.2016 me aktivitet 'Gatimi dhe tregtimi i produkteve ushqimore të gatshme dhe gjysmë të gatshme' ka mangësi në lidhje me shkarkimin e ujrave, nuk përcaktohet se si veprohet me vajrat e gjeneruara nga aktiviteti duke shkuar në kundërshtim me Shtojcën I të Ligjit nr. 10 448, datë 14.07.2011 "Për Lejet e Mjedisit" te ndryshuar.

**Gjetje 5.** Aplikanti **G.N.**, miratuar kërkesa për leje të tipit C në dt. 13.10.2016 me aktivitet 'Gatimi dhe tregtimi i produkteve ushqimore të gatshme dhe gjysmë të gatshme', nga auditimi u konstatua se përshkrimet e instalimeve për zhvillimin e aktivitetve nuk rezultojnë të plota, referuar Shtojcës I të Ligjit nr. 10 448, datë 14.07.2011 "Për Lejet e Mjedisit" të ndryshuar.

Më poshtë po i japim në format tabelar të përmledhura këto 5 raste të miratimit të Leje Tip C:

*Tabela nr.23*

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 1. | 6091-10-2016 | M.G. | MIRATUAR | 02.11.2016 |
| 2. | 6340-10-2016 | A.B. | MIRATUAR | 02.11.2016 |
| 3. | 7111-11-2016 | T.Sh.I. | MIRATUAR | 14.11.2016 |
| 4. | 5676-09-02016 | A.H. | MIRATUAR | 06.10.2016 |
| 5. | 5970-10-2018 | G.N. | MIRATUAR | 13.10.2016 |

*Burimi: DRM Durrës*

**a/2 Aplikimet për vitin 2017 për leje tip C**

Në rrugë elektronike QKL i ka dërguar aplikimet në AKM Tiranë dhe AKM[-ja], po në mënyrë elektronike me anë të e-mail-it zyrtar i ka përcjellë kërkesat për leje DRM Durrës.

Lista e aplikimeve leje tipi C e Subjekteve për vitin 2017 sipas aktivitetit që kryejnë, miratimet dhe refuzimet paraqiten në tabelën e mëposhtme.

*Përmbledhëse e shkurtuar sipas aktivitetetve kryesore - miratime e refuzime nga DRM Durrës për vitin 2017*

*Tabela nr.24*

| Nr | **Aktiviteti** | **Viti 2017** | |
|---|---|---|---|
| | | Miratim | Refuzim |
| 1 | Karburant+ gaz | 20 | 12 |
| 2 | Materiale ndërtimi | Nuk jane me objekt i paisjese me leje mejdisi tipi c | |
| 3 | Prerja, gdhendja dhe lustrimi i gurit | 10 | 2 |
| 4 | Magazinim skrapi | 5 | 1 |
| 5 | Baxho Përpunim qumështi | 1 | 0 |
| 6 | Furra të prodhimit të bukës | 6 | 1 |
| 7 | Riparim e paisje motorrike | 19 | 3 |
| 8 | Labarator mjekësore | 1 | 3 |
| 9 | Prodhim mobilje | 1 | 0 |
| 10 | Servis dhe gomisteri | 5 | 0 |
| 11 | Lavazh | 2 | 0 |
| 12 | Prodhim i produkteve te perbere kryesisht apo teresisht nga druri | 5 | 1 |

| | | |
|---|---|---|
| **TOTALI** | **75** | **23** |

*Burimi: DRM Durrës*

Sipas tabelës dhe dokumentacionit të paraqitur rezulton se gjatë gjithë **vitit 2017** DRM Durrës nëpërmjet **42** Vendimeve ka shqyrtuar **193** aplikime për Leje Mjedisore Tipi C duke miratuar **154** leje dhe refuzuar **39** aplikime të subjekteve për leje mjedisore tipi C, ose 79.7% miratime dhe 20.3% refuzime nga numri total i aplikimeve.

Nga auditimi me zgjedhje i dokumentacionit të dosjeve mbajtur në format elektronik dhe shkresor si dhe i akteve të miratimit të 154 praktikave, rezultoi se në lejet mjedisore Tipi C të miratuara u konstatuan mangësi tek akt-verifikimet e relacionet nga specialistët në vendosjen e kushteve për mbrojtjen e mjedisit, veprime në kundërshtim me shtojcën 6, pika 9, Kreu IV formulari i akt-miratimit pika 10, germa a, b, c, ç , d, dh të VKM nr. 419, datë 25.6.2014 "Për Miratimin e Kërkesave të Posacme për Shqyrtimin e Kërkesave për Leje Mjedisi të Tipave A, B dhe C, për Transferimin e Lejeve nga një Subjekt tek tjetri, të Kushteve për Lejet Respektive të Mjedisit si dhe Rregullave të Hollësishme për Shqyrtimin e tyre nga Autoritetet Kompetente deri në Lëshimin e Këtyre Lejeve nga QKL".

"Miratimi i lejeve tip C në DRM Durrës viti 2017".

Nga auditimi i procedures për leje tipi C për **vitin 2017** po paraqesim disa subjektet teC.t janë pajisur gabimisht me Leje Tipi C: **A.1) subjekte nga ID 1.10/11** "Furnizimi me karburant i makinave në një stacion të furnizimit me karburant dhe furnizimi me GLN" që kanë aplikuar dhe **A.2) subjekte sipas ID 10.5** qe janë pajisur me Leje të Tipit C "Riparimi i paisjeve motorike dhe motocikletave" sipas listimeve dhe dy tabelave përmbledhëse më poshtë:

**Gjetje nga auditimi 6:** Nga auditimi i aplikimit të subjektit **G.C. GKG** (2084-06-2017) rezultoi se mungon përcaktimi se si veprojnë me llumrat e krijuara në depozitat e karburanteve, në kundërshtim me shtojcën 6, pika 9, Kreu IV formulari i akt-miratimit pika 10, germa a, b, c, ç , d, dh të VKM nr. 419, datë 25.6.2014 "Për Miratimin e Kërkesave të Posacme për Shqyrtimin e Kërkesave për Leje Mjedisi të Tipave A, B dhe C, për Transferimin e Lejeve nga një Subjekt tek tjetri, të Kushteve për Lejet Respektive të Mjedisit si dhe Rregullave të Hollësishme për Shqyrtimin e tyre nga Autoritetet Kompetente deri në Lëshimin e Këtyre Lejeve nga QKL". **Gjetje nga auditimi 7:** Nga auditimi i aplikimit të subjektit **B-R.** (1705-06-2017) rezultoi se përshkrimi i instalimeve nuk është i plotë, në kundërshtim me shtojcën 6, pika 9, Kreu IV formulari i akt-miratimit pika 10, germa a, b, c, ç , d, dh të VKM nr. 419, datë 25.6.2014 "Për Miratimin e Kërkesave të Posacme për Shqyrtimin e Kërkesave për Leje Mjedisi të Tipave A, B dhe C, për Transferimin e Lejeve nga një Subjekt tek tjetri, të Kushteve për Lejet Respektive të Mjedisit si dhe Rregullave të Hollësishme për Shqyrtimin e tyre nga Autoritetet Kompetente deri në Lëshimin e Këtyre Lejeve nga QKL".

**Gjetje nga auditimi 8:** Nga auditimi i aplikimit të subjektit **S. G** (2410-07-2017) rezultoi se në aplikim mungojnë sasia dhe burimi i lëndëve të para dhe përshkrimi i instalimeve nuk është i plotë, në kundërshtim me shtojcën 6, pika 9, Kreu IV formulari i akt-miratimit pika 10, germa a, b, c, ç , d, dh të VKM nr. 419, datë 25.6.2014 "Për Miratimin e Kërkesave të Posacme për Shqyrtimin e Kërkesave për Leje Mjedisi të Tipave A, B dhe C, për Transferimin e Lejeve nga një Subjekt tek tjetri, të Kushteve për Lejet Respektive të Mjedisit si dhe Rregullave të Hollësishme për Shqyrtimin e tyre nga Autoritetet Kompetente deri në Lëshimin e Këtyre Lejeve nga QKL".

**Gjetje nga auditimi 9:** Nga auditimi i aplikimit të subjektit **K.** (2771-07-2017) rezultoi se në aplikim mungojnë sasia dhe burimi i lëndëve të para dhe përshkrimi i instalimeve nuk është i plotë, në kundërshtim me shtojcën 6, pika 9, Kreu IV formulari i akt-miratimit pika 10, germa a, b, c, ç , d, dh të VKM nr. 419, datë 25.6.2014 "Për Miratimin e Kërkesave të Posacme për

Shqyrtimin e Kërkesave për Leje Mjedisi të Tipave A, B dhe C, për Transferimin e Lejeve nga një Subjekt tek tjetri, të Kushteve për Lejet Respektive të Mjedisit si dhe Rregullave të Hollësishme për Shqyrtimin e tyre nga Autoritetet Kompetente deri në Lëshimin e Këtyre Lejeve nga QKL".

**Gjetje nga auditimi 10:** Nga auditimi i aplikimit të subjektit **L.O.** (5183-12-2017) rezultoi se në aplikim nuk përcaktohet se si ata veprojnë me llumrat e krijuara në depozitat e karburanteve, në kundërshtim me shtojcën 6, pika 9, Kreu IV formulari i akt-miratimit pika 10, germa a, b, c, ç , d, dh të VKM nr. 419, datë 25.6.2014 "Për Miratimin e Kërkesave të Posacme për Shqyrtimin e Kërkesave për Leje Mjedisi të Tipave A, B dhe C, për Transferimin e Lejeve nga një Subjekt tek tjetri, të Kushteve për Lejet Respektive të Mjedisit si dhe Rregullave të Hollësishme për Shqyrtimin e tyre nga Autoritetet Kompetente deri në Lëshimin e Këtyre Lejeve nga QKL".

**Gjetje nga auditimi 11:** Nga auditimi i aplikimit të subjektit **I.P.A.** (46-12-2017) rezultoi se në aplikim mungojnë sasia dhe burimi i lëndëve të para dhe në shumicën e rasteve mungojnë dokumenta të planifikimit të zonës, në kundërshtim me shtojcën 6, pika 9, Kreu IV formulari i akt-miratimit pika 10, germa a, b, c, ç , d, dh të VKM nr. 419, datë 25.6.2014 "Për Miratimin e Kërkesave të Posacme për Shqyrtimin e Kërkesave për Leje Mjedisi të Tipave A, B dhe C, për Transferimin e Lejeve nga një Subjekt tek tjetri, të Kushteve për Lejet Respektive të Mjedisit si dhe Rregullave të Hollësishme për Shqyrtimin e tyre nga Autoritetet Kompetente deri në Lëshimin e Këtyre Lejeve nga QKL".

Në pjesën V të Anekse janë tabelat tabelat e përmbledhura me subjektet e përmendura (shih Tabela a).

**Gjetje nga auditimi 12:** Nga auditimi i aplikimit të subjektit **P.D.** (2927.8.2017) rezultoi se mungon një dokument i planifikimit të zonës ku kryhet veprimtaria, në kundërshtim me shtojcën 6, pika 9, Kreu IV formulari i akt-miratimit pika 10, germa a, b, c, ç , d, dh të VKM nr. 419, datë 25.6.2014 "Për Miratimin e Kërkesave të Posacme për Shqyrtimin e Kërkesave për Leje Mjedisi të Tipave A, B dhe C, për Transferimin e Lejeve nga një Subjekt tek tjetri, të Kushteve për Lejet Respektive të Mjedisit si dhe Rregullave të Hollësishme për Shqyrtimin e tyre nga Autoritetet Kompetente deri në Lëshimin e Këtyre Lejeve nga QKL".

**Gjetje nga auditimi 13:** Nga auditimi i aplikimit të subjektit **M.A.I.** (2851-07-2017) rezultoi se ka disa mangësi në dokumentacionin e aplikimit psh, përshkrimi i instalimit nuk është bërë i detajuar, në kundërshtim me shtojcën 6, pika 9, Kreu IV formulari i akt-miratimit pika 10, germa a, b, c, ç , d, dh të VKM nr. 419, datë 25.6.2014 "Për Miratimin e Kërkesave të Posacme për Shqyrtimin e Kërkesave për Leje Mjedisi të Tipave A, B dhe C, për Transferimin e Lejeve nga një Subjekt tek tjetri, të Kushteve për Lejet Respektive të Mjedisit si dhe Rregullave të Hollësishme për Shqyrtimin e tyre nga Autoritetet Kompetente deri në Lëshimin e Këtyre Lejeve nga QKL".

**Gjetje nga auditimi 14:** Nga auditimi i aplikimit të subjektit **A.Sh.** (3989-09-2017) rezultoi se ka disa mangësi në dokumentacionin e aplikimit psh, këtu mungonte kontrata për vajrat e përdorura, në kundërshtim me shtojcën 6, pika 9, Kreu IV formulari i akt-miratimit pika 10, germa a, b, c, ç , d, dh të VKM nr. 419, datë 25.6.2014 "Për Miratimin e Kërkesave të Posacme për Shqyrtimin e Kërkesave për Leje Mjedisi të Tipave A, B dhe C, për Transferimin e Lejeve nga një Subjekt tek tjetri, të Kushteve për Lejet Respektive të Mjedisit si dhe Rregullave të Hollësishme për Shqyrtimin e tyre nga Autoritetet Kompetente deri në Lëshimin e Këtyre Lejeve nga QKL".

**Gjetje nga auditimi 15:** Nga auditimi i aplikimit të subjektit **A.** (4978-11-2017) rezultoi se ka disa mangësi në dokumentacionin e aplikimit psh, këtu mungonte tabela e shkarkimeve në ajër në kundërshtim me shtojcën 6, pika 9, Kreu IV formulari i akt-miratimit pika 10, germa a, b, c, ç , d, dh të VKM nr. 419, datë 25.6.2014 "Për Miratimin e Kërkesave të Posacme për Shqyrtimin e Kërkesave për Leje Mjedisi të Tipave A, B dhe C, për Transferimin e Lejeve nga një Subjekt tek tjetri, të Kushteve për Lejet Respektive të Mjedisit si dhe Rregullave të Hollësishme për Shqyrtimin e tyre nga Autoritetet Kompetente deri në Lëshimin e Këtyre Lejeve nga QKL".

**Gjetje nga auditimi 16:** Nga auditimi i aplikimit të subjektit **A.K.** (4955-11-2017) rezultoi se ka disa mangësi në dokumentacionin e aplikimit psh, këtu mungonte tabela e ujrave të ndotura në kundërshtim me shtojcën 6, pika 9, Kreu IV formulari i akt-miratimit pika 10, germa a, b, c, ç , d, dh të VKM nr. 419, datë 25.6.2014 "Për Miratimin e Kërkesave të Posacme për Shqyrtimin e Kërkesave për Leje Mjedisi të Tipave A, B dhe C, për Transferimin e Lejeve nga një Subjekt tek tjetri, të Kushteve për Lejet Respektive të Mjedisit si dhe Rregullave të Hollësishme për Shqyrtimin e tyre nga Autoritetet Kompetente deri në Lëshimin e Këtyre Lejeve nga QKL".

**Gjetje nga auditimi 17:** Nga auditimi i aplikimit të subjektit **A.C.** (4955-11-2017) rezultoi se ka disa mangësi në dokumentacionin e aplikimit, psh këtu mungonte një dokument i planifikimit të zonës ku kryhet veprimtaria dhe kontrata e vajrave të përdorura dhe e ujrave të ndotura, në kundërshtim me shtojcën 6, pika 9, Kreu IV formulari i akt-miratimit pika 10, germa a, b, c, ç , d, dh të VKM nr. 419, datë 25.6.2014 "Për Miratimin e Kërkesave të Posacme për Shqyrtimin e Kërkesave për Leje Mjedisi të Tipave A, B dhe C, për Transferimin e Lejeve nga një Subjekt tek tjetri, të Kushteve për Lejet Respektive të Mjedisit si dhe Rregullave të Hollësishme për Shqyrtimin e tyre nga Autoritetet Kompetente deri në Lëshimin e Këtyre Lejeve nga QKL".

Në seksionin e Anekseve (V) po japim tabelën e përmbledhur me subjektet e përmendura (Tabela – b-) .

**a/3.** Nga auditimi i procedures për leje tipi C për periudhën e auditimit për **vitin 2018** janë marrë **43 Vendime** nga të C.t janë shqyrtuar **265 dosje** aplikimi për Leje Mjedisi Tipi C, janë marrë **79 Akt-Miratime dhe 165 Akt-Refuzime**. Në ndryshim nga vitet e mëparshme bie në sy numri shumë i madh i refuzimeve në krahasim me numrin e e miratimeve që sic shihet me raste është në raportin **165:79 raste** ose përafërsisht numri i refuzimeve në përqindje është rreth **62,2%** në krahasim me miratimet që janë vetëm **27,8%** nga numri i përgjithshëm i aplikimeve. Po t'i krahasojmë me raportin refuzim/miratime të vitit 2017 që ka qenë **20.2%** refuzime dhe **79,8%** miratime shohim se **për periudhën 9 mujore të auditimit për vitin 2018 ka një rritje të Refuzimeve në masën 42%.**

*Përmbledhëse sipas aktivitetit - miratime - refuzime - numer leje DRM Durrës* **viti 2018**
*Tabela nr.25*

| Nr | Aktiviteti | Viti 2018 | |
|---|---|---|---|
| | | Miratim | Refuzim |
| 1 | Karburant+ gaz | 17 | 21 |
| 2 | Materiale ndërtimi | Nuk jane me objekt i paisjese me leje mejdisi tipi c | |

| | | | |
|---|---|---|---|
| 3 | Prerja, gdhendja dhe lustrimi i gurit | 9 | 13 |
| 4 | Magazinim skrapi | 1 | 3 |
| 5 | Baxho Përpunim qumështi | 0 | 3 |
| 6 | Furra të prodhimit të bukës | 7 | 8 |
| 7 | Riparim e paisje motorrike | 15 | 18 |
| 8 | Labarator mjekësore | 1 | 1 |
| 9 | Prodhim mobilje | 5 | 7 |
| 10 | Servis dhe gomisteri | 3 | 7 |
| 11 | Lavazh | 3 | 3 |
| 12 | Prodhimi i mobiljeve | 3 | 5 |

*Burimi: DRM Durrës*

Me poshtë po paraqesim disa subjekte të C.t janë pajisur me Leje Tipit C per vitin 2018 sipas **ID 1.10/11,** Furnizimi me karburant i makinave në një stacion të furnizimit me karburant dhe furnizimi me GLN të C.t janë pajisur gabimisht me Leje Tipi C duke vepruar në kundërshtim me VKM nr. 419, datë 25.06.2014 "Për miratimin e kërkesave të posacme për shqyrtimin e kërkesave për Leje Mjedisi tipi A,B dhe C, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullat e hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKL-ja"; Ligjit 10448, datë 14.7.2011, "Për lejet e mjedisit" të ndryshuar dhe VKM numër 419 datë 23.06.2014. Bie në sy se edhe pranimet edhe refuzimet kanë pasur në përgjithësi të njëjtat mangësi ligjore.

U auditua dosja e Refuzuar **M.**. Në formularin e kërkesës për Leje Mjedisi Tipi C, nuk është përcaktuar kapaciteti magazinues për Kodin 7.7/o. "Magazinimi frigoriferik i produkteve ushqimore të ambalazhuara".Në dosjen e aplikimit të subjektit mungon foto ilustruese e daljes së oxhakut të shkarkimeve në ajër.Nuk specifikohet saktë mënyra e asgjësimit të mbetjeve të ngurtaC.t gjenerohen gjatë operimit.Tabela e zhurmave e pa plotësuar, referuar Udhëzimit Nr.8 datë 27.11.2007 "Për nivelet kufi të zhurmave në mjedise të caktuara". Subjekti të deklarojë nivelin e zhurmave të shprehur në Decibel (Db).Tabela e shkarkimeve në ajër e plotësuar gabim, referuar natyrës së aktivitetit të ushtruar nga subjekti.

Dosja e refuzuar **O.F.**. Në formularin e kërkesës për Leje Mjedisi Tipi C, Tabela 1.2, pika 3, nuk është plotësuar sipas Sistemit Koordinativ GAUS KRUGE. Në formularin e kërkesës për Leje Mjedisi Tipi C, nuk specifikohet saktë mënyra e asgjësimit të mbetjeve të ngurta të C.t gjenerohen gjatë operimit.Në formularin e kërkesës për Leje Mjedisi Tipi C, tabela e zhurmave e pa plotësuar, referuar Udhëzimit Nr.8 datë 27.11.2007 "Për nivelet kufi të zhurmave në mjedise të caktuara". Subjekti të deklarojë nivelin e zhurmave të shprehur në Decibel (dB). Në dosjen e aplikimit të subjektit mungon foto ilustruese e daljes së oxhakut të shkarkimeve në ajër. Në këtë rast është vepruar në kundërshtim me VKM nr. 419, datë 25.06.2014 "Për miratimin e kërkesave të posacme për shqyrtimin e kërkesave për Leje Mjedisi tipi A,B dhe C, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullat e hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKL-ja"; Ligjit 10448, datë 14.7.2011, "Për lejet e mjedisit" te ndryshuar.

Dosja e refuzuar **A.M.**. Tabela 1.5 pronësia e impiantit është plotësuar gabim. Ne formularin e kerkesese per Leje Mjedisi tipi C subjekti te ilustroj me foto sistemin e aspirimit dhe ambjentet e brendshme te aspirimit. Në këtë rast është vepruar në kundërshtim me VKM nr. 419, datë 25.06.2014 "Për miratimin e kërkesave të posacme për shqyrtimin e kërkesave për Leje Mjedisi tipi A,B dhe C, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullat e hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet

kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKL-ja"; Ligjit 10448, datë 14.7.2011, "Për lejet e mjedisit" te ndryshuar.
Dosja e refuzuar **L.B..** Ka mospërputhje midis përshkrimit të aktivitetit dhe ekstratit te QKB-së.Tabela 1.1 kodi kryesor i aktivitetit duhet të plotësohet sipas kolonës 1 të Shtojcës 1 të Ligjit 10448, datë 14.07.2011 "Për lejet e mjedisit"
Në formularin e kërkeses per Leje Mjedisi Tipi C, Tabela 1.2 informacioni mbi instalimin/impiantin nuk është plotësuar sipas Sistemit Kordinativ GAUS KRUGË. Tabela 1.2 "Emri i instalimit/impiantit" është plotësuar gabim. Në dosjen e aplikimit, deklarata nuk është e saktë, mungon firma dhe vula e administratorit të subjektit.Pika 1.6 është plotësuar gabim. Në këtë rast është vepruar në kundërshtim me VKM nr. 419, datë 25.06.2014 "Për miratimin e kërkesave të posacme për shqyrtimin e kërkesave për Leje Mjedisi tipi A,B dhe C, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullat e hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKL-ja"; Ligjit 10448, datë 14.7.2011, "Për lejet e mjedisit" te ndryshuar.
Dosja e refuzuar **E.R..** Ka mospërputhje midis ekstratit të QKB-së dhe përshkrimit të aktivitetit.Subjekti të pasqyroje të gjithë fushën e veprimtarisë së aktivitetit në ekstrakt. Tabela 1.1 kodi kryesor i aktivitetit duhet të plotësohet sipas kolonës 1 të Shtojcës 1 të Ligjit 10448, datë 14.07.2011 "Për lejet e mjedisit". Tabela 1.2 emri i Instalimit /impiantit plotësuar gabim. Deklarata në dosjen e aplikimit të nënshkruhet nga vetë administratori i subjektit. Tek tabela e mbetjeve të ngurta (mënyra e asgjësimit të nbetjeve) është plotësuar gabim. Në këtë rast është vepruar në kundërshtim me VKM nr. 419, datë 25.06.2014 "Për miratimin e kërkesave të posacme për shqyrtimin e kërkesave për Leje Mjedisi tipi A,B dhe C, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullat e hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKL-ja"; Ligjit 10448, datë 14.7.2011, "Për lejet e mjedisit" te ndryshuar.
Në mënyrë të përmbledhur këto pasqyrohen në tabelën –c- të pjesës Anekse (V):
Në subjektet e mëposhtme që janë pajisur me Leje Tipi C sipas **ID 10.5** "Riparimi i paisjeve motorike dhe motocikletave"**,** ka disa lloj mangësish në dokumentacion.
**Gjetje nga auditimi 18:** Për subjektin **H.P.** (7411-02-2018) gjatë auditimit u konstatua se në këtë dosje aplikimi nuk është i plotë përshkrimi i instalimeve të domosdoshme për ushtrimin e aktivitetit, në kundërshtim me VKM nr. 419, datë 25.06.2014 "Për miratimin e kërkesave të posacme për shqyrtimin e kërkesave për Leje Mjedisi tipi A,B dhe C, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullat e hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKL-ja"; Ligjit 10448, datë 14.7.2011, "Për lejet e mjedisit" te ndryshuar.
**Gjetje nga auditimi 19:** Për subjektin **N.S.** (**LC-7660-03-2018 - 20.03.2018**) gjatë auditimit u konstatua se në dosjen e aplikimit të subjektit nuk janë bashkëlidhur planet, skicat, hartat, për të përshkruar te gjithë aspektin e aktivitetit, në kundërshtim me VKM nr. 419, datë 25.06.2014 "Për miratimin e kërkesave të posacme për shqyrtimin e kërkesave për Leje Mjedisi tipi A,B dhe C, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullat e hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKL-ja"; Ligjit 10448, datë 14.7.2011, "Për lejet e mjedisit" te ndryshuar.
**Gjetje nga auditimi 20:** Për subjektin **E.** (**LC-0158-07-2018**) gjatë auditimit u konstatua se në këtë dosje aplikimi informacioni i deklaruar në tabelat e formularit të aplikimit kërkesë për Leje Tipit C nuk është i plotë, në kundërshtim me VKM nr. 419, datë 25.06.2014 "Për miratimin e kërkesave të posacme për shqyrtimin e kërkesave për Leje Mjedisi tipi A,B dhe C,

për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullat e hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKL-ja"; Ligjit 10448, datë 14.7.2011, "Për lejet e mjedisit" te ndryshuar.
**Gjetje nga auditimi 21:** Për subjektin **M.T. Sh.a** (**LC-0863-07-2018**) gjatë auditimit u konstatua se në këtë dosje aplikimi në informacionin e deklaruar në tabelat e formularit të aplikimit kërkesë për Leje Tipit C nuk deklarohet sasia dhe burimi i mbetjeve, në kundërshtim me VKM nr. 419, datë 25.06.2014 "Për miratimin e kërkesave të posacme për shqyrtimin e kërkesave për Leje Mjedisi tipi A,B dhe C, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullat e hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKL-ja"; Ligjit 10448, datë 14.7.2011, "Për lejet e mjedisit" te ndryshuar.
**Gjetje nga auditimi 22:** Për subjektin **F.M.** (**LC-1543-08-2018**) gjatë auditimit u konstatua se në këtë dosje aplikimi nuk përcaktohet përdorimi/prodhimi i energjisë dhe programi i përmirësimit të operimit, në kundërshtim me VKM nr. 419, datë 25.06.2014 "Për miratimin e kërkesave të posacme për shqyrtimin e kërkesave për Leje Mjedisi tipi A,B dhe C, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullat e hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKL-ja"; Ligjit 10448, datë 14.7.2011, "Për lejet e mjedisit" te ndryshuar.
**Gjetje nga auditimi 23:** Për subjektin **N.E. SHPK** (**LC-1543-08-2018**), gjatë auditimit u konstatua se në këtë dosje aplikimi nuk janë bashkëlidhur planet, skicat, hartat, për të përshkruar të gjithë aspektin e aktivitetit, në kundërshtim me VKM nr. 419, datë 25.06.2014 "Për miratimin e kërkesave të posacme për shqyrtimin e kërkesave për Leje Mjedisi tipi A,B dhe C, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullat e hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKL-ja"; Ligjit 10448, datë 14.7.2011, "Për lejet e mjedisit" të ndryshuar.
**Gjetje nga auditimi 24:** Për subjektin **J.H.** (**LC-1866-09-2018**), gjatë auditimit u konstatua se në këtë dosje aplikimi informacioni i deklaruar në tabelat e formularit të aplikimit kërkesë për Leje Tipit C nuk është i plotë dhe mungon kontrata e grumbullimit të vajrave të përdorura, kjo bazuar në kriteret për aktivitetin "servis i mjeteve.", në kundërshtim me VKM nr. 419, datë 25.06.2014 "Për miratimin e kërkesave të posacme për shqyrtimin e kërkesave për Leje Mjedisi tipi A,B dhe C, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullat e hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKL-ja"; Ligjit 10448, datë 14.7.2011, "Për lejet e mjedisit" të ndryshuar.
Këto gjetje paraqiten në mënyrë të përmbledhur në tabelën –d- të pjesës Anekse (V):
Nga auditimi me zgjedhje i dosjeve të aplikimit që janë shqyrtuar nga DRM Durrës për periudhën **01.10.2016-01.10.2018** konstatohet se: në dokumentacionin e subjekteve që iu është dhënë Akt Miratimi për Leje Tipi C rezultojnë mangësi si: adresimi i shqyrtimit të lejes specialistëve të DRM, mbajtja e procesverbaleve të komisionit të shqyrtimit nuk është e saktë, mungon përshkrimi i instalimeve të domosdoshëm për ushtrimin e aktivitetit i cili nuk është i plotë, nuk janë bashkëngjitur planet, skicat, hartat për ta përshkruar të gjithë aspektin e aktivitetit; nuk ka deklarim nga subjektet se si veprojnë me mbetjet e ngurta (llumrat e depozitave) që gjenerohen gjatë zhvillimit të veprimtarisë; mungon informacioni në tabelat për shkarkimet e ujërave të ndotura, mbi mbjetjet e ngurta, përdorimi dhe prodhimi i energjisë, zhurmat dhe vibracionet sipas (tipit sasisë dhe burimit); mungon plotësimi në mënyrë korrekte i kodit kryesor të aktivitetit; ka veprime të C.t janë në kundërshtim me ligjin nr. 10448, datë

14.7.2011 "Për lejet e mjedisit", i ndryshuar, Vendimin nr.419, datë 25.6.2014 "Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për Leje mjedisi të tipave A, B dhe C, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKL-ja'.

**Konkluzion: 1.** Në periudhën e audituar, në mbledhjet e komisionit dosjet nuk janë studiuar mirë nga specialistët për një analizë dhe diskutim cilësor e të përgatitur në mënyrë të mirëfilltë për vendimmarrjen. Mbledhjet e komisionit janë të regjsitruara në regjistër dhe të protokolluara **2.** Nga auditimi konstatohet se shpesh herë aktet e miratimit të Lejeve të Tipit C janë hartuar formalë. Kështu, në kushtin "5" të aktit të miratimit lidhur me shkarkimet në "Ajër" dhe në "Ujë", nuk ka të dhëna të detajuara dhe të hollësishme për shkarkimet në mjedis, sipas: shtojcës "2", bashkëlidhur ligjit nr. 10448, datë 14.07.2011 "Për lejet e mjedisit", "Lista indikative e substancave kryesore ndotëse që duhen marrë parasysh nqs kanë rëndësi për caktimin e vlerave kufi të shkarkimeve", si pjesë e kushteve për dhënien e lejes së mjedisit tipi "C", e përcaktuar si kërkesë bazuar në VKM nr. 419, datë 25.06.2014 "Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave "A", "B" dhe "C", për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKL-ja"; Kreut IV "Procedurat për shqyrtimin e kërkesave dhe përcaktimi i kushteve për leje mjedisi të tipit "C", pika 10, ku akti i miratimit për lejen e mjedisit të tipit "C", për çdo instalim, përmban sipas rastit: a) "Vlerat kufi të shkarkimit të ndotësve, në mënyrë të veçantë ato të listuar në shtojcën "2" të ligjit nr. 10448, datë 14.7.2011, "Për lejet e mjedisit", që parashikohen të shkarkohen në sasi të konsiderueshme nga instalimi. Vlerat kufi të shkarkimeve, sipas rastit, mund të zbatohen për grupe ndotësish dhe jo për ndotës të veçantë". **3.** Lidhur me subjektet të C.t gjenerojnë mbetje, ARM Durrës duhej të specifikonte se në këtë sasi mbetjesh të zakonshme sa prej tyre janë të rrezikshme dhe çfarë bëjnë këto subjekte/aplikantë, lidhur me trajtimin apo asgjësimin e tyre. Kurse DRM Durrës thjesht ka evidentuar sasinë ton/mbetje për muaj. Gjithashtu nuk është vlerësuarC. është taksa për ndotje, më saktë për hedhje si për sasi (kg), por më tepër për llojin apo shkallën e rrezikshmërisë së mbetjeve. Në shtumicën e rasteve nga DRM-ja përcaktohet se subjektet plotësojnë standardet për sa i përket shkarkimeve në ajër dhe ujë, duke ju referuar normave të shkarkimeve të vendosura në lejet përkatëse mjedisore dhe monitorimeve të vetë subjekteve të kryera nga laboratorë të akredituar. Ndërkohë që për shkarkimet e ngurta nuk aplikohen normat e përcaktuara në Lejet mjedisore të lëshuara deri tani. **4.** Nga auditimi lidhur me gjenerimin e zhurmave në mjedis për aktivitetet e tjera, në zona të banuara, sipas Udhëzimit të Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave nr. 5, datë 26.11.2010 "Për kriteret dhe procedurat për pajisjen me leje të thjeshtë", shtojca I, nga auditimi konstatohet se përveç rastit të lokaleve të natës me veprimtari të specializuara të argëtimit që gjenden në zonat e banuara, në asnjë rast tjetër nuk është proceduar nga ana e ISHMPUT me hartimin e raporteve për nivelet e pritshme të zhurmës që do të çlirohen në mjedis nga veprimtaritë e tilla si: **a**. Furra të prodhimit të bukës; **b.** Serviset e automjeteve, gomisteritë, dhe pikat e larjes së automjeteve; **c.** Punishtet/veprimtaritë e saldimit të metaleve; **d.** Veprimtaritë e prodhimit/përpunimit të duraluminit; **e.**Veprimtaritë e përpunimit të mermerit dhe gurëve dekorativë; **f.** Veprimtaritë e prodhimit të mobiljeve; **g.** Veprimtaritë që për shkak të natyrës së tyre përdorin vazhdimisht gjener/Venti; **h.** Nyjat e fraksionimit të mineraleve; **m.** Prodhimi i betonit, llaçit,kollës, gëlqeres (parafabrikateve, blloqeve, etj.); **n.** Punishtet e pijeve alkoolike, produkteve shtazore dhe bimore. **5.** Nga auditimi i materjaleve të DRM Durrës u konstatua se në dokumentacionin e

subjekteve që iu është dhënë Akt Miratimi për Leje Tipi C, rezultojnë të njëjtat mangësi me ato që janë refuzuar, cka na bën të arrijmë në përfundimin se në vendimet e marra në lidhje me shqyrtimin e dosjeve janë përdorur standarde të dyfishta për plotësimin e dokumentacioneve, veprime këto në kundërshtim me kërkesat ligjore referuar Vendimit nr. 419, datë 25.6.2014 'Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave A, B Dhe C, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKL-ja'. **6.** Plotësimi i dokumentacionit të Akt Miratimeve në dhënien e Leje Mjedisore Tipi C, kushti 3.1: ***"Të bëhet dezinfektimi"***, është kompetencë e Inspektoratit Higjeno-Sanitar dhe jo e DRM, sipas *shtojca 6, pika 9, Kreu IV formulari aktmiratimit pika 10, germa a, b, c, dh, VKM nr. 419, datë 25.6.2014*. Kushti 4 (4.1.4) përcakton ***afat si datë*** pas 6 muajsh për dorëzimin e raportit dhe treguesve të vetmonitorimit por në shumë raste subjektet nuk i kanë sjellë ato. **7.** Ne rastet e miratimit të lejeve për "furnizim me karburant" sipas referimit te VKM nr. 419 shtojca 3 pika 1,6 *mungon dokumenti i planifikimit të zonës, mungon licensa nga PMNZH si dhe vertertimi teknik, referuar sipas ligjit per Emergjencat Civile. Mungon kontrata me subjektet e licensuara për asgjesimin e mbetjeve të rrezikshme, sipas Ligjit për Menaxhimin e Integruara të mbetjeve.*

*Për të gjitha shkeljet e konstatuara mbajnë përgjegjësi për periudha të ndryshme kohore specialistët e lejeve mjedisore E.V., S.V., K.P., E.Sh., A.B., L. D., B.C., E.Z., M.S., S.M., R.L. si edhe drejtuesit në periudhat përkatëse kohore të periudhës së auditimit, K.K., B.Gj. dhe B. H..*

***Mënyra e ruajtjes së dokumentacionit elektronik (arshiva elektronike), si dhe masat e marra për ruajtjen e tyre.***

Ndër mangësitë e konstatuara gjatë auditimit rezultoi se DRM Durrës nuk disponon kushtet e nevojshme të caktuara për ruajtjen fizike e teknologjike të dokumenteve.

-Formularët informues për leje mjedisi të tipit C janë konform formatit standard,

- Nuk janë zbatuar kërkesat e kreut të IV-të VKM nr. 419, datë 25.06.2014 pika 2 dhe 3, ku citohet se brenda 3 ditëve punë nga data e marrjes së aplikimit, DRM dërgon një kopje të aplikimit në NJQV, eC. jep mendimin e saj me shkrim brenda 3 (tre) ditëve pune.

-Nga NjQV-të në shumë raste nuk është dërguar mendim brenda 3 ditëve pune në lidhje me miratimet apo refuzimet e lejeve të tipit C.

-Për praktikat e aplikimit për leje të tipit C, për subjektet me veprimtari që kanë patur shkarkime në tokë, ajër dhe ujë, në përgjithësi nuk janë bërë matje të burimit dhe sasisë referuar llojit të aktivitetit dhe ndikimit në mjedis nga subjekte të licencuara të akredituara apo shtetërore.

- Nga mangësia e bashkëpunimit midis strukturave, sidomos me ISHMP, konstatohet se për mos paisjen me leje mjedisore është krijuar një mungesë të ardhurash në buxhetin e shtetit nga arkëtimet e tarifave për lejet e miratuara.

***8.c.Mbi zbatimin e procedurave ligjore në plotësimin e dokumentacionit të Akt Refuzimeve dhe argumentimi ligjor i Akt Refuzimeve për Leje Mjedisi Tipi C, për periudhën 01.10.2016 deri 01.10.2018 të trajtuar si më poshtë sipas viteve .***

**Viti 2015**

Për tre muajt e fundit **Tetor-Dhjetor 2016** DRM Durrës nga **68** aplikime të kryera ka refuzuar **23** aplikime për leje mjedisore tipi C; për vitin **2017** DRM Durrës nga **193** aplikime të kryera ka refuzuar **39** aplikime për leje mjedisore tipi C; për nëntmujorin e parë **Janar-Shtator të vitit 2018** DRM Durrës nga **265** aplikime të kryera ka refuzuar **165** leje mjedisore tipi C.

Refuzimet e lejeve mjedisore tipi C janë kryer për mangësi në plotësimin e dokumentacionit ku mungojnë aktverifikimet e relacionet perkatëse, ka parregullsi dhe mungesa argumentimi

ligjor si mos citimi i bazës nënligjore e kërkesës së shtojcave, mosevidentim e ndjekje të procedures që kanë sjellë vonesa, ka patur ripërsëritje të kërkesave dhe ushtrim aktiviteti pa licencë, formulime me përcaktime të dokumentacionit, në kundërshtim me VKM nr. 419, datë 25.06.2014 "Për Miratimin e Kërkesave të Posaçme për Shqyrtimin e Kërkesave për Leje Mjedisi të Tipave A,B dhe C, për Transferimin e Lejeve nga një Subjekt tek tjetri, të Kushteve për Lejet Respektive të Mjedisit si dhe Rregullave të Hollësishme për Shqyrtimin e tyre nga Autoritetet Kompetente deri në Lëshimin e Këtyre Lejeve nga QKL".

**Konkluzion:** DRM nuk kishte formatin standard të Akt Refuzimit ku të përfshihej saktësisht numri dhe data e aktit, të përfshihej, përcaktohej e cilësohej data e refuzimit të mëparshëm si dhe data e riaplikimit, me synim bërjen më transparente të shërbimit, respektimin e afateve, mospengimin dhe nxitjen e biznesit në pajisjen me lejet mjedisore Tipi C etj. në zbatim të VKM nr. 419, datë 25.06.2014 "Për Lejet e Mjedisit Kreu IV, pika 9, formati standard i aktit Miratim /refuzimit shtojca nr.6 " të rishikohet formulari tip "Akt-refuzimit" ku të përshkruhen rastet e riaplikimit duke përcaktuar datat dhe sasinë e refuzimeve (për herë të dytë data,trete data) duke përshkruar shkurtimisht numrin e kushteve të paplotësuara), masë që do të rrisnin transparencën e DRM, nxinin biznesin dhe mbi të gjitha rrisnin shkallën e menaxhimit duke përcaktuar ngarkesën ndërmjet specialisteve sipas praktikave ndarë praktikë fillestare, praktikë ne vazhdim për së dyti, për së treti etj, pasi volumi i punës sipas praktikave është i diferencuar ndërmjet atyre në proces (të refuzuara) dhe atyre fillestare për herë të parë.

***8.d – Mbi zbatimin e procedurave të vlerësimit të ndikimit në mjedis, të dhënieve të Mendimeve për VNM dhe dhenieve të mendimeve për Leje Mjedisore nga DRM Durrës, për miratimet e lejeve të Tipit A,B nga AKM Tiranë.***

Në zbatim të pikës "8 b" të programit të auditimit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1) Lejet mjedisore të Tipit A/B
2) Dokumentacioni shkresor dhe elektronik i disponueshëm në institucion në zbatim të ligjit dhe udhzimeve për mjedisin.

*Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:*

Nga ana e DRM Durrës u konstatuan të meta e mangësi në përcaktimet ligjore të bëra përsa i përket zbatimit të procedurave të ndikimit në mjedis dhe paisjen e subjekteve me leje mjedisore.

| |
|---|
| *Baza ligjore;*<br>*-Ligji nr.10448, datë 14.07.2011 "Për lejet e mjedisit" i ndryshuar me ligjin nr.60/2014, datë 19.06.2014 "Për lejet në mjedis".*<br>*-Ligji nr.10431, datë 09.06.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit" i ndryshuar.*<br>*- Ligji nr.10266, datë 15.04.2010 "Për mbrotjen e ajrit nga ndotja".*<br>*-Ligji nr.19463, datë 22.09.2011 "Për manaxhimin e integruar të mbetjeve".*<br>*-Ligji nr.10081, datë 23.02.2009 "Për liciensat, autorizimet dhe lejet".*<br>*-VKM nr. 47, datë 29.01.2014 "Për Përcaktimin e Rregullave për Organizimin dhe Funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit e të Agjencive Rajonale të Mjedisit" dhe "Rregullore për organizimin dhe veprimtarinë e AKM dhe të ARM-ve/ DRM-ve" e miratuar datë 20.10.2014 nga Ministri i Mjedisit.*<br>*-VKM nr. 419, datë 25.06.2014 "Për Miratimin e Kërkesave të Posaçme për Shqyrtimin e Kërkesave për Leje Mjedisi të Tipave A,B dhe C, për Transferimin e Lejeve nga një Subjekt tek tjetri, të Kushteve për Lejet Respektive të Mjedisit si dhe Rregullave të Hollësishme për Shqyrtimin e tyre nga Autoritetet Kompetente deri në Lëshimin e Këtyre Lejeve nga QKL", Kreu IV, pika 3 dhe pikat 2, 4 dhe 5, ku përcaktohen afatet e procedurës së vendim-marrje.*<br>*-VKM nr. 686, datë 29.05.2015"Për rehabilitimin e shtretërve dhe brigjeve të lumejve, të dëmtuara nga shfrytëzimi i inerteve".*<br>*-VKM nr. 1189, datë 18.11.2009 "Për rregullat dhe procedurat për hartimin dhe zbatimin e Programit Kombëtar të monitorimit të mjedisit".* |

| |
|---|
| *-VKM nr. 435 datë 12.09.2002 "Për miratimin e normave të shkarkimeve në ajër në Repuplikën e Shqipërsië".*<br>*-VKM nr.247, datë 30.04.2014 "Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e procedurave dhe përfshirjen e publikut në vendimarrjen mjedisore".*<br>*-VKM nr.10440, datë 07.07.2011 "Për vlersimin në mjedis".*<br>*-VKM nr.417, datë 23.02. 2009 "Për miratimnin e tarifave të lejeve të mjedisit".*<br>*-VKM nr.371, datë 11.06.2014 "Për mbetjet e rrezikshme".*<br>*-VKM nr.229, datë 23.04.2014 "Për miuratimin e rregullave për trasferimin e mbetjeve jo të rrezikëshme".* |

Për këtë pikë programi u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

**Auditimi i dokumentacionit dhe procedurave të Konsultimeve me publikun për VNM dhe mendime për Leje A dhe B viti 2016, 2017 deri me 31.07.2018.**

-Për vitin **2016,** vit për të cilin mungonte lista elektronike e të dhënave**,** janë shqyrtuar **159** dosje nga të C.t **69** janë aplikime për VNM paraprake/thelluar kurse **90** janë aplikime për Leje Mjedisi Tipi A/B. Por për periudhën e auditimit **Tetor, Nëntor dhe Dhjetor 2016** në DRM Durrës kanë ardhur për mendim **28** subjekte nga të C.t **18** aplikime per VNM paraprake dhe **10** aplikime për Leje **Tipit B** për të C.t është dhënë mendim pozitiv për **27** subjekte (aplikime) dhe vetëm **1** mendim negativ për LM Tip B.

Nga auditimi u konstatua se në DRM **nuk ruhej regjistri i VNM dhe mendim për Leje A/B** për periudhën tetor – dhjetor të vitit 2016, **madje nuk ruhej ky regjistër elektronik për gjithë vitin 2016**.

Për vitin **2017** janë shqyrtuar gjithësej **129** dosje nga të C.t **96** janë VNM Paraprake dhe **27** janë Leje Tipi B dhe **4** janë Leje Tipi A. Prej shqyrtimit për **124** ka dhënie mendimi pozitiv dhe për **5** ka dhënie mendimi negativ ku hyjnë 4 VNM dhe 1 leje Tip B. Krahasuar me vitin 2016 ku numri i dosjeve të aplikimit për vitin 2016 ka qenë **159**, për 2017 ka më pak aplikime të ardhura për VNM të Thelluar/Paraprake dhe Leje Mjedisi Tipi A/B. Për periudhën **1 Janar 2018- 1 Tetor 2018** janë shqyrtuar gjithësej **101** dosje nga të C.t **58** VNM paraprake dhe **41** Leje Tipit B e 2 Leje Tip A. Nga ky total aplikimesh **85** janë dhënie mendimi pozitiv dhe **16** dhënie mendimi negative nga të C.t janë refuzuar **13** VNM dhe 3 leje Tip B.

Nga auditimi konstatohet së për **258** rastet e përmendura më lart në total, dëgjesat nuk janë kryer për të gjitha rastet si konsultime me publikun, në varësi edhe të delegimit të kësaj kërkese që DRM Durrës ka marë nga AKM.

-Në raportet e dhënies së mendimit DRM Durrës shprehet së në fazën e shqyrtimit nuk është i nevojshëm konsultimi me publikun.

-Nuk konstatuam 'Raporte përmbledhëse' të konsultimeve të përgatitura e nënshkruara nga specialistët e DRM.

-Në të gjitha rastet duke mos kryer konsultime të plota me publikun, raportet nuk kanë patur mundësinë të evidentojnë shprehjet për shumë çështje të diskutuara a shqyrtuara nga publiku për mendimet, kundërshtimet apo plotësimet e kërkesave të tyre.

*Të dhënat për procedurat e konsultimit sipas praktikave të dhënieve të mendimeve për Leje Tip C + VNM për tre periudhat e auditimit paraqiten në tabelën e mëposhtme:*

*Tabela nr.26*

| *Mendime VNM dhe Leje Tip C* | | *Konsultimi* | |
|---|---|---|---|
| | *sasi* | *Me konsultim* | *Pa konsultim* |
| Tetor – dhjetor 2016 | 86 | 25 | 61 |
| Viti 2017 | 258 | 75 | 183 |
| Viti 2018 | 326 | 88 | 238 |

*Burimi: DRM Durrës*

Kjo procedurë e ndjekur nga DRM Durrës nuk është në përputhje me kërkesat e VKM nr. 419 datë 25.06.2014 "Për Miratimin e Kërkesave të Posaçme për Shqyrtimin e Kërkesave për Leje Mjedisi të Tipave A,B dhe C, për Transferimin e Lejeve nga një Subjekt tek tjetri, të Kushteve për Lejet Respektive të Mjedisit si dhe Rregullave të Hollësishme për Shqyrtimin e tyre nga Autoritetet Kompetente deri në Lëshimin e Këtyre Lejeve nga QKL*"* Kreu I **pika 1/dh eC. përcakton** se: *"Relacion rreth dëgjesës me publikun, sipas përcaktimit në pikën 13 të kreut V të këtij vendimi.*", **Kreu VI pika 12, 13, 15, 16** të C.t përcaktojnë së: **"Pika 12** *Procesverbali i dëgjesës mbahet nga kërkuesi dhe nënëshkruhet nga pjesmarrësit në dëgjesë. Kopje të procesverbalit u vihen në dispozicion publikut, palëve pjesmarrësë ne dëgjesë, NJQV –së dhe AKM-së".* **Pika 13**. *Kërkuesi, kur aplikon për leje mjedisi të tipi A dhe të tipit B, harton një relacion rreth dëgjesës me publikun dhe palët e interesuara dhe e dorëzon në QKL."* ***Pika 15****. "AKM-ja, gjatë hartimit të aktit të miratimit të lejes së mjedisit të tipit A dhe B, merr parasysh çdo koment, informacion, analizë apo mendim të paraqitur nga publiku që vlerësohet i vlefshëm dhe argumenton arsyet kur ato nuk janë marrë parasysh".* ***Pika 16****. "AKM-ja, kur e gjykon të arsyeshme, delegon DRM-në e qarkut përkatës për të marrë pjesë në dëgjesën me publikun."*

Gjithashtu, kjo proceudrë është në kundërshtim edhe me VKM nr.686 datë 29.07.2015 "Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore" pika11. "Shtojcat e raportit të thelluar të VNM-së" në të cilën ndër të tjera përcaktohet:- "*Informacion për mënyrën e realizimit të konsultimit gjatë procesit të hartimit të raportit të thelluar të VNM-së dhe metodat e konsultimit, rezultatet përkatëse, kontaktet e personave dhe subjekteve që kanë marrë pjesë në këtë proces, mendimet që janë dhënë dhe arsyetimet se si janë adresuar osë jo në raportin e thelluar të VNM-së, përfshirë edhe kërkesat e mendimet e dhëna në dëgjesën publike"*

DRM Durrës dhe AKM Tiranë, në të gjitha praktikat e dhënies së mendimit për VNM dhe për Leje Tip A e B, mbështeten në formate standarte dhënie mendimi për VNM dhe mendimi për Leje Mjedisore A/B të përcaktuar në një kërkesë nr. 228, datë 3.2.2016 të Drejtorisë së Vlerësimit Mjedisor eC. është e pa miratuar nga Titullari. Këto formate kanë mangësi në formë, përmbajtje dhe funksion, pasi në pjesën fillestare të tyre nuk janë përfshirë elementët si: " *...bazuar në kërkesën nr, datë, apo emaile datë, apo në autorizimin e AKM* ", ekzistenca e të C.ve do bënte të mundur evidentimin dhe zbatimin e afateve dhe procedurës së dhënies së mendimit për VNM, dhënies së mendimit për leje mjedisore tip A, B. refuzimin dhe kohën e përsëritjes së tyre duke reflektuar arsyet e refuzimit. Gjithashtu në këto formate mungojnë treguesit identifikues të pasurisë, juridiksioni i shtrirjes dhe konstatohet se nga **258** raste vetëm për Leje Tip C + 412 VNM gjithësej, janë me përgjigje të NJQV-ve përkatëse vetëm 189 raste gjithësej nga të tre bashkitë Durrës, Krujë e Shijak, veprime në mospërputhje me VKM nr. 419, datë 25.06.2014 "Për Miratimin e Kërkesave të Posaçme për Shqyrtimin e Kërkesave për Leje Mjedisi të Tipave A,B dhe C, për Transferimin e Lejeve nga një Subjekt tek tjetri, të Kushteve për Lejet Respektive të Mjedisit si dhe Rregullave të Hollësishme për Shqyrtimin e tyre nga Autoritetet Kompetente deri në Lëshimin e Këtyre Lejeve nga QKL", shtojcën 4 dhe 5.

Në të gjitha rastet e dhënies të mendimeve për VNM mungon vlerësimi i raport-studimit të VNM në lidhje me faktin nësë në këto studime e projekte janë përfshirë masa për rehabilitimin e mjedisit të dëmtuar nga zhvillimi i veprimtarisë, kërkesë kjo e nenit 50 pika1/b e ligjit nr.10431 datë 9.6.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit", kushtëzimi dhe bashkëpunimi me NJQ-ët përkatësë në kuadër të miratimit të "Planeve Vendore", për detyrimin e subjektit për realizimin

e rehabilitimit të sipërfaqeve shkurrore e pyjore që do të përdoret si rrugë deri në vepër, sipërfaqet e karrierave të guroreve, sipërfaqet e vend-depozitimeve të mbetjeve etj. Kjo është kërkesë edhe e VKM nr. 686 datë 29.07.2015 "Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore" Kreu I, Pika 1.2 "Raportin paraprak të VNM-së", ku përfshihen ndër të tjera edhe nënpika e) *për mundësinë e rehabilitimit të mjedisit të ndikuar dhe mundësinë e kthimit të mjedisit të ndikuar të sipërfaqes në gjendjen e mëparshme, si dhe kostot financiare të përafërta për rehabilitimin;*

***Disa praktika të dhënieve të mendimeve për VNM sipas llojeve të aktviteteve***

Për procedurat e licencimet e subjekteve të ndryshme DRM Durrës ka dhenë mendime për VNM gjithsëj për **258** subjekte të ndara për periudhën e auditimit si më poshtë: **174 VNM** (miratuar 157 refuzuar 17); **6 Leje Tip A** (6 miratime); **78** dhënie mendimi për **Leje Tip B** (nga të C.t janë miratuar **73** dhe janë refuzuar **5** të tilla. Për këto praktika mendimesh për VNM-të, nuk ka informacione se sa praktika janë miratuar dhe sa praktika janë refuazuar nga AKM Tiranë pasi mungon korrespondenca për këtë pikë mes tyre.

*Tabela nr.27*

| **Nr.** | **Emërtimi** | **Shtator-dhjetor 2016** | **Viti 2017** | **Janar-dhjetor 2018** |
|---|---|---|---|---|
| **1** | **LEJE TIP A** | **-----------------** | **4** | **2** |
| **2** | **LEJE TIP B** | **10** | **27** | **41** |
| **3** | **VNM paraprake/thelluar** | **18** | **96** | **58** |
| **4** | **TOTALI** | **28** | **127** | **101 (Totali 256)** |

*Burimi: DRM Durrës*

Nga auditimi i miratimit të VNM paraprake/thelluara dhe Lejeve Tip A dhe B, për periudhën e auditimit 1.10.2016 – 1.10.2018 në DRM Durrës u konstatua se: Referuar ligjit Nr. 10 440, datë 07.07.2011 "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis" të ndryshuar, Nenit 10 - 'Paraqitja e kërkesës për vlerësimin e ndikimit në mjedis nga zhvilluesi' u konstatua se në kundërshtim me këtë nen ka një shqyrtim tepër formal të këtyre dosjeve nga ana e DRM Durrës, pasi formatet e dhënies së mendimeve janë pothuajse njësoj për të gjitha aplikimet, duke ndërruar vetëm emrin e subjektit dhe administratorët.

Në aneksin e materjalit do paraqitim listat e plota për vitet 2017 dhe nëntmujorin e parë të vitit 2018 për VNM paraprake/thelluar dhe Leje Mjedisore A e B. ***Nga auditimi u konstatua se DRM Durrës nuk ka hartuar lista me të dhëna bazë në varjant elektronik ose shkresor për dhënie mendimi VNM dhe Leje Tip A, B për vitin 2016*** dhe për periudhën e auditimit të tremujorit të fundit të këtij viti, tetor, nëntor, dhjetor 2016.

*Nga tabela e mësipërme konstatohet së DRM Durrës për periudhën e audituar ka dhënë mëndime për VNM dhe Leje Mjedisore A e B, si më poshtë***:**

*Tabela nr.28*

| Viti | Mendime pozitive | Mendime negative |
|---|---|---|
| tetor – dhjetor 2016 | 27 | 1 |
| 2017 | 122 | 5 |
| Janar – shtator 2018 | 85 | 16 |

| | | |
|---|---|---|
| **Shuma** | **234** | **22** |

*Burimi: DRM Durrës*

Nga auditimi konstatohet së DRM Durrës nuk ka informacion të mëtejshëm mbi ecurinë e marrjes të lejeve të tipit B nga instucionet e tjera si AKM Tiranë dhe ISHMPUT Durrës.

Nga auditimi me të zgjedhur i dokumentacionit për dhënien e e VNM konstatohet se:

Nga DRM Durrës në shumë raste mendimi është dhënë pa kryer dëgjesa me publikun sidomos për Leje Tip A/B dhe VNM me ndikim mjedisor duke cilësuar se ky veprim do të kryhet hap pas hapi gjatë fazës së zbatimit të projektit, veprim i cili nga DRM Durrës argumentohet me arsyetimin se nuk ka pasur delegim nga ana e AKM për të zhvilluar më shumë dëgjesa, sidomos për ato raste dhënie mendimi që kanë impakt të lartë mjedisor.

Ka patur raste që mendimi për lejen mjedisore është dhënë pas fillimit të punimeve nga subjektet zbatuese. Ky veprim i bërë fakt nga subjektet humbet çdo rol e përgjegjësi që ka DRM për pajisjen me leje mjedisore dhe është shkelje flagrante në zbatimin e ligjeve dhe rregullores së brendshme.

DRM Durrës nuk ka dhënë mendime për sipërfaqet e zëna si “Vend-depozitime për inerte (Landfille)” për të C.t kërkohet dhënie mendim për VNM.

Nga shyrtimi i VNM$^{-ve}$ të paraqitura , DRM Durrës nuk ka argumentuar detyrimin për ripyllëzim të sipërfaqeve të fondit pyjor. Në dhëniet e mendimeve nuk argumentohet me llogaritje të sipërfaqes së zëne dhe të ndarë sipas zërave kadastral pyje, pyje shkurre, kullota, konvertuar në raportet me pikën 1,2,5 të Urdhrit të Ministrit nr. 1937, datë 21.10.2014 “Mbi përcaktimin e detyrimit të subjekteve për të zëvendësuar sipërfaqet pyjore dhe përmirësuar sipërfaqet kullosore që hiqen nga fondi pyjor dhe kullosor nëpërmjet pyllëzimit, ripyllëzimit dhe përmirësimit të tyre.

Në bazë të Urdhrit të Ministrit të Mjedisit, nr. 1964, datë 13.11.2014 “Për miratimin e procedurave të administrimit dhe formatit të regjistrave të lejeve të mjedisit të tipit A, B dhe C”, DRM Durrës duhet të marrë informacion nga AKM Tiranë dhe të përditësojë në formë elektronike regjistrin e lejeve të tipit A,B sipas formatit standard shtojcës 1,2, 4.

Për pikën 8 të programit të auditimit u mbajt **Akt Konstatimi nr.3**, dt. 18.01.2019.

***Komente nga subjekti i audituar***: *Nga Znj.B. H., në cilësinë e drejtorit të komanduar të DRM Durrës në mënyrë të detajuar ka bërë kundërshtime nëpërmjet observimit me numër 598/2 , datë 23.10.2018, protokolluar në KLSH nr.1012/1, datë 23.04.2019, edhe për sa është trajtuar në Aktkonstimin numër 3 datë 118.01.2019, që i përket procedurave për praktikën e ndjekur në miratimin e lejes tipi (C), procedurave ligjore për komunikimin me organet e NJQV, zbatimin e procedurave për plotësimin e dokumentacionit të aktmiratimit për dhënien e Lejes tipi (C), dokumentacionit për konsultimin me publikun për Lejet mjedisore dhe VNM, ndjekjen e procedurave për dorëzimin e raporteve të vetmonitorimit nga subjekti për Lejen e tipit (C), komunikimin me NJQV, mbi dhënien e pëlqimeve mjedisore për Leje tip A/B dhe VNM paraprake/thelluara, me ISHMPUT-në rajonale, duke i kundërshtuar në përgjithësi këto pika me shpjegimet se DRM ka respektuar me korrektësi maksimale për cdo cështje të shqyrtuar e të konstatuar nga grupi i auditimit, të gjitha procedurat e duhura ligjore.*

***Qëndrim i grupit të auditimit***: *Grupi auditimit i shqyrtoi me kujdes shpjegimet e dhëna para dhe pas hartimit të Projekt Raportit të KLSH nëpërmjet observacioneve të dërguara nga ana e DRM se fundmi me numër 598/2 prot datë 23.04.2019 dhe të protokolluar në KLSH me numër 1275/3 datë 23.4.2019 të dërguara edhe elektronikisht, disa prej të C.ve grupi i auditimit i pati parasysh gjatë hartimit të këtij Raporti përfundimtar. Nëpërmjet tyre DRM duket se ka shqyrtuar me kujdes të gjitha mangësitë e konstatuara dhe të trajtuara në Projekt Raportin e realizuar nga ana e grupit të auditimit të KLSH, konkretisht në Aktkonstatimin numër 3 që trajton pikën 8 të programit, të C.t DRM do t’i ketë parasysh gjatë periudhës së mëvonshme në funksion të përmirësimit të punës. Në disa raste duhet të theksojmë se obserbacionet e DRM Durrës janë jashtë kontekstit të trajtimeve të bëra në Projekt Raport në lidhje me pikën 8 të Programit të Auditimit të KLSH.*

*Përsa ju përket akt Miratimeve/Refuzimeve të Lejeve Tip C nga DRM Durrës, (për Refuzimet bie në sy sidomos rritja e lartë me rreth* ***45%*** *e numrit të tyre gjatë 9 mujorit të parë të vitit 2018 krahasuar me vitin 2017), nuk janë ndjekur për cdo rast të njëjtat rrugë ligjore pasi edhe Miratimet edhe Refuzimet, në shumë raste, sic u vërtetua nga auditimi me zgjedhje, janë kryer mbi të njëjtat mangësi në raport me kriterete e vendosura ligjore duke përdorur një standart të dyfishtë subjektiv nga ana e komisjoneve të shqyrtimit për pajisje me Leje tip C dhe duke mos zbatuar në të gjitha rastet e përmendura në Akt Konstatimin numër 3 të grupit të auditimt* ***Ligjin 10448 datë 14.07.2011*** *"Për Lejet e Mjedisit" i ndryshuar dhe* ***VKM numër 419 datë 25.06.2014*** *dhe aktet e tjera nënligjore lidhur me të gjitha cështjet e trajtuara në këtë pikë të Programit të Auditimit.*

**Pika 9 e programit të auditimit:** ***Mbi auditimin e zbatimit të procedurave te vetëmonitorimit dhe monitorimit të mjedisit nga ndotja dhe dëmtimi.***

*Dokumentacioni i vënë në dispozicion nga subjekti i audituar është si më poshtë:*

1- Regjistri elektronik i vlerësimit të relacioneve të vetmonitorimit;
2- Regjistri i Raporteve hyrëse të vetmonitorimit;
3- Regjistri i shkarkimeve dhe transferimit të ndotësve të mjedisit ;
4- Regjistri i Revokimeve.
5- Libri i regjistrit për prodhuesit dhe importuesit e vajërave lubrifikantë.
6 -Libër i regjistrit për gjeneruesit e vajërave lubrifikantë.
7 -Libri i regjistrit për menaxhuesit e licensuar të grumbullimit dhe riciklimit të vajërave lubrifikantë.

DRM Durrës është institucion i krijuar në zbatim të VKM nr. 47, datë 29.01.2014 "Për përcaktimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit e të Agjencive në vazhdim (DRM), si dhe (drejtorive) rajonale të mjedisit" nuk ka për detyrë / kompetencë të vendosë/ aplikojë sanksione ndaj subjekteve, pasi kjo është detyrë e DRISHMPU-ve.

Referuar ligjit Nr. 10431, datë 09.06.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit", ligjit nr. 10440, datë 07.07.2011 "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis", ligjit nr. 10448, datë 14.7.2011 "Për lejet e mjedisit", VKM nr.1189, datë 18.11.2009 "Për rregullat dhe proçedurat për hartimin dhe zbatimin e programit kombëtar të monitorimit të mjedisit" si dhe kushtit të vënë në lejet e marra nga subjektet për raportim periodik, subjektet janë të detyruar të monitorojnë shkarkimet e veprimtarive në përputhje me kushtet e lejeve mjedisore, të bëjnë vetëmonitorimet dhe të sjellin raportet e vetëmonitorimit pranë DRM-së.

Në zbatim të kushteve ligjore të vendosura, në çdo leje mjedisore të subjekteve operuese secili prej tyre ka si detyrim ligjor raportimin e zbatimit të pikave të vendosura në lejet përkatëse përmes Relacioneve të Vetëmonitorimit, të C.t janë periodike në çdo 6-muaj. Operatorët e veprimtarive të përfshira në kategoritë A,B dhe C, referuar nenit 44 të Ligjit Nr.10431 datë 09.06.2011 "Për Mbrojtjen e Mjedisit", kryejnë monitorimin e shkarkimeve të veprimtarive të tyre, në përputhje me dispozitat e legjislacionit për Lejet e Mjedisit dhe kushtet e përcaktuara në lejen përkatëse të mjedisit.

Nga auditimi i kryer për dhënien dhe miratimin e lejeve mjedisore për vetëmonitorim të subjekteve, nga informacioni i vënë në dispozicion rezulton se:

Një pjesë e subjekteve që aktivitetet e tyre janë me ndikim në mjedis nuk kanë respektuar detyrimin ligjor që buron nga kushtet e Lejeve Mjedisore, pasi nuk kanë dorëzuar raportet e vetëmonitorimit.

a) Janë gjithësej **209 subjekte** që kanë dorëzuar raporte vetmonitorimi ne DRM Qarku Durres nga **data 01.10.2016-31.12.2016**, nga subjekte qe jane pajisur me Leje Mjedisi Tipi C;

b) Janë gjithësej 797 raporte vetmonitorimi që janë dorëzuar në DRM Qarku Durrës per vitin 2017, nga subjekte që jane pajisur me Leje Mjedisi Tipi C;
c) Janë gjithësej 682 raporte vetmonitorimi që janë dorëzuar në DRM Qarku Durrës për vitin 2018, nga subjekte që janë pajisur me Leje Mjedisi Tipi C.
Të dhënat e vetëmonitorimeve të pjesshme për një pjesë të subjekteve janë hedhur në rregjistrat e shkarkimeve për vitet përkatëse dhe mbahen në formë elektronike (në tabela në eksel).
Nga tabela e mësipërme rezulton se për periudhën e audituar 01.10.2016 – 01.10.2018, subjektet që duhet të sillnin në DRM raportet e monitorimit për çdo 6 muaj rezulton se nuk i kanë sjellë ato për **701 raste**, në kundërshtim me nenin 29, pika b (ii) të ligjit nr.10488, datë 14.07.2014 "Për lejet e mjedisit", si dhe për mosplotësim të kushteve të lejes dhe numrit të vetë monitorimeve. Këto subjekte ishin njoftuar në formë shkresore për kryerjen e raportit të vetëmonitorimit në bazë të kushtit Nr. 4.1.4 të lejes për të sjelle një herë në gjashte muaj të dhënat e monitorimit në DRM Durrës, në plotësimin të detyrimeve ligjore për informacionin periodik mjedisor. Kjo liste e këtyre subjekteve që nuk kanë kryer vetmonitorim i ishte dërguar rast pas rasti në formë shkresore ISHMPUT Durrës, duke qenë se është institucioni që kryen kontrollin dhe inspektimin e zbatimit të kushteve të Lejes së Mjedisit në terren.

*Tabela nr.29*

| Viti | Shkresa Lenda | Nr.prot | Date | Mberritur ne ISHMPU | Nr. Prot | Date | Shenime |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Tetor-Dhjetor 2016** | Kërkesë për marrjen e sanksioneve ligjore ndaj subjekteve që nuk kanë dorëzuar/dërguar gjatë vitit 2016 pranë DRM Durrës, asnjë relacion shkresor vetmonitorimi për aktivitetin që ushtrojnë. | 197 Prot. | 10.02.2017 | - | - | - | 76 subjekte |
| **2017** | Kërkesë për marrjen e sanksioneve ligjore ndaj subjekteve që nuk kanë dorëzuar/dërguar gjatë vitit 2017 pranë DRM Durrës, relacione shkresore vetmonitorimi për aktivitetin që ushtrojnë | 828 Prot. | 07.05.2018 | - | - | - | 387 subjekte |
| **Janar-Shtator 2018** | Informacion për subjekteve që nuk kanë dorëzuar/dërguar gjatë vitit 2018 pranë DRM Durrës, relacione shkresore vetmonitorimi për aktivitetin që ushtrojnë | 9 Prot. | 04.01.2019 | - | - | - | 280 subjekte |

*Burimi: DRM Durrës*

-DRM Durrës ka marrë masa për hartimin e një *database* të veçantë për t'u përditësuar me numrin e subjekteve dhe numrin e raporteve të vetëmonitorimeve periodike që duhet të paraqiten nga secili subjekt, numrin e raporteve të vetëmonitorimit të dorëzuara dhe ato që duhet të dorëzohen, me afatet dhe datat përkatëse, në varësi të llojit të veprimtarisë të subjektit dhe kushteve të lejes. DRM Durrës nuk zotëronte numrin e subjekteve që zhvillonin aktivitet pa marrë leje Tipi C pasi për këto përgjigjej ISHMPUT rajonale.
-Ka patur mos vlerësim në shkallën e duhur nga ana e subjekteve për vetëmonitorimet dhe hartimin e raporteve të vetëmonitorimit.
-Mungesa e raporteve të vetëmonitorimit për të gjitha kategoritë e lejeve bën që të mos njihet si duhet gjendja e mjedisit në qarkun Durrës me të dhënat e shkarkimeve në tokë, ujë dhe ajër.
Raportet e vetëmonitorimit duhet të vlerësohen teknikisht për shkarkimet apo ndërhyrjet që kanë në mjedis, në varësi të aktivitetit/veprimtarisë që ushtrojnë këto subjekte, referuar dispozitave ligjore të mjedisit.
-Edhe subjektet që kanë sjellë raporte vetëmonitorimi rezulton se nuk kanë saktësinë dhe besushmërinë e analizave sepse mungojnë laboratorët shtetërorë me ndihmën e të cilëve mund të sigurohet informacion mbi saktësinë e laboratorëve të akredituar.
-Në arritjen e këtij synimi në monitorimin, vlerësimin e gjendjes, mbrojtjen e mjedisit dhe arritjen e një zhvillimi të qëndrueshëm DRM Durrës duhet të mbështetet në bashkëpunimin me institucionet e DRT Durrës, ISHMP dhe NjQV$^{-të}$ për të evidentuar gjendjen mjedisore dhe punën e bërë për përmirësimin e tij.
Nga auditimi konstatohet se ndërsa nga DRM është njoftuar ISHMP Durrës në mënyrë periodike *(sipas shkresave të paraqitura në tabelë)* nga ana e ISHMPUT Durrës nuk ka asnjë informacion për masat e marra prej tyre ndaj subjekteve që nuk kanë paraqitur monitorimet.
*Strukturat vartëse të MM të tilla si ISHMP, AKM Tiranë dhe në këtë rast DRM* Durrës*, në zbatim të nenit 29, pika 1, gërma b të ligjit nr. 10448, datë 14.07.2011 "Për lejet e mjedisit" dhe ligjit 10431, datë 09.06.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit", sipas përkatësisë, nuk kanë marrë masa këshilluese dhe masa administrative deri në dënime me gjobë, si dhe nuk kanë propozuar pezullimin apo revokimin e lejes së mjedisit për sejcilin subjekt në shkelje të detyrimit për vet-monitorim.*
*-Në arritjen e këtij synimi në monitorimin, vlerësimin e gjendjes së mjedisit, mbrojtjen e mjedisit dhe arritjen e një zhvillimi të qëndrueshëm, DRM* Durrës *duhet të mbështetet edhe në bashkëpunimin me institucionet dhe NjQV-të për të evidentuar gjendjen mjedisore dhe punën e bërë për përmirësimin e tij duke kërkuar informacion për* monitorimin dhe vlerësimin e treguesve mjedisorë për situatën mjedisore, për cilësinë e ujërave sipërfaqësore, kontrollin e shkallës së ndotjes dhe përcaktimin e ndotësve kryesorë që shkarkohen në to për njohjen e gjendjes dhe marrjen e masave për mbrojtjen ose rehabilitimin e mjediseve ujore.
DRM Durrës duhet të punojë për evidentimin e të gjithe subjekteve me ndikim ne mjedis, jo vetëm për paisjen e tyre me leje mjedisi por edhe për zbatimin e kushteve mjedisore të përcaktuara nga ana e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit.
Nga shqyrtimi i Raporteve te Vetëmonitorimeve të dërguara prane zyrës DRM Durrës u vu re se subjektet nuk kanë sjellë të gjithë raportim sipas afatit 6 mujor të përcaktuar në ligj. Për subjektet të C.t kanë dorëzuar ose kanë mungesë të raportit të vetmonitorimit, edhe pse e kanë të cituar në kushtet e lejes mjedisore; kjo ka vazhduar për shumë subjekte edhe pasi janë njoftuar me shkresë zyrtare nga specialistët e DRM Durrës duke ju dërguar në mënyrë periodike AKM dhe ISHMPU Durrës, për terheqje vemendje dhe kryerjen e inspektimeve të këtyre subjekteve: Por, nga ISHMPU dhe AKM nuk është kthyer asnjë përgjigje në lidhje me

marrjen e masave ndaj këryre subjekteve të C.t nuk kanë paraqitur raportet e vetëmonitorimit sipas percaktimit ligjor.
Kushtin e vetëmonitorimit në zbatim të VKM nr. 419 datë DRM-Durrës ja u ka vendosur të gjithë subjekteve për veprimtaritë që paisen me leje mjedisore.
-Për dy vitet e përiudhës së auditimit janë paisur me leje mjediore 278 subjekte me leje te tipit C, nga 526 aplikime gjithësej për këtë periudhë.
-Për dy vitet e përiudhes auditimit janë paisur me leje mjediore 40 subjekte me leje te tipit B. Për këto subjekte DRM Durrës në menyrë periodike çdo fund muaji i ka dërguar ISHMPU Durrës shtojcën për subjektet e pajisura me Leje Mjedisi Tip C**.**
Sipas numrit të vetëraportimeve që nuk kanë plotësuar kriterin, pra numrin e vetëmonitorimeve brenda 6 mujorit, në zbatim të nenit 29 pika b (iii) i Ligjit nr. 10488 datë 14.07.2014 "Për lejet e mjedisit", për mosplotësimin e kushteve të lejes për plotësimin e vetëmonitorimeve duhej të aplikoheshin masa deri në gjoba nga 300 mijë deri 500 mije lekë. Nga auditimi u konstatua se në 3 muajt e fundit të vitit 2016 janë **76** subjekte që nuk kanë sjellë vetë monitorimin; në periudhën e vitit 2017 janë **345** subjekte që nuk kanë sjellë vetë monitorimin; në 9 mujorin e parë të vitit 2018 janë **280** subjekte që nuk kanë sjellë vetë. Nëse ISHMPUT do të kishte aplikuar gjobën minimale prej 300 mijë lekë për 701 subjektet që nuk kanë realizuar detyrimin për vetmonitorim, ka një mosarkëtim në buxhet në shumën 84,400,421 lekë për këto subjekte.
**Në zbatim të pikës "9 b"** të programit të auditimit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:
1- Lejet mjedisore të Tipit A/B
2- Dokumentacioni shkresor dhe elektronik i disponueshëm në institucion në zbatim të ligjit dhe udhzimeve për mjedisin.
***Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:***
Në DRM Durrës u auditua niveli i bashkëpunimit me ISHMP Durrës ku konstatuan të meta e mangësi sipas përcaktimeve ligjore për ardhjen e monitorimeve çdo 6 muaj, përsa i përket zbatimit të procedurave të ndikimit në mjedis dhe raportimit të gjendjes për zbatimin e kushteve në lejet mjedisore të dhëna.
Drejtoria Rajonale e Mjedisit Durrës është institucion i krijuar në zbatim të VKM-së nr. 47, datë 29.01.2014, "Për përcaktimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit e të Agjencive në vazhdim (DRM), si dhe (drejtorive) rajonale të mjedisit" nuk ka për detyrë/kompetencë të vendosë/aplikojë sanksione, kjo është detyrë e DR-ISHMPUT$^{-së}$.
Referuar në ligji nr.10431, datë 09.06.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit", ligjin nr.10440, datë 07.07.2011 "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis", ligjin nr. 10448, datë 14.07.2011 "Për lejet e mjedisit", VKM nr.1189, datë 18.11.2009 "Për rregullat dhe proçedurat për hartimin dhe zbatimin e programit kombëtar të monitorimit të mjedisit" si dhe kushtit i vënë në lejet e marra nga subjektet për raportim periodik, subjektet janë të detyruar të monitorojnë shkarkimet nga veprimtaritë ekonomike në përputhje me kushtet e lejeve mjedisore, të bëjnë vetëmonitorimet dhe të sjellin raportet e vetëmonitorimit pranë DRM$^{-së}$.
Nga auditimi për dhënien dhe miratimin e lejes mjedisore pas vetemonitorimit të subjekteve, nga informacioni i vënë në dispozicion nga DRM Durrës rezulton se një pjesë e subjekteve që me aktivitetet e tyre kanë më shumë ndikim në mjedis, nuk kanë respektuar detyrimin ligjor që buron nga kushtet e lejeve mjedisore, pasi nuk kanë dorëzuar raportet e vetëmonitorimit. Të dhënat e vetëmonitorimeve të pjesshme për një pjesë të subjekteve janë hedhur në rregjistrat e shkarkimeve për vitet përkatëse dhe mbahen në formë elektronike (tabela në ecxel).
DRM Durrës ka marrë masa për hartimin e një database të veçantë, të përditësuar me numrin e subjekteve dhe numrin e raporteve të vetëmonitorimeve periodike që duhet të paraqiten nga

secili subjekt, numrin e raporteve të vetëmonitorimit të dorëzuara dhe ato që duhet të dorëzohen, me afate dhe data përkatëse, në varësi të llojit të veprimtarisë së subjektit dhe kushteve të lejes.

-Nuk ka saktësi dhe besushmëri në analizat nga subjektet që kanë sjellë vetetmonitorimin sepse mungojnë laboratorët shtetërorë me ndihmën e të cilëve do të mund të sigurohej informacion mbi saktësinë e laboratorëve të akredituar.

-Mungesa e raporteve të vetëmonitorimit për të gjitha kategoritë e lejeve bën që të mos njihet si duhet gjendja e mjedisit në qarkun Durrës me të dhënat e shkarkimeve në tokë, ujë dhe ajër.

- *Strukturat vartëse të MM si ISHMP dhe DRM* Durrës*, në zbatim të nenit 29, pika 1, gërma b të ligjit nr. 10448, datë 14.07.2011 "Për lejet e mjedisit" " dhe ligjit 10431, datë 09.06.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit" sipas përkatësisë nuk kanë dhënë dënime me gjobë, nuk kanë propozuar pezullimin apo revokimin e lejes së mjedisit për sejcilin subjekt që nuk ka kryer vetmonitorimin.* Raportet e Vetëmonitorimit duhet të vlerësohen teknikisht për shkarkimet apo ndërhyrjet që kanë në mjedis, në varësi të aktivitetit/veprimtarisë që ushtrojnë këto subjekte, referuar dispozitave ligjore të mjedisit. Nga ana e subjekteve ka patur mos vlerësim sa duhet për vetëmonitorimet dhe hartimin e raporteve të vetëmonitorimit fakt të cilin e tregon shifra e lartë e **743** subjekteve që nuk kanë raportuar për vetmonitorim gjatë periudhës dy vjecare të auditimit nga data 1.10.2016 – 1.10.2018.

Më poshtë po paraqesim në mënyrë tabelare korrespondencën që ka pasur DRM Durrës me ISHMPUT rajonale për nëntmujorin e parë të vitit 2018.

Tabela nr.30

| ISHMPUT Durrës | Dërguar | Kthim përgjgije |
|---|---|---|
| Janar | - | - |
| Shkurt | - | - |
| Mars | - | - |
| Prill | - | - |
| Maj | 2 | 2 |
| Qershor | 7 | 7 |
| Korrik | 8 | 5 |
| Gusht | 10 | 8 |
| Shtator | 11 | 6 |

*Burimi: DRM Durrës*

Nga tabela duket se janë dërguar gjithësej si nëntmujor nga ana e DRM Durrës drejt ISHMPUT Durrës gjithësej 38 shkresa dhe ka përgjigje në 28 raste prej tyre. Pra mungon bashkëpunimi për 10 shkresa gjatë kësaj periudhe nga ana e ISHMPUT Durrës.

-*Në arritjen e synimit në monitorim, vlerësimin e gjendjes së mjedisit, mbrojtjen e mjedisit dhe arritjen e një zhvillimi të qëndrueshëm, DRM* Durrës *duhet të mbështetet në bashkëpunimin me institucionet e ISHMP dhe NjQV-të për të evidentuar gjendjen mjedisore dhe punën e bërë për përmirësimin e tij.*

Nga auditimi konstatohet se ndërsa DRM ka njoftuar ISHMP Durrës në mënyrë periodike dhe njëherë në vit *(sipas shkresave të paraqitura në tabelën më lart)* nga ana e ISHMP nuk ka informacion të plotë për masat e marra ndaj subjekteve që nuk kanë paraqitur monitorimet. DRM Durrës

Nuk ka një realicion shpjegues për ndjekjen e subjekteve të raportuara nga DRM për mos dërgim Raport monitorimi përcaktuar në ligj ku *DRM Durrës në mënyrë periodike çdo fund*

*muaji dhe njëherë në vit si përmbledhje i dërgon ISHMPU Durrës shtojcën për subjektet e pajisura me Leje Mjedisi Tip A,B dhe C.* Në fakt u konstatua se sipas numrit të vetëraportimeve që duhet të vinin në ARM, në **743** raste nuk kanë plotësuar kriterin, pra numrin e vetëmonitorimeve brenda 6 mujorit nga data e futjes në fuqi e lejes, veprim që shkon ndesh me nenin *29 pika b (iii) i Ligjit nr. 10488 datë 14.07.2014 "Për lejet e mjedisit" për mosplotësimin e kushteve të lejes për plotësimin e numrit të lejeve për vetëmonitorimin do të mund të aplikoheshin masa shtërnguese deri në gjoba nga 300 mijë deri 500 mijë lekë.*

ISHMPUT nuk ka raportuar dhe nuk ka hartuar të dhëna me një tabelë nga çdo specialist me emer të cilët të paraqitin inspektimet e kryera dhe masat e marra për periudhën e auditimit ku të përcaktohen inspektimet e kryera dhe masat e propozuara nga inspektori (Emër Mbiemër), vijmësia deri në 01.10.2018 i situates së masës së propozuar duke cilësuar, sipas rastit, subjektin llojin e lejes, masën e propozuar: vërejtje, lënie afati për detyrën, inspektim për herë të dytë apo të tretë, plotësim të raportit, revokim të lejes, gjobë e arkëtuar apo në proces arkëtimi ose gjyqësor.

Këto të dhena i kërkuam në perputhje me ligjin organik të veprimtarisë së KLSH konkretisht :

*Neni 15 pika;*

*e) në përputhje me nenin 26 të këtij ligji, t'u kërkojë subjekteve të audituara që t'i dorëzojnë dokumentet zyrtare, shkresore apo elektronike, si dhe informacionin e kërkuar, në kushtet, afatet dhe strukturën e vendosur prej tij;*

*neni 16,*

*Vlerësimi i sistemeve të kontrollit dhe auditimit të brendshëm 1. Kontrolli i Lartë i Shtetit, në ushtrim të kompetencave të tij, vlerëson funksionimin e përgjithshëm të sistemeve të kontrollit dhe auditimit të brendshëm në organet subjekte të auditimit, duke dhënë, sipas rastit, opinionet dhe rekomandimet e duhura.*

*Neni 26*

*Aksesi në dokumentet zyrtare 1. Kontrolli i Lartë i Shtetit ka të drejtë për të pasur akses në të gjitha dokumentet zyrtare, shkresore apo elektronike, në bazat elektronike të të dhënave si dhe në çdo informacion apo dokumentacion tjetër të subjekteve të audituara të parashikuar në këtë ligj, që mund të përbëjë sekret shtetëror apo konfidencial, dhe që konsiderohen të nevojshme në funksion të ushtrimit të kompetencave dhe detyrave të tij ligjore. 2. Të gjitha subjektet e audituara janë të detyruara t'i sigurojnë Kontrollit të Lartë të Shtetit akses në dokumentet zyrtare sipas paragrafit të mësipërm. Në rast të hasjes së pengesave, veprimeve apo mosveprimeve në kundërshtim me të drejtat e mësipërme, Kontrolli i Lartë i Shtetit i drejtohet, sipas rastit, organit më të lartë administrativ ose organeve të pushtetit gjyqësor.*

DRM nuk ka informacion periodik të plotë nga ana e ISHMP mbi gjobat dhe masat administrative të përkoheshme apo adminsitrative që merren ndaj subjekteve shkelës për mosdërgim te vetemonitorimeve apo tejkalim të normave të shkarkimit në mjedis. Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi specialistët e sektorit të mjedisit K.P., Ergesa Nexhipi dhe E.V. *(Për problemet e trajtuara u mbajt* **Akt verifikimi nr. 4**, *datë 18.01.2019).*

***Në lidhje sa është trajtuar në këtë pikë të mësipërme të programit, nga subjekti i audituar nuk u paraqitën kundërshtime.***

***Pika 10 - Mbi auditimin e ushtruar nga DRM, në subjektet që me aktivitetin e tyre kanë ndikim të lartë e të mesëm në mjedis.***

Me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 10448, datë 14.07.2011, "Për lejet e mjedisit", ka një qasje të re në lidhje me aktivitetet që duhet të jenë objekt i lejes mjedisore. Nëse me legjislacionin e mëparshëm mjedisor, aktivitetet me ndikim të ulët (Autorizim Mjedisor) ishin kategorizuar veçmas nga ato me ndikim të mesëm e të lartë (Leje mjedisore), me ligjin aktual për lejet e

mjedisit, të sipërcituar, të treja kategoritë e aktiviteteve A, B dhe C janë përfshirë në një shtojcë të vetme dhe kategorizimi i aktiviteteve në A, B ose C bëhet në bazë të kapacitetit prodhues kufi të tyre, parametër që është shumë e vështirë të sigurohet saktësisht gjë që e bën shumë të vështirë kategorizimin e aktiviteteve, nëse janë për leje mjedisi të tipit A, B ose C. Për kategorizimin e një aktiviteti, nëse është për VNM të thelluar apo paraprake, këto subjekte i nënshtrohen procedurës paraprake për vlerësimin e ndikimit në mjedis, në zbatim të ligjit nr. 10440, datë 17.07.2011, "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis". Operatori i instalimit nuk paguan çdo vit pagesën vjetore, përkatësisht, Ministrisë, për instalimet e tipeve A dhe B, dhe Drejtorisë përkatëse Rajonale të Mjedisit për tipet C. Në bazë të eksperiencave të mëparshme, kur ARM dhe Inspektoriati ishin një institucion së bashku, mënyra më e mirë për të konkluduar mbi ndikimin real të tyre në mjedis është inspektimi në terren, gjë eC. tashmë kryhet nga ISHMPU Durrës. Këtij institucioni i dërgohet rregullisht një kopje e akt-miratimeve dhe akt-refuzimeve për leje mjedisi tipi C, në mënyrë që të kenë mundësi të bëjnë përditësimin e listës së subjekteve që janë objekt i legjislacionit mjedisor në Shqipëri.
DRM Durrës në lidhje me subjektet me aktivitet të lartë e të mesëm në mjedis disponon një tabelë të cilën e përditëson nëpërmjet informacionit të marrë në AKM ku gjenden të gjitha subjektet e pajisur me leje mjedisore të tipit A dhe B në Durrës. Tabela-regjistër mbahet nga DRM Durrës me qëllimin për të qenë e informuar në lidhje me subjektet (numrin, aktivitetin) që operojnë në territorin e saj.
Në bazë të tabelës së vënë në dispozicion nga DRM Durrës në këtë qark gjenden gjithsej 181 subjekte me ndikim të lartë e të mesëm në mjedis. Nga këto subjekte 13 janë pajisur me leje mjedisore të tipit A, 9 për rrethin e Durrësit dhe 4 për Rrethin e Krujës. Ndër aktivitetet e përfshira në to përmendim "rritje intensive të shpendëve", "prodhim produkte higjienike kozmetike", "rafineri vajrash dhe gazsh", në Durrës dhe kryesisht prodhim çimentoje në Krujë, etj. 168 subjekte janë pasjiur me leje mjedisi të tipit B, nga të C.t 119 për Rrethin e Durrësit dhe 49 për Rrethin e Krujës. Ndër aktivitetet e përfshira në to përmendim në Durrës "magazinim i kimikateve", "stacion transferimi për mbetje jo të rrezikshme", "gaz natyror aromatik ose GLN", "prodhim letre", "përpunim metalesh", "fabrikë këpucësh", "treg fruta-perime me shumicë", "përpunim lëndësh drusore", etj. Në Rrethin e Krujës përmendim "nxjerrje mineralesh, rërë, argjilë, etj.", "prodhim i produketeve abrazive", "prodhim inertesh dhe betoni", "linjë prodhimi gëlqere", "riveshje e gomave të përdorura", "linjë fraksionimi inertesh", etj.
*Për sa është trajtuar në më lart mbi këtë pikë. është mbajtur* ***Akt Verifikimi nr. 1****, datë 04.01.2019.*

***<u>Pika 11 - Auditimi mbi zbatimin e marrëveshjeve me organet e tjera të kontrollit për kryerjen e inspektimit të kontrolleve të përbashkëta.</u>***

Në zbatim të pikave 11; 12; 13 të programit të auditimit *nr.1012/1, datë 02.09.2018* u shqyrtua dokumentacioni i vënën në dispozicion nga subjekti audituar sa më poshtë:
*1.* Evidencat e dërguara në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit me objekt monitorime në mjedis.
*2.* Pasqyrat dhe evidencat e monitorimit.
*3.* Regjistrat e subjekteve që gjenerojnë dhe riciklojnë vajra lubrifikant të përdorur.
4. Urdhëri Nr. 16, datë 06.11.2017 "Për ngritjen e grupeve të punës për zbatimin e programit për evidentimin e problematikës mjedisore në Republikën e Shqipërisë" dhe informacioni përmbledhës dërguar në Ministrinë e Mjedisit dhe Turizmit Tiranë;
5. Urdhëri i Ministrisë së Mjedisit dhe Turizmit Nr.10 date 11.1.2018 "Për inspektimin e guroreve" në rrethin e Krujës dhe Informacioni përmbledhës i dërguar në Ministrinë e Mjedisit dhe Turizmit Tiranë;

6. Urdheri i Ministrit Nr.70, date 12.03.2018, Nr.2075 Prot "Për kontrollin e fabrikave të lëkureve dhe të fabrikave të përpunimit të peshkut"';
7. Urdheri nr.383 date 16.10.2018 "Per ngritjen e grupit te punes per monitorimin e zbatueshmërise se VKM Nr. 177 datë 06.03.2012 'Per amballazhet dhe mbetjet e tyre'" (ky grup është ende në vazhdim të aktivitetit për këtë qëllim).
8. Gjithashtu u audituan edhe rezultatet e arritura nga kontrolli i përbashkët i subjekteve të një grupi të përbashkët pune i ngritur nga Ministria e Mjedisit mes Prefekturës, Agjensisë Rajonale të Mjedisit dhe ISHMPU Durrës, për inspektimin dhe vlerësimin e gjendjes së Vend-depozitimeve të mbetjeve urbane në Qarkun Durrës dhenë fund është përgatitur një informacion përmbledhës dërguar në Ministrinë e Mjedisit dhe Turizmit Tiranë si edhe pranë Prefekturës së Qarkut Durrës.
*9.* Planveprimet e përbashkëta dhe shkëmbimi informacioneve, si dhe shkresat e dërguara për marrje informacioni për përgatitjen e Raportit Gjëndjes Mjedisore (RGJM).
Nga auditimi mbi dokumentacionin e vendosur në dispozicion për bashkëpunimin e DRM$^{-së}$ Durrës me institucione të tjera shtetërore me qëllim parandalimin e ndikimeve negative në mjedis dhe që i përket identifikimit të subjekteve që gjenerojnë e disponojnë mbetje të ndryshme me ndikim të madh në mjedis, si edhe marrja e masave në drejtim të përmirësimit të gjendjes për perudhën raportuese objekt auditimi (*tetor 2016-tetor 2018)* u konstatua se; DRM$^{-ja}$ Durrës me institucionet e tjera shtetërore si; Drejtoria e Shëndetit Parësor (DSHP), Drejtoria e Bujqësisë e Ushqimit (DBU), Autoriteti Kombëtar i Ushqimit Durrës (AKU), Drejtoria Rajonale Tatimore (DRT), Drejtorinë Rajonale ALUIZN Qarku Durrës, si dhe NJQV bashkitë Durrës, Krujë Shijak, nuk kanë kryer asnjë bashkëpunim, sepse me këto institucione nuk ka të dokumentuar ndonjë planveprim të përbashkët, si dhe ka munguar shkëmbimi informacionit të ndërsjelltë, ndërsa DRM është mjaftuar vetëm me dërgimin e shkresave zyrtare për marrje informacioni me qëllim përgatitjen e Raportit të Gjëndjes Mjedisore (*RGJM*); pra ka munguar bashkëpunimi në mënyrë që të bëhet sa më eficente ndjekja dhe evidentimi mbetjeve që gjenerohen në teritorin e qarkut, njëkohësisht për të evidentuar ndërtimet pa leje në toka bujqësore e troje, etj.
Nga auditimi i materjaleve të mësipërme u konstatua se mes Drejtorisë Rajonale të Mjedisit dhe Inspektoriatit Shetëror të Mjedisit, Pyjeve, Ujerave dhe Turizmit, Dega Rajonale Durres, nuk ka pasur ndonjë marrëveshje të nënshkruar mes të dyja palëve në lidhje me kryerjen e inspektimeve të përbashkëta. Për periudhën e auditimit, 2016- tetor 2018, të dy institucionet kanë kryer 4 fushata të perbashkëta inspektuese dhe 1 në vazhdim, sipas urdhërave të punës të mësipërme të miratuara nga Ministria e Mjedisit dhe Turizmit apo ISHMPUT Qendër Tiranë, si më poshtë:
**A.** Në zbatim të Urdhërit Nr. 16, datë 06.11.2017 "Për ngritjen e grupeve të punës për zbatimin e programit për evidentimin e problematikës mjedisore në Republikën e Shqipërisë", Dega Rajonale e ISHMP- Durrës në bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale të Mjedisit Durrës, ngriti **11 grupe inspektimi** për evidentimin e situatës mjedisore në Qarkun e Durrësit. Nga auditimi i procesverbaleve u konstatua se ka pasur hedhje pa kriter të mbetjeve të ndryshme si urbane, inerte, skrapi etj, të C.t ishin të fotografuara dhe përcaktuarame përafërsi sasia e gjetur dhe ngarkuar cdo ditë në sistemin *TrashOut Albania* të ndara sipas rretheve dhe lagjeve kjo sasi e mbetjeve është si më poshtë:

**<u>Rrethi Durrës</u>**

Në Durrës, nga auditimi i dokumentacionit të konstatimit në teren që kanë realizuar së bashku ***DRM & ISHMPTU***, nga këto të fundit ishte verifikua se në lagjet nr.1 – 13 kishte përafërsisht 5 m3 mbetje urbane dhe 18,5 m3 mbetje inerte; - në lagjet nr.14 – 15 - nga verifikimet e kryera

prej tyre në terren ishte konstatuar përafersisht 200.030 m3 mbetje urbane, 18 m3 mbetje inerte, si dhe 16 m3 mbetje plastike; -në Njëinë Administrative Rrashbull, nga verifikimet në terren u konstatuan përafersisht 19 m3 mbetje urbane, 10 m3 mbetje inerte si dhe 20 pjesë automjetesh; -në Njësine Administrative Xhafzotaj, nga verifikimet ne terren u konstatuan përafersisht 32 m3 mbetje urbane, 56 m3 mbetje inerte si dhe 97 pjese automjetesh; - në Njësine Administrative Sukth, nga verifikimet në terren u konstatuan përafersisht 230,5 m3 mbetje urbane, 187 m3 mbetje inerte si dhe 120 pjesë automjetesh; -në Njësine Administrative Ishem, nga verifikimet ne terren u konstatuan përafersisht 156 m3 mbetje urbane, 213 m3 mbetje inerte; -në Njësine Administrative Katund i Ri, nga verifikimet ne terren u konstatuan perafersisht 3 m3 mbetje urbane, 1 m3 mbetje inerte; -në Bashkinë Shijak, nga verifikimet në terren u konstatuan përafersisht 61 m3 mbetje urbane, 60 m3 mbetje inerte si dhe 5 m3 dhera; - në Njësinë Administrative Manëz, nga verifikimet në terren u konstatuan përafërsisht 16 m3 mbetje urbane, 65 m3 mbetje inerte, 10 m3 mbetje hekurishte, 5 m3 pjesë auto, si dhe 4 m3 mbetje të rrezikshme.
**Rrethi Krujë:** Për Bashkinë Krujë u audituan materjalet lidhur me verifikimet në terren që kishin kryer DRM dhe ISHMPUT Durrës të C.t konstatuan përafërsisht 122 m3 mbetje urbane, 502 m3 mbetje inerte, 100 ton mbetje metalike, 12 pjese auto. Në Njësine Administrative **Fushë-Krujë**, Nikël, nga verifikimet në terren u konstatuan përafersisht 154 m3 mbetje urbane, 864 m3 mbetje inerte, 75 m3 mbetje metalike, 32 pjese auto. Situata me problematike paraqitej pergjate rrjedhes se lumenjve, Ishem dhe Erzen ku mbetjet depozitohen pa kriter pergjate rrjedhes.
**Gjetje 1:** Nga auditimi i materjaleve ku u bazua relacioni i dy institucioneve të varrësisë të AKM në Durrës u arrit në përfundimin se në dy rrethet e qarkut Durrës, përkatësisht për tri bashkitë Durrës, Shijak dhe Krujë, lloji kryesor i mbetjeve të evidentuara është mbetje urbane, inerte, mbetje metalike dhe mbetje nga automjetet. Këto probleme ishin më të theksuara në rrethin Durrës.
**B.** Në periudhën 12-30 Janar 2018 sipas Urdhërit të Ministrisë së Mjedisit dhe Turizmit Nr.10 date 11.1.2018,ishte ngritur grupi i punës për inspektimin e guroreve në Rrethin Krujë. Në listë ishin përcaktuar për inspektim ***34 gurore*** sipas listës në tabelën më poshtë, të C.t u verefikuan në terren nga grupi i punës. Nga auditimi i Informacionit përmbledhës të dërguar në Ministrinë e Mjedisit dhe Turizmit Tiranë konstatohen problemet sipas tabelës së mëposhtme:
**Gjetje 2:** Në listën e dërguar nga AKM janë **35 gurore** dhe jo 34. Nga informacioni bazuar tek verifikimi në terren u konstatua se nga këto janë **7** karriera argjile. (të C.t në listën e dërguar nga dega rajonale mbajnë nr; 28, 29, 30, 31, 32, 33, 34). Gjatë inspektimit ishin konstatuar ***edhe 3 gurore*** që nuk ishin në listën e AKM.
**Gjetje 3:** Nga auditimi i informacionit dërguar Ministrisë së Mjedisit dhe Turizmit u konstatua se **1 gurore** punonte pa pasur leje mjedisore dhe disa të tjerave ju kishte mbaruar afati.
**Gjetje 4:** Nga auditimi i informacionit dërguar Ministrisë së Mjedisit dhe Turizmit u konstatua se **1 guroreje** i ishtë pezulluar leja e shfrytëzimit.
**Gjetje 5:** Nga auditimi i informacionit dërguar Ministrisë së Mjedisit dhe Turizmit janë **34 gurore** për të C.t dega rajonale nuk ka pasqyruar në proçes verbal të dhëna për koordinatat.
**Gjetje 6:** Nga auditimi i informacionit dërguar Ministrisë së Mjedisit dhe Turizmit u konstatua se ishin **10 gurore** të C.t nuk kishin hequr sipërfaqen e dhënë në shfrytëzim nga fondi pyjor kullosor.
**Gjetje 7:** Nga auditimi që u ushtrua mbi relacionin dërguar Ministrisë së Mjedisit dhe Turizmit lidhur me inspektimin në terren prej dy institucioneve DRM & ISHMPUT, Durrës u konstatua

se ishin 6 gurore që nuk kishin dorëzuar në AKM raportet e vetmonitorimit sipas kushteve të lejes

**C.** Në shkurt të vitit 2018, ishte ngritur grupi i punës nga Ministria e Mjedisit dhe Turizmit, në bashkëpunim me Prefekturat dhe Agjensitë Rajonale të Mjedisit dhe Inspektoriatet Rajonale, për inspektimin dhe vlerësimin e gjendjes së Vend-depozitimeve të mbetjeve urbane në Qarkun Durrës. Fushata u organizua sipas dy grupeve të punës, për rrethin Durrës dhe Krujë. Në rrethin Durrës u inspektuan 5 vend-depozitime mbetjesh urbane dhe për rrethin Kruje, 4 të tilla. Qëllimi i inspektimit ishte vleresimi i gjendjes aktuale të këtyre vend-depozitimeve në kuadër të përcaktimit të kapaciteteve maksimale, tejkalimit të këtyre kapaciteteve, plotesimit të kushteve të nevojshme dhe vlerësimi i përcaktimit të vend-depozitimit i cili ploteson kushtet për të qenë Vend-depozitim i mitaruar për grumbullimin e mbetjeve urbane. Në fund të procesit të vleresimit informacioni u dërgua pranë Prefekturës së Qarkut. Nga auditimi i materjalit të këtij informacioni u konstatua se:

**Gjetje 8:** Të gjitha vend-depozitimet në rrethin Durrës:Porto Romano-Lagja nr.15, pranë korpusit Universitar, Vadardh-Sukth i Ri, Manze-prane Grykë-Minierës, Ishëm- Fushë Bize dhe në rrethin e Krujës:Kameras Fushë-Krujë -Pranë liqenit dhe përroit te Bardharit, Krastë Krujë-Brenda ekonomisë pyjore Krastë rreth 1 Km në distancë nga qyteti i Krujës, Fshati Dukagjin, Thumanë, kanë qenë jashte kushteve të lejuara mjedisore dhe ato kishin tejkaluar kapacitetin e mjaftueshem per depozitim dhe subjektet duhej të përcaktonin një vend-depozitimi te ri që te plotesonin kushtet e nevojshme (pozicioni, siperfaqja, kapaciteti, kushtet teknike) referuar VENDIMIT Nr.175, datë 19.1.2011 PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË KOMBËTARE TË MENAXHIMIT TË MBETJEVE DHE TË PLANIT KOMBËTAR TË MENAXHIMIT TË MBETJEVE.

**Gjetje 9:** Nga auditimi i materjaleve të verifikuara në terren nga DRM & ISHMPUT Durrës,, në listën totale të subjekteve të përcjella **3 subjekte** kishin mbylluar aktivitetin dhe nuk ushtronin veprimtari ekonomike; **1 subjekt** nuk ishte gjetur në terren kurse **6 subjekte** të tjera ju ishte kontrolluar dokumentacioni sipas listës së verefikimit dhe kishin pasur disa probleme si: tek fabrikat e përpunimit të peshkut problematikë kryesore ishte mungesa e depuratorëve të ujit (linja e trajtimit të ujërave të ndotura) referuar LIGJIT Nr.9115, datë 24.7.2003 PËR TRAJTIMIN MJEDISOR TË UJËRAVE TË NDOTURA)Ndërsa në lidhje me fabrikat e regjies së lëkurës, nuk u konstatuan probleme duke qenë së nuk u inspektua asnje fabrike në kushte pune.

**D.** Në zbatim të VKM Nr. 177 datë 06.03.2012 Për amballazhet dhe mbetjet e tyre, referuar Urdherit nr.383 date 16.10.2018, Per ngritjen e grupit te punes per monitorimin e zbatueshmërise se VKM Nr. 177 datë 06.03.2012 'Per amballazhet dhe mbetjet e tyre' (akoma ne ndjekje). Për këtë fushate nga auditimi i dokumentacionit në DRM Durrës u konstatua se ajo ende është në proces ndjekje dhe nga grupi i punës ishin evidentuar paraprakisht **5 subjekte** që do të kontrolloheshin mbi përmasat në mikronë të materjalit plastik të prodhuar nga secila prej tyre.

Mungesa e bashkëpunimit mes institucionit dhe organeve të tjera të kontrollit, ka sjellë edhe mungesën e informacionit për të bërë të mundur njohjen e faktorëve që kanë ndikim në mjedis për cështje të tilla si:

- grumbullimi i materialeve, apo mbetjeve të tjera të C.t nuk nevojiten për nevoja teknologjike a janë të vendosura në vende të miratuara nga pushteti lokal;
- shfrytëzimi i sipërfaqeve me shkallë për të lejuar rehabilitimin e sipërfaqeve;
- respektimi i koordinatave sipas kërkesave të përcaktuara në dosjen përkatëse;

- shfrytëzimi i karrierave për kryerjen në vazhdimësi të rehabilitimit të sipërfaqeve të shfrytëzuara, duke i gjelbëruar, mbjellë e kultivuar me bimë e pemë të ndryshme lokale, të C.t janë të adoptueshme për zonën; -për zbatimin e të gjitha normave ligjore për shkarkimet në tokë, ujë dhe ajër;
- ulja e ritmit të shfrytëzimeve për stinën e verës për të evituar në maksimum pluhurat apo procesin e mundshëm të erozionit;
- marrja e masave për kanalizimin e ujërave, në mënyrë që të mos ndikojë në gërryerjen e formacionit;
- lagia e terreneve të punës dhe sidomos vendburimet e materialit të nxjerrë;
- kryerja e analizave të përbërjes kimike të lëndës së parë për të dalë me shifra konkrete prania, ose jo e rodonit;
- sistemimi i skarpateve përfundimtare të shkallëve të shfrytëzimit dhe respektimin e parametrave gjeometrikë të tyre etj.

Në këto kushte si pasojë e mungesës së bashkëpunimit nga institucionet dhe organet e tjera të kontrollit nga procesi i auditimit rezultojnë këto gjetje;
- DRM Durrës nuk disponon të dhëna të plota për personat fizikë dhe juridikë, veprimtaria e të cilëve gjenerojn mbetje, ndërsa subjekti detyrohet të ndërtojë linja dhe impiante për përpunimin dhe riciklimin e mbetjeve;
- DRM Durrës nuk ka të evidentuar subjektet që janë objekt i lejes, apo autorizimit mjedisor veprimataria e të cilëve gjeneron mbetje jo urbane, ndërsa kryejnë aktivitetin e tyre brenda territorit të qarkut Durrës;
- DRM Durrës nuk ka të evidentuar subjektet, veprimataria e të cilëve gjeneron mbetje vecanërisht ato që kanë përbërës të rrezikshëm, me qëllim që të evidentohen mënyrat e grumbullimit, transportimit, depozitimit dhe trajtimit të tyre deri në asgjësimin përfundimtar.

Veprimet e mësipërme janë kryer në mospërputhje me pikën 4, të Aneksit nr.2, të VKM nr. 418, datë 25.06.2014 "*Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim*" dhe për këtë ngarkohen me përgjegjësi specialisti i monitroirmit në DRM Durrës për periudhën e auditimit, **B.Gj.** (nga fillimi i periudhës së auditimit më 1 tetor 2016 deri më 25.5.2018).

*Për sa është trajtuar në më lart mbi këtë pikë, është **mbajtur Akt Konstatimi nr. 4**, datë 18.01.2019.*

***Në lidhje me sa është trajtuar në këtë pikë të programit, nga subjekti i audituar nuk u paraqitën kundërshtime.***

***Pika 12 - Auditimi mbi aplikimin e sanksioneve të vendosura.***

DRM Durrës si institucion i krijuar në zbatim VKM nr.47, datë 29.01.2014 "*Për përcaktimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit e të Agjencive Rajonale të Mjedisit*", nuk ka për detyrë/kompetencë të vendosë /aplikojë sanksione, detyrë e C. është vetëm e Inspektoriatit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve, Ujërave e Turizmit Durrës (ISHMPUT).

Për sa trajtuar më lart mbi këtë pike është mbajtur ***Akt Verifikimi nr. 2, datë 04.01.2019***.

***Pika 13-Auditim mbi verësimin e funksionimit të Sistemeve të Kontrollit të Brendshëm.***

U shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Regullorja e funksionimit të brendshëm
- Ligji nr. 10448, datë 14.07.2011, "Për lejet e mjedisit"

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:

DRM Durrës, krijuar nëpërmjet VKM nr. 47, datë 29.01.2014, "Për përcaktimin e rregullave për organizimin e funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe të agjencive

(drejtorive) rajonale të mjedisit" nuk ka në strukturën e saj auditues apo specialistë për kontrollin e brendshëm të institucionit.
Struktura e DRM Durrës ka në përbërjen e saj Drejtor Drejtorie (aktualisht të komanduar), nëntë specialistë për leje mjedisore dhe vlerësim të ndikimit në mjedis, një specialist monitorimi dhe një specialist finance.
DRM Durrës nuk ka kompetencë të hartojë programe, të organizojë sisteme apo të përcaktojë struktura standarde për dokumentimin, qarkullimin dhe nxjerrjen nga përdorimi të aktivëve në njësinë publike. DRM është njësi shpenzuese e një programi buxhetor dhe për këtë arsye në fillim të vitit nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit i shkon i miratuar buxheti vjetor. Çdo veprim i DRM-së udhëzohet dhe kontrollohet nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit dhe Ministria e Turizmit dhe Mjedisit.
Për sa është trajtuar në këtë pikë, është mbajtur ***Akt Verifikimi nr. 3, datë 04.01.2019***.

***14 - Probleme të ndryshme që mund të dalin gjatë auditimit.***
Gjatë auditimit nuk ka pasur probleme të tjera, veç atyre çështjeve të programit të trajtuara në Projekraportin e Auditimit.

## IV. Gjetjet dhe rekomandimet

Për përmirësimin e punës në të ardhmen për DRM Durrës *rekomandojmë*:

### A. MASA ORGANIZATIVE

**1- Gjetje nga auditimi:** Në analizën e fondeve të programuara në projektbuxhetet dhe alokimet për shpenzime të përdorura nga njësia shpenzuese DRM Durrës, rezulton se fondet për shpenzime janë në kushtet e pamjaftueshmërisë për realizimin e funksioneve të institucionit, sepse ka mungesa investimi për paisje zyre e mjete transporti për lëvizjen e specialistëve për kontroll dhe monitroim të subjekteve që janë pajisur me lejet mjedisore të cdo tipi. Ka mungesë në ambiente pune, ku edhe ato në dispozicion janë në kushtet të papërshtatshme dhe të pamjaftueshme për punonjësit, njëkohësisht mungon ambienti për funksionimin e arkivit dhe protokollit. Ka mungesë në fonde për shpenzime operative, për udhëtime të specialistëve jashtë vendit të punës, në territorin e qarkut për ushtrimin e verifikimeve të nevojshme në terren në subjektet e pajisura me leje mjedisore, si dhe për shpenzime për dokumenta evidentuese (larje foto), të C.t janë të domosdoshme dhe pjesë e procedurave për paisjen me leje mjedisore të tipit (C), apo të dhënies së mendimeve për VNM e leje tipi (A) e (B) të subjektit aplikues (*Trajtuar në faqen **18-20** të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
**1.1.Rekomandim**: DRM Durrës nëpërmjet hartimit të projektbuxhetit, të bëjë analizë të plotë dhe të kërkojë pranë Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit zgjidhjen për të siguruar ambiente të përshtatshme për zyra me qëllim krijimin e kushtev të punës për punonjësit e institucionit, duke përfshirë dhe ambientin për arkiv-protokoll. Njëkohësisht të kërkojë rishikimin e alokimit dhe rritje fondeve të programuara për shpenzime operative në mbështetje të funksioneve të saj.
**Në vijimësi**

**2- Gjetje nga auditimi:** Në auditimin e kryer mbi nxjerrjen e hartimin e pasqyrave financiare të njësisë shpenzuese DRM Durrës për periudhën raportuese objekt auditimi u konstatua se pasqyra financiare (bilanci kontabël) nuk mund të quhet se pasqyron realitetin e gjendjes së aktiveve, pasurisë, aseteve e gjendjes materiale të institucionit, pasi rezultati i inventarizimit

fizik nuk i ka shërbyer hartimit të pasqyrës financiare sepse, ndërmjet gjendjes fizike e gjendjes së deklaruar në pasqyrën financiare rezultojnë diferenca; njëkohësishtë 8 artikuj janë të administruar vetëm në sasi pa vlerë dhe 5 artikuj janë në përdorim, por të pa administruar e dokumentuar në sasi e vlerë. Këto veprime janë mospërputhje me UMF nr.28, datë 18.12.2014 "Për procedurat e mbylljes së llogarive vjetore të buxhetit", Kap VI "Rakordimi dhe mbyllja e llogarive të tjera vjetore të qeverisjes se përgjithshme", pika 33 "Rakordimi, mbyllja e llogarive të tjera vjetore të njësive dhe hartimi i pasqyrave financiare do të vazhdojë të kryhet në bazë të UMF nr.14, datë 28.12.2006 dhe nr.26, datë 27.12.2007 ndryshuar me udhëzimi nr.10, datë 27.02.2008" dhe UMF nr.30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", Kreu IV "Sistemi kontrollit periodik aktiveve", pika 74"Inventarizimi aktive"(*Trajtuar në 32-39 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
**2.1.Rekomandim:** DRM Durrës, specialisti financës të marrë masa të plota për të kryer vlerësimin dhe administrimin e aktiveve të qëndrueshme qarkulluese të institucionit të C.t janë në përdorim pa vlerë dhe të pa administruara, nëpërmjet kontabilizimit me qëllim që inventarizimi fizik i aktiveve të qëndrueshme qarkulluese, ti shërbej hartimit të pasqyrës financiare.

**Brenda muajit Shtator 2019**

**3- Gjetje nga auditimi:** DRM Durrës nuk ka të përditësuar periodikisht listën e subjekteve të pajisur me leje mjedisore të tipit (C) që janë aktive, të nxjerrë nga bashkëpunimi periodik me DRT Durrës, QKL, DR ISHMPUT apo dhe me NJVQV$^{-të}$ (për 6 bashkitë) për numrin e përgjithshëm të subjekteve që ushtrojnë veprimtari ekonomike në qarkun Durrës e që kanë ndikim në mjedis, për të ditur subjektet që duhet të bëjnë vetmonitorim dhe subjektet që zhvillojnë ativitet të pa pajisur me leje mjedisi në kundërshtim me nenin 4 dhe nenin 10 të ligjit nr.10431, datë 09.06.2011"*Për lejet e mjedisit*" për ushtrimin e veprimtarisë ekonomike dhe VKM nr.419, datë 25.6.2014, kreu VIII pika 1,2,3 (*Trajtuar në faqen 62 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
**3.1.Rekomandim:** DRM Durrës në bashkëpunim me AKM Tiranë të marrë masa për të evidentuar e ndjekur subjektet aktive mbajtës të lejeve mjedisore tipi (C) dhe subjektet që ushtrojnë veprimtari ekonomike të pa pajisur me leje mjedisore, duke rakorduar me DRT Durrës, ISHMPUT, QKL dhe NJVQV$^{-të}$, për numrin e përgjithshëm të subjekteve aktive që ushtrojnë në çdo periudhë të kohës veprimtari ekonomike në qarkun Durrës, ndjekjen e monitorimin e vazhdueshëm të tyre si edhe të subjekteve që zhvillojnë aktivitet ekonomik të pa pajisur me leje mjedisi sipas subjekteve të përcaktuara në bazë të aktivitetit kufi tek shtojca nr.1 e ligjit 10448, datë 14.07.2011.

**Menjëherë**

**4- Gjetje nga auditimi:** DRM Durrës në formulimin e akteve të refuzimit të lejeve tipi (C), është konstatuar se, në disa raste mungojnë citimet në nenin apo pikën e bazës ligjore e nënligjore dhe pikat e shtojcës përkatëse të përcaktuara në VKM nr.419, datë 25.6.2014, kreu 4 pika 9 dhe10 dhe shtojcës nr. 6 për secilin prej kushteve të paplotësuara. Në akt refuzimet DRM Durrës është mjaftuar në përgjithësi vetëm me përmendjen apo citimin e ligjit nr. 10431, datë 09.06.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit"; gjithashtu mungojnë aktverifikimet ne terren dhe relacionet përkatëse të grupit të specialistëve për argumentimin e refuzimeve*(Trajtuar në faqe 43-52 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
**4.1.Rekomandimi**: Në urdhrin e brendshëm të drejtorit të DRM Durrës për ngritjen e komisionit të licensimit me Leje Tipi C, të kërkohet që ato të përgatisin dhe formulojnë

qartësisht në çdo rast arsyetimin ligjor për akt-refuzimet, duke i mbështetur në çdo rast shkaqet e refuzimit edhe me bazën nënligjore të kushtete, sipas shtojcës nr.6.

**Menjëherë**

**5- Gjetje nga auditimi:** Në DRM Durrës u konstatua se procesverbalet e mbledhjeve të komisioneve teknike gjatë verifikimit dhe shqyrtimit të kërkesave për miratimin ose refuzimin e lejeve mjedisore janë mbajtur pa regulla drejtshkrimi dhe pa korrektesë gjuhësore, sidomos në 19 raste ku u konstatuan mangësi në konceptim dhe formulim dhe nuk janë evidentuar diskutimet, mendimi i NJVQV, dokumentacioni, situatat, zhvillimi i tyre, duke mos prezantuar një informacion të plotë në përputhje me kërkesat e ligjit nr.10448, datë 14.07.2011"Për lejet e mjedisit" dhe VKM nr. 419, datë 25.06.2014. Në procesverbalet e mbledhjeve të komisionit nuk pasqyrohen as të dhënat mbi zotërimin e dokumentave të pronësisë, dokumentimi i mendimit të NJVQV-ve dhe informacion tjetër ligjor që lidhet me mbrojtjen e mjedisit, sepse këto informacione ligjore pothuaj në asnjë rast nuk kanë qenë të pasqyruara me korrektësi në këto shënime *(Trajtuar në faqen 43-45 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
**5.1. Rekomandim:** Kryetari i Komisionit të dhënies së 'Leje Tipi C' të marrë masa që në procesverbalet e mbajtura në mbledhjen e komisioneve për leje mjedisi tipi (C), të pasqyrohen e citohen saktësisht në çdo rast shënimet nga ana e formës dhe përmbajtjes së aktivitetit gjatë shqyrtimit të dokumentacionit në mbledhjet e komisioneve teknike dhe të pasqyrohen në këto procesverbale në mënyrë objektive dhe sipas rregullave të drejtshkrimit arsyet e pranim/refuzimit, mangësitë ligjore dhe dispozitat përkatëse, duke kërkuar respektimin e kushteve apo kritereve ligjore e nënligjore që duhen plotësuar nga subjektet me informacion të plotë për vlerësimin e dokumentacionit.

**Në vazhdimësi**

**6- Gjetje nga auditimi:** Është konstatuar gjatë kontrolleve të kryera në DRM Durrës ka diferenca mes të dhënave që subjektet paraqesin në raportet e vetëmonitorimit dhe ndotjes reale të mjedisit prej tyre, kjo pasi në disa raste analizat e sjella prej tyre nuk kanë saktësi dhe besueshmëri të lartë dhe mungojnë laboratorët shtetërorë me ndihmën e të C.ve do të mund të sigurohej një informacion më i përafërt mbi saktësinë e të dhënave në cdo rast prej laboratorëve të akredituar sipas VKM nr.1185, datë 18.11.2009*"Për rregullat dhe procedurat për hartimin dhe zbatimin e programit kombëtar të monitorimit në mjedis",* vendim i cili ka nevojë për ndryshime dhe përshtatje me kushtet e reja, pasi ka mangësi në vërtetësinë e raporteve të vetëmonitorimit *(Trajtuar në faqe 60-65 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
**6.1.Rekomandim:** DRM Durrës në bashkëpunim me AKM Tiranë, të marrin masa që të parashikohen fonde të nevojshme për të lidhur kontrata me subjekte të liçensuara dhe akredituara laboratorike për marrjen prej tyre të shërbimit të kërkuar laboratorik për verifikime të pavarura me analiza shoqëruese të dhënash ndaj subjekteve që kërkojnë leje mjedisore ose që kryejnë vetmonitorim.

**Në vazhdimësi**

**7- Gjetje nga Auditimi:** Mungesa e raporteve të vetëmonitorimit për të gjitha kategoritë e lejeve bën që të mos njihet si duhet gjendja e mjedisit në qarkun Durrës me të dhënat e shkarkimeve në tokë, ujë dhe ajër.
Raportet e vetëmonitorimit nuk janë vlerësuar teknikisht për shkarkimet apo ndërhyrjet që kanë në mjedis, në varësi të aktivitetit/veprimtarisë që ushtrojnë subjektet e ndryshme me Leje Tipi C, referuar dispozitave ligjore të mjedisit, ligjit nr.10448, datë 14.07.2011"Për lejet e

mjedisit" dhe VKM nr. 419, datë 25.06.2014 *(Trajtuar në faqen 60-66 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**7.1. Rekomandim:** DRM Durrës të marrë masa për hartimin e një database të veçantë, të përditësuar me numrin e subjekteve dhe numrin e raporteve të vetëmonitorimeve periodike që duhet të paraqiten nga secili subjekt, numrin e raporteve të vetëmonitorimit të dorëzuara dhe ato që duhet të dorëzohen, me afate dhe data përkatëse, në varësi të llojit të veprimtarisë së subjektit dhe kushteve të lejes.

**Menjëherë**

**8- Gjetje nga Auditimi:** DRM Durrës për periudhën raportuese tetor 2016 – teror 2018, ka dhënë ***258 mendime për vlerësime të ndikimit në mjedis (VNM)*** dhe për leje mjedisore për licencimet të tipit (A), (B) nga AKM. Për këto DRM Durrës ka data base elektronike për vitin 2017-2018 por nuk ka informacione të sakta nga AKM Tiranë për ecurinë e procedurës për ***shumicën e praktikave të dhënies së mendimit prej tyre,*** përcaktime këto të bëra në VKM nr. 419, kreu VIII tek Dispozitat përfundimtare. Këto veprime janë në kundërshtim edhe me urdhrin e Ministrit të Mjedisit nr. 1964, datë 13.11.2014 "Për miratimin e procedurave të administrimit dhe formatit të regjistrave të lejeve të mjedisit të tipit (A), (B) dhe (C)". Gjithastu, DRM Durrës nuk disponon një data base elektronike mbi VNM dhe dhënie mendimi për Leje Tipi A/B për periudhën e auditimit tetor-dhjetor 2016 dhe për gjithe vitin 2016 *(Trajtuar në faqe **55-60** të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**8.1.Rekomandim:** DRM Durrës të kërkojë nga AKM Tiranë, marrjen e të dhënave në lidhje me ecurinë e praktikave që ka dhënë mendime për VNM$^{-të}$ e lejet mjedisore tipi (A; B) me synim përditësimin nga ana e saj në formë elektronike të rregjistrit të lejeve tipi (A, B) sic përcakton VKM nr. 419, kreu VIII tek Dispozitat përfundimtare sipas formatit standard të miratuar, zbatimin e afateve dhe procedurave ligjore, si dhe mundësimin e bashkëpunimit ligjor me strukturat e tjera si DRISHMU, NJVQV$^{-të}$ dhe QKL.

**Menjëherë**

**9- Gjetje nga auditimi:** DRM Durrës për periudhën raportuese tetor 2016 –2018, nuk ka hartuar program pune për bashkëpunim dhe kryerje të kontrolleve të përbashkëta dhe bashkëpunim me NJVQV (*bashki e njësi administrative*) për mbetjet urbane dhe mbetjet spitalore sipas Urdhërit Nr. 16, datë 06.11.2017 "Për ngritjen e grupeve të punës për zbatimin e programit për evidentimin e problematikës mjedisore në Republikën e Shqipërisë". Gjithashtu, bashkëpunimi ndërmjet DRM dhe ISHMPU Durrës ka qenë në kushtet e pamjaftueshmërisë dhe nuk janë shtrirë në të gjithë intervalin kohor të auditimit kontrollet e monitorimet e përbashkëta për informalitetin e zbatimit të kushteve të lejeve mjedisore, në përmbushje të kërkesave të ligjit nr.10431, datë 09.06.2011 "*Për mbrojtjen e mjedisit*" dhe kërkesave të përcaktuara në Kreu VII, pika 2 ku përcaktohet se "Agjencia Kombëtare e Mjedisit administron sistemin e informacionit mjedisor"dhe pika 3 ku thuhet se "Autoritetet publike bashkëpunojnë me Agjencinë Kombëtare të Mjedisit, me qëllim sigurimin e funksionimit të duhur të këtij sistemi...", VKM nr.47, datë 29.01.2014 "*Për përcaktimin e rregullave për organizimin e funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe të agjencive rajonale të mjedisit*" sipas pikës a të Kreut VI ku thuhet se: "AKM-ja lidh marrëveshje dhe bashkëpunon me njësitë e qeverisjes vendore mbështetur në ligjin "Për organizimin dhe funksionimin e njësive të qeverisjes vendore", si dhe në legjislacionin mjedisor" *(Trajtuar në faqe 66-70 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**9.1. Rekomandim:** DRM Durrës nëpërmjet bashkëpunimit me AKM duhet të nxitë dhe të kërkojë prej saj që në hartimin e programit vjetor të punës të DRM Durrës, që të pasqyrohet qartë edhe bashkëpunimimi me institucionet e tjera, me qëllim kryerjen e monitorimeve nëpërmjet kontrolleve të përbashkëta me ta, në zbatim të marrëveshjeve të bashkëpunimit me organet e tjera të kontrollit, si me Drejtorinë Rajonale të Tatimeve, NJQV dhe DR ISHMPUT Durrës për zbatimin e kushteve të lejeve mjedisore dhe ndikimit në mjedis.

**Në vazhdimësi**

**10. Gjetje nga auditimi:** DRM Durrës për periudhën raportuese Tetor 2016 – Tetor 2018 ka shqyrtuar gjithësej **670** dosje për Leje Tip C + mendim VNM (526+ 144 raste) duke kryer njoftim në NJVQV në **277** raste ose në masën **41 %** të tyre. NjVQV janë përgjigjur gjithësej në **188** raste ose në masën **67%** të rasteve të njoftuara, në mungesë të të C.ve DRM ka vijuar procedurat e miratimit të lejeve pa kthim përgjigje nga NJQV, sipas pikës 2, 3 dhe 4, Kreu IV të VKM nr.419, datë 25.06.2014 “***Mbi afatin 3 ditor”*** të përgjigjes për mendimin e NJQV për miratimin e lejeve mjedisore tipi (C) ku në pikën 4 thuhet se “Nëse NjVQV-ja përkatëse nuk shprehet brenda afatit, DRM vijon me procedurën” *(Trajtuar në faqe 41-43 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**10.1. Rekomandim:** DRM Durrës të marë masa dhe të gjejë forma bashkëpunimi për tërheqjen e e mendimit ndaj subjekteve që aplikojnë për Leje tip C nga ana e NJVQV$^{-të}$ përkatëse dhe të sigurojë prej tyre dhënien e mendimit brenda afatit 3 ditor. DRM Durrës, herë pas here, për rastet e mosdhënies së mendimit nga ana e NJVQV të njoftojë zyrtarisht AKM Tiranë dhe Ministrinë e Mjedisit në lidhje me angazhimin e e NJVQV në dhënien e mendimeve të mbi subjektet që kërkojnë leje Tip C.

**Në vazhdimësi**

**11. Gjetje nga Auditimi**: DRM Durrës në dokumentacionin elektronik të dosjeve për dhënie mendimi për VNM$^{-të}$ e lejes mjedisore të tipit A e B pothuajse në të gjitha rastet mungojnë praktikat e procesit të konsultimeve dhe dëgjesave me publikun. Në mbi **34** raste për dëgjesat me publikun DRM është shprehur se; “*....do të kryhen hap pas hapi në fazën e zbatimit të projektit...”*. Nga auditimi u konstatua se në subjektet që kanë filluar punimet, deri në përfundim të periudhës së auditimit, nuk ka informacione për realizimin e të gjitha këtyre dëgjesave, veprime në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 419, datë 25.06.2014 “*Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për Leje Mjedisi të Tipi A,B,C, për transferimin e lejeve nga një subjekt tek tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKL”,* Kreu I, pika 1/dh, Kreu VI, pika 12; 13; 15; 16 dhe 22 *(Trajtuar në faqet 55-60 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**11.1. Rekomandim:** DRM Durrës në bashkëpunim me AKM Tiranë, të marrë masa që të komunikojë në dëgjesa me publikun në të gjitha rastet kur veprimtaria e subjektit që aplikon për lejë ka impakt mjedisor ose kur kjo kërkohet nga publiku i interesuar, sidomos në rastet e lejeve tip A/B dhe VNM dhe kjo të realizohet para se të jepet mendimi për leje mjedisore e jo pasi të ketë filluar aktiviteti investues ose prodhues nga ana e subjektit.

**Në vazhdimësi**

**12. Gjetje nga auditimi**: Nga auditimi i strukturës së organikës së DRM Durrës për periudhën objekt auditimi u konstatua se ka pasur ndryshime të shpeshta të specialistëve, çfarë ka shkaktuar mungesën e eksperiencës së specialistëve duke ndikuar negativisht në realizimin e

objektivave dhe funksioneve të institucionit, pasi DRM e ushtron aktivitetin në Qarkun Durrës në një teritor të gjerë, me veprimtari ekonomike intensive, me gjendje të madhe asetesh dhe pasurish natyrore, faktorë këta që kërkojnë vazhdimësi, eksperiencë dhe profesionalizëm të lartë në mjedis e shoqëruar kjo me një numër të konsiderueshëm specialoistësh në strukturen e DRM-së. Kështu, gjatë periudhës së auditimit u konstatua se ka pasur gjithësej 18 punonjës me status të nëpunësit civil dhe 1 në periudhë prove nga të cilët janë larguar 10 punonjës *(Trajtuar në faqen **20** të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**12.1. Rekomandim:** DRM, AKM dhe Ministria e Turizmit dhe Mjedisit duhet të ndryshojë filozofinë e rekrutimit të punonjësve të DRM të cilët janë me status të nëpunësit civil nga DAP për të trajnuar dhe aftësuar punonjësit dhe për të shmangur mundësinë negative të pagesave të disa pagave shtesë të punonjësve që vazhdojnë gjyqet me DRM-AKM për largimin e tyre nga puna.

**Në vazhdimësi**

**13. Gjetje nga auditimi**: Në DRM Durrës për 153 subjekte të cilët nuk kanë kryer pagesën vjetore të tarifës së lejes mjedisore tipi (C), si pa mjaftueshmëri nga fakti mungesës së rregullshmërisë (udhëzim, urdhër, etj...) dhe për të ndjekur proceduarat në rastet e ndërprerjes së aktivitetit për pasojë edhe të lejës mjedisore, ndërsa për 112 subjekte për të cilët është bërë pezullimi lejes mjedisore për mos pagesë të tarifës vjetore të lejës mjedisore në total 265 subjekte (153+112) me tarifë 2,000 lekë në vit, duke krijuar të ardhura të munguar për buxhetin e shtetit shuma 530 mijë lekë (*Trajtuar në faqen 8 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

***13.1. Rekomandim*:** DRM Durrës në bashkëpunim me DRISHMP Durrës, të vazhdojë ndjekjen dhe të marë masa administrative për arkëtimin nga 153 subjekte të tarifës vjetore për leje mjedisore tipi (C), si dhe 112 subjekte pas pezullimit të lejes mjedisore tipi (C).

**Në vazhdimësi**

## V. Konkluzione dhe opinioni i auditimit

***Baza për opinionin:***
KLSH ka audituar veprimtarinë e Drejtorisë Rajonale të Mjedisit Durrës, në mbështetje të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "*Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*" dhe *ISSAI 1700*[1]*, dhe ISSAI 4000*[2].

[1] **ISSAI 1700**- *Objektivi i audituesit është të formulojë një opinion mbi besueshmërinë e llogarive vjetore dhe bazuar në një vlerësim të përfundimeve të hartuara nga evidencat e marra të auditimit të shprehë qartë opinionin nëpërmjet një raporti të shkruar që shpjegon bazat e opinionit.*

Auditimi u krye në përputhje me kërkesat e manualit të auditimit të **përputhshmërisë** dhe atij **financiar** të KLSH si dhe Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të zbatueshme për Institucionet Supreme të Auditimit. Sipas kërkesave etike, të C.t janë relevante për auditimin tonë në institucionet buxhetore, KLSH është e pavarur nga DRM Durrës dhe përgjegjësitë e tjera etike janë përmbushur në pajtim me këto kërkesa. Ne besojmë se dëshmitë e evidencës së auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për sigurimin e bazës për opinionin tonë.

Menaxhimi i DRM Durrës është përgjegjës për hartimin e pasqyrave financiare në përputhje me kuadrin e zbatueshëm të raportimit financiar dhe të kontrollit të brendshëm, për të mundësuar përgatitjen e tyre pa gabime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Përgjegjësia e auditimit është të shprehë një opinion mbi pasqyrat financiare bazuar në rezultatet e auditimit të kryer, për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare janë pa gabime materiale.

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të DRM Durrës për vitin ushtrimor, më 31 dhjetor 2017, të C.t përfshijnë pasqyrën e gjendjes ekonomike, pozicionit financiar (hyrjeve dhe daljeve (pagesave) në para, pasqyra e amortizimit, pasqyrën e krahasimit të fondeve buxhetore dhe rezultateve aktuale, shënimet shpjeguese që shoqëronin këto pasqyra.

Në gjykimin tonë pasqyrat financiare prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale (pa devijime të përhapura materiale) lidhur me performancën e tij financiare dhe fluksin e parasë për vitin respektiv në përputhje me Kuadrin e Raportimit Financiar të Sektorit Publik, si dhe të buxhetit të realizuar nga DRM Durrës për vitin 2017-2018, në përputhje me bazën ligjore që rregullon raportimin financiar dhe atë buxhetor, por vetëm në rastin e rezultatit të inventarizimit fizik, i cili nuk i ka shërbyer me korrektësi hartimit të pasqyrës financiare. Për këtë arsye, grupi i auditimit jep opinion të pakualifikuar me "***Theksim të çështjes***" si më poshtë:

-Nga auditimi i inventarit fizik të llogarisë 218 "Inventar ekonomik" , krahasuar me inventarin kontabël të kësaj llogarie rezultuan diferenca ku në gjendjen fizike janë administruar 8 artikuj vetëm në sasi pa vlerë dhe 5 artikuj janë në përdorim, për të C.t nuk egzistonte dokumentacion në sasi dhe vlerë. Këto veprime janë në mospërputhje me UMF nr. 28, datë 18.12.2014 "Për procedurat e mbylljes së llogarive vjetore të buxhetit", Kap VI "Rakordimi dhe mbyllja e llogarive të tjera vjetore të qeverisjes se përgjithshme", pika 33 "Rakordimi, mbyllja e llogarive të tjera vjetore të njësive dhe hartimi i pasqyrave financiare do të vazhdojë të kryhet në bazë të UMF nr. 14, datë 28.12.2006 dhe nr. 26, datë 27.12.2007 ndryshuar me udhëzimi nr. 10, datë 27.02.2008" dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", Kreu IV "Sistemi kontrollit periodik aktiveve", pika 74 "Inventarizimi i aktiveve".

***Opinion:***

Nga ***auditimi i pasqyrave financiare***, mbështetur në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit, Rregulloren e Procedurave të Auditimit të KLSH dhe Manualin e Auditimit Financiar, përsa i takon shkallës së zbatimit nga subjekti *DRM Durrës,* të standardeve të kontabilitetit, të ligjit mbi kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, udhëzimeve e kushteve të vendosura apo termave mbi raportimin financiar, mbi të C.t është rënë dakord, u evidentua se informacioni financiar i këtij subjekti, është paraqitur, **në përgjithësi,** në përputhje me kuadrin rregullator të raportimit financiar dhe se pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale kornizën e zbatueshme të raportimit financiar. Megjithatë, nga auditimi i pasqyrave financiare, mbështetur në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit dhe Standardin ISSAI 1700, u konstatuan edhe anomali në plotësimin e pasqyrave financiare dhe zbatimin e kuadrit ligjor

dhe rregullator në fuqi (të paraqitura më lartë), të konsideruara *jomateriale dhe jo të përhapura, për të cilën japim* ***opinion të pakualifikuar***[3] *" me Theksim të cështjes.*
II. ***Nga auditimi mbi përputhshmërinë***[4]: Nga auditimi i veprimtarisë së subjektit të audituar, për periudhën e auditimit u konstatua se ka pasur të meta dhe mangësi në lidhje me:
**a**-formulimin e akteve të pranim/refuzimit të lejeve të tipit (C) pasi mungojnë citimet në nenin apo pikën e bazës ligjore e nënligjore dhe pikat e shtojcës përkatëse për secilin prej kushteve të pa plotësuara, duke u mjaftuar vetëm me përmendjen apo citimin e ligjit nr.10431, datë 09.06.2011 "Për lejet e mjedisit", si dhe mungojnë aktverifikimet ne terren dhe relacionet përkatëse të grupit të specialistëve për argumentimin e tyre; **b**- DRM nuk kishte formatin standard të Akt Refuzimit për Leje Tipi C ku të përfshihej saktësisht numri dhe data e aktit, të përfshihej, përcaktohej e cilësohej data e refuzimit të mëparshëm si dhe data e riaplikimit, me synim bërjen më transparente të shërbimit, respektimin e afateve, mospengimin dhe nxitjen e biznesit në pajisjen me lejet mjedisore Tipi C etj. në zbatim të VKM nr. 419, datë 25.06.2014 "Për Lejet e Mjedisit Kreu IV, pika 9. Në Akt-refuzim" nuk përshkruhen rastet e riaplikimit dhe nuk përcaktohen datat dhe sasia e refuzimeve (për herë të dytë data, për herë të trete, data) duke përshkruar shkurtimisht numrin e kushteve të paplotësuara), masë që do të rriste transparencën e DRM, do të nxiste biznesin dhe mbi të gjitha do të rriste shkallën e menaxhimit të subjektit. Për tre muajt e fundit të vitit 2016 DRM Durrës nga 68 aplikime ka refuzuar 23 aplikime dhe ka aprovuar 45 Leje mjedisore tipi C; për vitin 2017 ka shqyrtuar 193 aplikime dhe ka refuzuar 39 aplikime duke aprovuar 154 Leje Mjedisore Tipi C; për nëntmujorin e e parë të vitit 2018 nga 265 aplikime për leje Tipi C janë refuzuar 165 kërkesa dhe janë dhënë 100 leje mjedisore Tipi C; bie në sy rritja e refuzimeve në përqindje gjatë vitit 2018, në krahasim me dy periudhat e tjera çka kufizon numrin e operimit të bizneseve, prodhimin, shërbimet dhe punësimin; **c**- DRM Durrës nuk ka pasur një bashkëpunim në shkallën e cilësinë e duhur me ISHMPUT Durrës dhe nuk ka hartuar program pune bashkëpunimi me të dhe as me institucione të tjera rajonale për evidentimin nga verifikimi në terren në teritorin e Prefekturës Durrës se sa aktivitete të ndryshme biznesi ushtrojnë aktivitet të pa pajisur me leje tipi (C), nga mungesa e bashkëpunimit me struktura të tjera shtetërore, sidomos me ISHMP dhe si pasojë e mos paisjes me leje mjedisore që nuk kanë arkëtuar tarifat përkatëse duke krijuar të ardhura të munguara në buxheti shtetit si edhe në funksion të përmirësimit të cilësisë së Mjedisit në qark duke mos kryer kontrolle të përbashkëta me to mbi subjektet, për të ushtruar kontrolle monitorimi për informalitetin e zbatimit të kushteve për leje mjedisore në përmbushje të kërkesave të ligjit nr. 10431, datë 09.06.2011 "*Për mbrojtjen e mjedisit*" dhe VKM nr. 47, datë 29.01.2014 "*Për përcaktimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit e të agjencive rajonale të mjedisit*", Kreu V, gërma (a), pika (1/n), Kreu VI, germa (a); **d**- ka një numër total mos-deklarimesh të kushteve të lejes mjedisore prej **701** subjektesh nga të C.t **76** subjekte nuk kanë sjellë vetë-monitorimin për periudhën 1 tetor-31 dhjetor 2016; **345** subjekte nuk kanë sjellë vetë-monitorimin – 2017; **280** subjekte nuk kanë sjellë vetë monitorimin për periudhën 1.01.2018-1.10. 2018, në kundërshtim me nenin 29, pika b (ii) të ligjit nr.10488, datë 14.07.2014 "Për lejet e mjedisit". Për mosplotësim të kushteve të lejes dhe numrit të vetë monitorimeve, duhej të aplikohej penalitet me gjobë në masën nga 300 mijë lekë deri 500 mijë lekë. Nëse marrim parasysh

[3]- Sipas ***Manualit të Auditimit Financiar*** të KLSH-së, kapitulli IV, pika 4.2, "Një opinion i pakualifikuar (pa rezervë) jepet kur audituesi është i kënaqur në të gjitha aspektet materiale se: (a) pasqyrat financiare janë përgatitur duke përdorur baza të pranueshme të kontabilitetit dhe politika të cilat janë aplikuar në vazhdimësi; (b) pasqyrat janë në përputhje me kërkesat ligjore dhe me rregulloret përkatëse; (c) situata e paraqitur nga pasqyrat financiare është në përputhje me njohuritë e audituesit mbi njësinë publike të audituar;dhe (d) janë paraqitur saktë të gjitha çështjet materiale që lidhen me pasqyrat financiare.

kufirin minimal prej 300 mijë lekë, ***ardhurat e munguara për buxhetin e shtetit duhet të përllogariten në vlerën prej 210,*****300** mijë lekë (300 x 701=210,3 milion lekë).

**<u>Opinion</u>:**

*Nga **auditimi i përputhshmërisë**, mbështetur në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI 400, Rregulloren e Procedurave të Auditimit të KLSH dhe Manualet e Auditimit të Përputhshmërisë, nën gjykimin tonë, aktiviteti i DRM Durrës, në përgjithësi është kryer në përputhje me kuadrin rregullator. Megjithatë, nga auditimi i përputhshmërisë, u konstatuan edhe devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi të përmendura më lart, për të cilën japim **opinion të pakualifikuar**.*

**Kontrolli i Lartë i Shtetit**